



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PROFILI GJINOR I KOSOVËS





Financuar nga
Bashkimi Evropian



PROFILI GJINOR I KOSOVËS

Nëntor 2024

Ky publikim u financua nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetëm UN Women dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e grafikëve	5
Lista e tabelave	5
Lista e shkurtesave	7
Përmbledhje ekzekutive	11
Hyrje	15
Metodologjia	16
Konteksti i vendit	19
Situata politike, ligjore dhe e të drejtave të njeriut	19
Korniza institucionale.....	22
Garantimi i lirisë nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.....	25
Analiza e politikave.....	25
Qasja në drejtësi dhe qasja në shërbime esenciale.....	28
Incidenca e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave.....	35
Ngacmimet seksuale, sulmet seksuale dhe ndjekja.....	37
Programet për rehabilitimin e kryerësve të dhunës.....	39
Trafikimi me njerëz	39
Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese	41
Edukimi seksual, përdorimi i kontraktivëve dhe lindjet e adoleshentëve	41
Aborti	43
Zbulimi i hershëm i kancerit të qafës së mitrës dhe gjirit	43
Vaksinat kundër HPV-së.....	44
Shëndeti seksual dhe riprodhues i grave me aftësi të kufizuara.....	44
HIV/AIDS dhe IST.....	44
Promovimi i të drejtave ekonomike dhe sociale dhe fuqizimi i vajzave dhe grave	47
Ekonomia	47
Ndërmarrësia.....	52
Mbrojtja Sociale dhe Cenueshmëria Sociale	55
Skemat e Ndihmës Sociale.....	56
Skemat Pensionale	57
Arsimi.....	58
Të drejtat pronësore dhe trashëgimore.....	63
Bujqësia.....	65
Sistemi i licencimit	66
Promovimi i pjesëmarrjes dhe lidërsipit të barabartë.....	67
Përfaqësimi në nivel qendror	67
Përfaqësimi në nivel lokal.....	68
Pjesëmarrja në proceset zgjedhore	71

Media, media sociale dhe gjuha e urrejtjes	72
Kultura, trashëgimia kulturore dhe sporti.....	73
Integrimi i agjendës “Gratë, paqja dhe siguria”	75
Analizë e shkurtër e politikave.....	75
Përfaqësimi i grave në misionet diplomatike	76
Përfaqësimi i grave në polici dhe në forcat e sigurisë	77
Përfaqësimi i Grave në Dialogun Kosovë-Serbi.....	79
Dhuna seksuale e shkaktuar gjatë konfliktit.....	79
Ndryshimet klimatike dhe mjedisi.....	83
Analiza e politikave.....	83
Përfaqësimi dhe vendimmarrja	84
Digjitalizimi.....	86
Hartëzimi i mbështetjes	89
Bashkimi Evropian	89
Organizatat ndërkombëtare	89
Donatorët dypalësh	91
Shoqëria civile	93
Konkluzione dhe rekomandime.....	95

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Rastet e pranuar nga ZMNV-ja, të ndara sipas gjinisë.....	29
Grafiku 2. Numri i grave dhe fëmijëve të strehuar në strehimoret e Kosovës 2019–2023	31
Grafiku 3. Numri i grave dhe burrave që marrin shërbime nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas për shkurorëzim dhe pagesa të alimentacionit	33
Grafiku 4. Rastet e dhunës në familje të raportuara në Policinë e Kosovës	36
Grafiku 5. Numri i rasteve të infeksioneve seksualisht të transmetueshme midis grave dhe burrave 2014–2023	45
Grafiku 6. Treguesit kryesorë të tregut të punës, të ndarë sipas gjinisë, ASK.....	49
Grafiku 7. Pronësia e ndërmarrjeve në Kosovë 2022.....	52
Grafiku 8. Përfituesit e Pensionit Bazik në Kosovë, 2024	55
Grafiku 9. Përfituesit e pensionit kontributpagues, 2024	57
Grafiku 10. Pronësia e grave 2010-2024	63
Grafiku 11. Përfaqësimi në nivelet më të larta të qeverisjes lokale.....	69
Grafiku 12. Përfaqësimi i përgjithshëm i grave në qeverisjen lokale.....	69
Grafiku 13. Përfaqësimi i grave dhe burrave në Komisionet Komunale të	71

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Treguesit shtesë të punësimit, të ndarë sipas gjinisë, 2022	49
Tabela 2. Përfituesit e SNS në Kosovë, të ndarë sipas kategorisë dhe gjinisë, 2024	56
Tabela 3. Përfituesit e skemave të ndryshme të pensioneve, të ndarë sipas gjinisë, 2024	57
Tabela 4. Numri i mesimdhënësve të ndarë sipas gjinisë dhe nivelit arsimor	59
Tabela 5: Numri i nxënësve të ndarë sipas gjinisë dhe nivelit arsimor.....	60
Tabela 6. Të dhëna të ndara sipas gjinisë për shkollat e mesme të larta	60
Tabela 7: Normat e braktisjes, të ndara sipas nivelit arsimor dhe gjinisë 2022/2023	61
Tabela 8: Numri i të diplomuarve në universitetet publike, i ndarë sipas gjinisë	62
Tabela 9. Përfituesit e mbështetjes financiare nga MKRS-ja, të ndarë sipas gjinisë.....	74
Tabela 10. Të dhënat e ndara sipas gjinisë për misionet diplomatike në Kosovë	76
Tabela 11. Përfaqësimi në nivele vendimmarrëse në misionet diplomatike	76
Tabela 12: Përfaqësimi në Policinë e Kosovës, i ndarë sipas gradës dhe gjinisë.....	77
Tabela 13: Oficerët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të ndarë sipas gradës dhe gjinisë	77
Tabela 14. Stafi nënoficer në Forcën e Sigurisë së Kosovës, i ndarë sipas gradës dhe gjinisë	78
Tabela 15. Numri i aplikacioneve të pranuar nga Komisioni 2018 – 2024	80
Tabela 16. Rastet e trajtuara, të miratuara dhe të refuzuara nga Komisioni, të ndara sipas gjinisë	81
Tabela 17: Të dhënat e ndara sipas gjinisë për përfaqësimin në institucionet që punojnë në lidhje me mjedisin dhe ndryshime klimatike.....	84

LISTA E SHKURTESAVE

ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
ANJF	Agjencia për Ndhmë Juridike Falas
ABGj	Agjencia për Barazi Gjimore
AIDS	Sindroma e mungesës së imunitetit të fituar
AShI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
ANF	Aksioni për Nëna dhe Fëmijë
PTH	Prokuroritë Themelore
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
PZNV	Plani i Zbatimit në Nivel Vendi
KiE	Këshilli i Evropës
DhSK	Dhuna seksuale e shkaktuar gjatë konfliktit
QPS	Qendra për Punë Sociale
ECDC	Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
ZBEK	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
PVGj	Plani i Veprimit Gjitor
BPV	Bruto Produkti Vendor
GEF	Instrumenti për Barazinë Gjimore
ZBGj	Zyrtarët e Barazisë Gjimore
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit/Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
BPGj	Buxheti i Përgjegjshëm Gjitor
HIV	Virusi i mungesës së imunitetit të njeriut
HPV	Virusi i Papillomës Njerëzore
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IPA	Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
QKSGj	Qendra Kosovare për Studime Gjimore
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KGjK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KOK	Komiteti Olimpik i Kosovës

IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës
PK	Policia e Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
QKRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
RrGGK	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës
LGBTI+	
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
KKZ	Komisionet Komunale Zgjedhore
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MAShTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
QKMF	Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
NDI	Instituti Demokratik Kombëtar
OJQ	Organizatat Joqeveritare
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë
ZKM	Zyra e Kryeministrit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
VV	Vendvotim
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
IST	Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
UN Women	Agjencia e OKB-së për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNKT	Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
MV	Mbrojtësit e viktimave
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
DhGV	Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave
QAP	Qendra e Aftësisë Profesionale
KW4W	“Kosova – Women 4 Women”
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OShCG	Organizatat e Shoqërisë Civile të Grave

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Profili Gjinator i Kosovës ofron një analizë të thellë të pabarazive gjinore ekzistuese në Kosovë. Fillon me situatën politike, atë ligjore dhe të të drejtave të njeriut, duke vazhduar përqendrimin thellësisht në Temat e PVGj III-shit (**Plani i Veprimit për Barazi Gjinore III i Bashkimit Evropian**), duke përfshirë: “Eliminimin e çdo forme të dhunës me bazë gjinore,” “Promovimin e të drejtave në shëndetin riprodhues dhe seksual,” “Promovimin e të drejtave ekonomike dhe sociale dhe fuqizimin e vajzave dhe grave,” “Promovimin e pjesëmarrjes dhe udhëheqjes së barabartë,” “Integrimin e agjendës për gratë, paqen dhe sigurinë,” si dhe “Adresimin e sfidave dhe shqyrtimin e mundësive të ofruara nga tranzicioni i gjelbër dhe transformimi digjital.”

Për konsolidimin e këtij profili gjinator është përdorur një qasje e kombinuar metodash, përfshirë ato kualitative dhe sasiore të kërkimit, rishikimin e literaturës, analizën e politikave gjinore dhe analizën e statistikave ekzistuese sasiore. Janë përdorur gjithashtu edhe statistikat e publikuara së fundmi, dhe në rastet kur ato ishin të padisponueshme, të dhënat janë ndarë me hulumtuesit drejtpërdrejt nga institucionet përkatëse. Si metodë, janë përdorur edhe grupet e fokusit, të cilat janë organizuar për të marrë të dhëna kualitative për çështje për të cilat statistikat ose analizat më të përditësuara nuk ishin të disponueshme.

Në përgjithësi, Profili Gjinator identifikon përmirësime dhe progres të konsiderueshëm, megjithatë thekson pabarazitë gjinore që vazhdojnë të ekzistojnë në të gjitha temat e analizuara. Vlen të potencohet se ka pasur përmirësime të konsiderueshme në Kornizën Ligjore të Kosovës që e adreson dhunën me bazë gjinore, duke theksuar përfshirjen e Konventës së Stambollit në Kushtetutën e Kosovës, rishikimet e Kodit Penal dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës Ndaj Grave për periudhën 2022–2026. Megjithatë, pavarësisht progresit, sfidat janë evidente, me studime në terren që demonstrojnë se 54 për qind e grave kanë përjetuar dhunë nga partneri intim që nga moshën 15 vjeç.

Temat që lidhen me shëndetin seksual dhe riprodhues vazhdojnë të jenë tabu, duke çuar në një boshllëk të konsiderueshëm sa i përket njohurive të përgjithshme për përdorimin e kontraktivëve. Sipas të dhënave, vetëm 40 për qind e të rinjve përdorin kontraktivë, shumë më pak se bashkëmoshatarët e tyre evropianë. Ky boshllëk nënvizon nevojën për një edukim seksual gjithëpërfshirës dhe qasje më të mirë në burime të planifikimit familjar.

Pabarazia ekonomike vazhdon, me një përqindje më të lartë të grave që jetojnë nën kufirin e varfërisë krahasuar me burrat. Diskriminimi me bazë gjinore në tregun e punës mbetet një pengesë e rëndë, me gratë që janë më pak të prira të marrin pjesë në tregun e punës për shkak të normave shoqërore, punës së papaguar dhe diskriminimit të vazhdueshëm me bazë gjinore në tregun e

punës. Për më tepër, edhe pse ka pasur avancime në kornizën ligjore dhe, në veçanti, kuotat gjinore e kanë bërë të mundshëm diversitetin gjinor në qeverisje, gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në rolet vendimmarrëse.

Pavarësisht përpjekjeve avokuese në kuadër të rezolutës UNSCR 1325 dhe ligjeve kombëtare për promovimin e barazisë gjinore, përfaqësimi i grave në Kosovë në misionet diplomatike dhe në nivelet vendimmarrëse mbetet konsiderueshëm i ulët. Veçanërisht, gratë mbajnë vetëm 24.4 për qind të pozitave vendimmarrëse. Sa i përket ambientit dhe digjitalizimit, legjislacioni i Kosovës për ambientin dhe ndryshimet klimatike ka mungesë të perspektivës gjinore, duke mos e adresuar fare ndikimin gjinor dhe duke dështuar të njohë efektet e ndryshme që ambienti e ndryshimet klimatike kanë te gratë dhe burrat. Sa i përket digjitalizimit, pavarësisht shkallës së lartë të konektivitetit dhe shtrirjes së gjerë të internetit, gratë përballen me barriera të konsiderueshme në qasjen në mundësitë që i ofron digjitalizimi.

Profili Gjinor i jep disa rekomandime për Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë (EUOK) në të gjitha tematikat e analizuar, me synim adresimin e sfidave të identifikuara.

HYRJE

Barazia gjinore është pjesë integrale e politikave dhe veprimeve të brendshme dhe të jashtme të Bashkimit Evropian (BE). BE-ja mbetet e përkushtuar për promovimin e zhvillimit gjithëpërfshirës, të barabartë dhe të qëndrueshëm. Në këtë drejtim, ajo ka zhvilluar korniza, udhëzime dhe politika gjithëpërfshirëse, si Plani i Veprimit për Barazi Gjinore III i BE-së, që nxjerr në pah rëndësinë e integritit të perspektivave gjinore në të gjitha fushat e punës së saj. PVBGj III-shi (GAP III) shërben veçanërisht si kornizë gjithëpërfshirëse për BE-në për të promovuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Plani bazohet në pesë shtylla të veprimit, duke përfshirë objektivin që 85 për qind e të gjitha veprimeve të reja të kontribuojnë në barazinë gjinore dhe në fuqizimin e grave deri në vitin 2025. PVBGj III-shi (GAP III) ofron një qasje transformuese, duke e përfshirë perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe veprimet. Ky dokument inkurajon në mënyrë aktive ndryshimet në qëndrimet shoqërore, duke angazhuar burrat, djemtë dhe të rinjtë si nxitës të ndryshimit. Qëllimi i përgjithshëm i PVBGj III-shit (GAP III) është nxitja e transformimeve pozitive, arritja e rezultateve më të mira dhe nxjerrja në pah e modeleve/shembujve për t'u ndjekur përmes narrativëve të grave dhe vajzave.

Zyra e BE-së në Kosovë (ZBEK) bashkëndan përkushtimin për zbatimin e PVBGj III-shit, duke e bërë atë prioritet në përpjekjet e saj për të promovuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e

grave në rajon.¹ Për këtë qëllim, në vitin 2021, ZBEK-u ka përgatitur **Planin e Zbatimit në Nivel Vendi (PZNV)** të PVBGj III-shit të BE-së. PZNV-ja shërben si udhërrëfyes strategjik i përshtatur për kontekstin specifik të Kosovës, duke përkrahur veprimet dhe iniciativat që duhet të ndërmerren për të avancuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në vend. Megjithatë, PVBGj III-shi i BE-së ka një kërkesë tjetër të rëndësishme. Ai përcakton se duhet të krijohen dhe përditësohen profilet e detajuara gjinore të vendeve dhe analizat gjinore specifike për sektorët. Këto profile gjinore të vendeve duhet të mbulojnë politikat dhe kornizat legislative, statusin e qeverisë dhe statistikat gjinore mbi dhunën, arsimin, shëndetin, punësimin, pjesëmarrjen politike, pengesat për barazinë gjinore, çështjet specifike që lidhen me normat dhe qëndrimet sociale diskriminuese dhe praktikatat e dëmshme, mes tjerash. Profili i fundit Gjinor i Kosovës me titull **“Analiza Gjinore e Kosovës”** u publikua në vitin 2018, dhe tani është i vjetëruar. Disa nga të dhënat që gjenden aty janë përditësuar në vitin 2021 në **Profilin e Shkurtër Gjinor të Kosovës**, për të informuar PZNV-në e Kosovës, por që nga viti 2018 nuk është hartuar asnjë Profil i thelluar Gjinor i Kosovës.

Ky Profili Gjinor i Kosovës ofron një analizë përimtuese të pabarazive ekzistuese gjinore në Kosovë. Ai fokusohet fillimisht në situatën politike, ligjore dhe atë të të drejtave të njeriut, dhe më pas fokusohet në thellësi në fushat tematike të PVGj III-shit, duke përfshirë “Sigurimin e lirisë nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore,” “Promovimin e shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese,” “Promovimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe fuqizimin e vajzave dhe

1 https://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/country-level-implementation-plan-gap-iii-kosovo_en?s=321

grave,” “Promovimin e pjesëmarrjes dhe udhëheqjes së barabartë,” “Integrimin e agjendës për gra, paqe dhe siguri,” si dhe “Adresimin e sfidave dhe shfrytëzimin e mundësive të ofruara nga tranzicioni i gjelbër dhe transformimi digjital.”

METODOLOGJIA

Për konsolidimin e këtij profili gjinor është përdorur një qasje e kombinuar e metodave, e atyre kualitative dhe sasiore të kërkimit, përfshirë rishikimin e literaturës, analizën e politikave gjinore dhe analizën e statistikave ekzistuese sasiore. Janë përdorur edhe statistikat e publikuara së fundmi, dhe në rastet kur ato ishin të padisponueshme, të dhënat janë ndarë me hulumtuesit drejtpërdrejt nga institucionet përkatëse. Si metodë janë përdorur edhe grupet e fokusit, të cilat janë organizuar për të marrë të dhëna kualitative për çështje ku statistikat ose analizat më të përditësuara nuk ishin të disponueshme.

Rishikimi i literaturës ka shërbyer si themeli kryesor për Profilin Gjinor. Janë shqyrtuar burime të ndryshme, përfshirë kornizat ligjore dhe politikat kombëtare, raportet hulumtuese, profilet gjinore paraprake dhe po ashtu statistikat ekzistuese kualitative. Në shumë raste, statistikat ekzistuese ishin të pamjaftueshme dhe të vjetra, prandaj hulumtuesit i kanë kontaktuar institucionet relevante për të marrë të dhëna në mënyrë direkte. Në procesin e marrjes së të dhënave në mënyrë direkte janë përfshirë, Ministria e Edukimit, Komisioni Qendror Zgjedhor, Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punëve të Jashtme, Policia e Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor.

Në fund, tri grupe të fokusit janë përdorur për të marrë të dhëna kualitative në temat e ndërlidhura me ambientin dhe ndryshimet klimatike, diskriminimi ndërsektorial dhe dhuna me bazë gjinore. Një total prej 22 pjesëmarrësish kanë marrë pjesë në diskutimet e grupeve të fokusit, duke mundësuar diskutime ndërvepruese dhe përmbajtjesore. Diskutimet janë transkriptuar dhe janë analizuar përmes metodës së analizës tematike, e cila përfshin nxjerrjen dhe organizimin e të dhënave në tema që përsëriten. Një grup i fokusit është mbajtur për dhunën me bazë gjinore dhe ka përfshirë përfaqësues institucionalë dhe të shoqërisë civile. Një tjetër grup i fokusit është mbajtur mbi temën e diskriminimit ndërsektorial dhe ka përfshirë pjesëmarrës nga shoqëria civile që punojnë me grupe të cënueshme si minoritetet etnike, komuniteti LGBTQI+, dhe gratë me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrësit nga institucionet, shoqëritë civile, dhe aktivistët kanë marrë pjesë në një grup të tretë të fokusit në temat e ndryshimeve klimatike dhe mbrojtës së ambientit.

KONTEKSTI I VENDIT

Situata politike, ligjore dhe e të drejtave të njeriut

Demografia

Kosova është e banuar nga afërsisht 1,771,293 banorë, nga të cilët 48.5 për qind prej tyre janë gra dhe 51.5 për qind burra.² Ka një popullsi relativisht të re, me 27.17 për qind nën moshën 15 vjeç, 66.13 për qind midis moshave 15 dhe 64 vjeç dhe 6.70 për qind janë të moshës mbi 65 vjeç. Për sa i përket përkatësisë etnike, popullsia është kryesisht shqiptare, me rreth 92.9 për qind, serbët përbëjnë rreth 1.5 për qind, boshnjakët 1.6 për qind, dhe turqit 1.1 për qind. Përbërja fetare është kryesisht islame me 87.0 për qind, pasuar nga e krishterë me 11.4 për qind dhe 1.6 për qind nuk kanë përkatësi fetare.³ Jetëgjatësia mesatare është 69 vjet, 67 vjet për burrat dhe 71 vjet për gratë.⁴

Korniza politike dhe ligjore

Barazia Gjinore dhe Përfshirja Sociale janë ndër vlerat themelore të kornizës kushtetuese dhe ligjore të Kosovës. Vetë Kushtetuta njeh barazinë gjinore dhe mundësitë e barabarta si vlera thelbësore.⁵ Për më tepër, ajo pranon se Kosova është një shoqëri shumetnike ku të gjithë janë të barabartë para ligjit, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike.⁶ Përveç kësaj, Kushtetuta përcakton zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare brenda Kosovës, siç është Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). CEDAW-i kërkon që të merren masat e nevojshme për eliminimin e diskriminimit ndaj grave në fusha të ndryshme, duke përfshirë vendin e punës, si dhe për garantimin e të drejtave të barabarta si për burrat ashtu edhe për gratë. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut si dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë gjithashtu të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë përmes Kushtetutës. Konventat Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare janë gjithashtu të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë, duke përfshirë Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Konventën e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

2 Këto të dhëna bazohen në vlerësimet e vitit 2024 nga Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale i Kombeve të Bashkuara. Agjencia e Statistikave aktualisht është duke kryer regjistrimin e popullsisë, dhe të dhënat e përditësuara dhe të besueshme duhet të jenë të disponueshme në vitin 2024. Shihni më shumë në: <https://countrymeters.info/en/Kosovo>

3 Po aty.

4 Po aty.

5 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008). [Kushtetuta e Republikës së Kosovës](#). Neni 7.2.

6 Po aty, neni 3.

Krahas Kushtetutës, Ligji për Barazinë Gjimore është instrumenti kryesor ligjor për inkurajimin e barazisë gjimore dhe parandalimin e diskriminimit ndaj grave në të gjithë sektorët, duke përfshirë punësimin, arsimin, energjinë dhe kujdesin shëndetësor.⁷ Ligji kërkon përfaqësim të barabartë gjinor, të përcaktuar si 50 për qind–50 për qind në të gjitha nivelet vendimmarrëse të të gjitha institucioneve publike, duke përfshirë organet legjislative, ekzekutive, gjyqësore, si dhe institucionet e tjera publike.⁸ Ligji, përmes nenit 5.1.3, përcakton më tej që perspektiva gjimore të përfshihet në të gjitha ligjet dhe politikat e qeverisë në mënyrë që të adresohen problemet ekzistuese dhe të promovohet barazia midis grave dhe burrave.⁹ Përveç kësaj, ai obligon të gjitha institucionet publike në Kosovë që të zbatojnë Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator (BPGJ) në proceset e tyre të planifikimit, alokimit dhe monitorimit të buxhetit.¹⁰ BPGJ-ja kërkon që institucionet të shpërndajnë fondet qeveritare në mënyrë të barabartë dhe të adresojnë pabarazitë ekzistuese gjimore. Për fund, Ligji për Barazinë Gjimore promovon përdorimin e masave afirmative për adresimin e pabarazive ekzistuese.¹¹ Këto masa mund të përfshijnë kuotat, programet mbështetëse, fuqizimin ekonomik dhe trajtimin preferencial, gjithnjë duke marrë parasysh kualifikimet individuale.

Përveç kësaj, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbron qytetarët e Kosovës nga diskriminimi në baza racore, të gjinisë, etnisë, fesë, orientimit seksual ose origjinës kombëtare. Ai ndalon, ndër të tjera, diskriminimin në punësim, arsim, banim dhe qasje në shërbimet publike.¹² Ngjashëm me Ligjin për Barazinë Gjimore, ky ligj lejon marrjen e masave afirmative për të promovuar përfaqësimin e grupeve të nënpërfaqësuar, që synojnë arritjen e trajtimit të barabartë. Ai thekson faktin se masat afirmative, kur merren për të mbështetur grupet e nënpërfaqësuar ose të marginalizuara, nuk duhet të përbëjnë diskriminim.¹³ Sa i përket mbrojtjes së pakicave etnike (boshnjakëve, serbëve, turqve, ashkalinjve, egjiptianëve, goranëve dhe romëve), ekziston Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre.¹⁴ Ligji ekziston që të sigurojë barazi të plotë për të gjithë qytetarët në Kosovë, duke përfshirë të gjitha pakicat kombëtare. Krahas të drejtave themelore, ai thekson parandalimin e diskriminimit, mundësitë e barabarta, ruajtjen e identitetit kulturor dhe promovimin e dialogut ndërkulturor.

Një legjisllacion tjetër i rëndësishëm është Ligji për Avokatin e Popullit.¹⁵ Ligji përcakton një mekanizëm ligjor për mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave dhe lirive themelore në Kosovë. Përgjegjësitë e Avokatit të Popullit përfshijnë hetimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe diskriminimit, dhënien e rekomandimeve për ndalimin e rasteve të tilla, promovimin e ndërgjegjësimit për të drejtat e njeriut, publikimin e raporteve dhe rekomandimeve dhe bashkëpunimin me organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Avokati i Popullit gjithashtu ka autoritetin për të shqyrtuar ankesat, për t'iu qasur

7 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2015). [Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjimore](#).

8 Po aty, neni 6.7

9 Po aty, neni 5.1.3

10 Po aty, neni 5.1.5

11 Po aty, neni 6.

12 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2015). [Ligji nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi](#).

13 Po aty, neni 7.3

14 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2015). [Ligji nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë](#), 2008.

15 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2015). [Ligji nr. 05/L-19 për Avokatin e Popullit](#).

dosjeve dhe dokumenteve përkatëse dhe për të kryer inspektime në vendet ku individët raportojnë se janë privuar nga të drejtat dhe liritë themelore.¹⁶

Dokumentet kryesore të politikave

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024, i konsideruar si strategjia kryesore për barazi gjinore në Kosovë, bazohet në tri shtylla: Shtylla I: *Fuqizimi Ekonomik dhe Mirëqenia Sociale*; Shtylla II: *Zhvillimi Njerëzor, Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore*; Shtylla III: *Të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguria*.¹⁷ Secila shtyllë ka objektivin e saj të përgjithshëm, objektivat specifike dhe aktivitetet. Rishikimi i parë i progresit për këtë program, që mbulonte periudhat e viteve 2020 dhe 2021, tregoi një shkallë të përgjithshme të progresit prej 66 për qind.¹⁸ Shkalla e përgjithshme për vitin 2022 ishte 63 për qind.¹⁹

Programi për Reforma në Ekonomi 2022–2024 përshkruan politikat strategjike ekonomike dhe reformat strukturore të nevojshme drejt sigurimit të rritjes ekonomike, përmirësimit të stabilitetit financiar dhe rritjes së konkurrencës në Kosovë. Ai u jep përparësi disa fushave, duke përfshirë menaxhimin e financave publike, energjinë, punësimin, arsimin dhe politikat sociale. Perspektiva gjinore është e integruar në tërë programin, kryesisht duke synuar uljen e pabarazisë ekonomike midis grave dhe burrave, dhe rritjen e punësimit të grave nëpërmjet politikave të ndjeshme gjinore në zhvillimin e fuqisë punëtore dhe ndërmarrësisë.²⁰

Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022–2026 dhe Plani i Veprimit 2022–2024 është hartuar me qëllim të uljes së përjashtimit të komuniteteve rom dhe ashkali.²¹ Ajo përmban veprime për t'i arritur këto pesë objektiva: arsim cilësor gjithëpërfshirës, punësim të qëndrueshëm dhe ulje të varfërisë, qasje në shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor, qasje në banim të qëndrueshëm dhe shërbime thelbësore, si dhe parandalim të diskriminimit, racizmit dhe gjuhës së urrejtjes.²²

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 fokusohet në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik duke krijuar më shumë ndërmarrje, duke integruar teknologjitë moderne në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe duke kontribuar në zhvillimin rural përmes një sektori të fuqishëm bujqësor. Ajo gjithashtu fokusohet në zhvillimin e barabartë njerëzor nëpërmjet përmirësimit të qasjes në arsim, kujdesit shëndetësor dhe mundësive kulturore, me vëmendje të veçantë fuqizimit të grave dhe të rinjve për të marrë pjesë plotësisht në ekonomi dhe shoqëri.²³

16 Po aty.

17 Agjencia Kosovare për Barazi Gjinore (2020). [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024](#).

18 Agjencia Kosovare për Barazi Gjinore (2023). Raporti i monitorimit dhe vlerësimit për arritjet e objektivave për treguesit dhe zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit të PKBGj 2020–2022.

19 Agjencia Kosovare për Barazi Gjinore (2024). Raporti i dytë i monitorimit të Planit të Veprimit të PKBGj-së, për vitin 2022.

20 Qeveria e Kosovës (2022), [Programi për Reforma në Ekonomi, 2022–2026](#)

21 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Korrik (2022). [Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022–2026 dhe Plani i Veprimit 2022–2024](#). Faqe 22.

22 Zyra e Kryeministrit të Kosovës (2022). [Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022–2026 dhe Plani i Veprimit 2022–2024](#). Faqe 23–24.

23 Qeveria e Kosovës (2023). [Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030](#)

Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2022–2026 përshkruan kornizën strategjike dhe planin e veprimit që Kosova të përafrohet me standardet dhe politikat e Bashkimit Evropian si pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Programi synon të orientojë reformat e Kosovës drejt integritimit në BE. Kjo përfshin veprimet dhe masat e detajuara në sektorë të ndryshëm, siç janë: sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik, qeverisja, mjedisi dhe politikat sociale, vendimtare për procesin e integritimit evropian të Kosovës. Perspektiva gjinore është e integruar në PKZMSA 2022–2026 në tërësi, përmes zotimeve specifike për të përmirësuar kornizën ligjore dhe institucionale në lidhje me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave. Mes tjerash, kjo përfshin miratimin e *Acquis* së BE-së për barazinë gjinore, duke synuar uljen e diskriminimit dhe përmirësimin e statusit socio-ekonomik të grave në Kosovë, si dhe sigurimin që perspektivat gjinore të përfshihen në të gjitha fushat e politikave të mbuluara nga marrëveshja.²⁴

Ligjet dhe politikat e diskutuara në këtë kapitull janë dispozitat kryesore në kornizën ligjore të Kosovës që promovojnë barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale. Është e rëndësishme të theksohet se ka ligje dhe politika shtesë që trajtojnë çështje të ndërlidhura, mes tjerash, si dhuna me bazë gjinore, prona dhe trashëgimia, arsimit, të cilat nuk janë diskutuar këtu dhe do të diskutohen më poshtë në fusha të ndryshme tematike.

Në fund, është e rëndësishme të theksohet se dispozitat e këtyre ligjeve jo gjithmonë zbatohen. Për shembull, derisa përfaqësimi i barabartë është obligim ligjor, gratë në Kosovë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuara në nivelet vendimmarrëse në të gjitha institucionet publike në nivel qendror dhe atë lokal. Për më tepër, edhe pse integrimi gjinor kërkohet në të gjitha politikat dhe ligjet, shumicës së legjislacionit primar dhe sekondar në Kosovë i mungon perspektiva gjinore, duke lënë pa adresuar nevojat e ndryshme të grave dhe burrave në sektorë të ndryshëm.²⁵

Korniza institucionale

Kosova ka një kornizë të fortë institucionale për sigurimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave. Korniza institucionale është kryesisht e mishëruar në Ligjin për Barazi Gjinore dhe fokusohet në dy mekanizma kryesorë: Agjencinë Kosovare për Barazi Gjinore (ABGj) dhe Zyrtarët e Barazisë Gjinore (ZBGj).

ABGj-ja është agjenci ekzekutive dhe gjendet në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM). Ajo është organi qendror institucional përgjegjës për promovimin, koordinimin dhe monitorimin e barazisë gjinore në Kosovë.²⁶ Ndër të tjera, ABGj-ja është përgjegjëse për propozimin e ndryshimeve të ligjeve dhe politikave, hartimin e politikave dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me shoqërinë civile dhe organizatat donatore ndërkombëtare. ABGj-ja ka shumë përgjegjësi të tjera, duke filluar nga avokimi, fushatat e ndërgjegjësimit, raportimi mbi detyrimet ndërkombëtare dhe monitorimi i institucioneve mbi integritimin gjinor dhe praktikën buxhetore.²⁷ Dy përgjegjësi shtesë kyçe të ABGj-së janë hartimi i Programit të

24 Qeveria e Kosovës (2022). [Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit \(PKZMSA\) 2022–2026](#).

25 Rrjeti i Grave të Kosovës (2018). [Analiza Gjinore e Kosovës](#).

26 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2015). [Ligji nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore](#).

27 Po aty, neni 7.

Kosovës për Barazi Gjinore dhe monitorimi i zbatimit të tij, si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi me ZBGj-të.

Zyrtarët e Barazisë Gjinore janë të vendosur në secilën ministri dhe komunë në Kosovë. Mes tjerash, ZBGj-të janë përgjegjës për rishikimin e ligjeve dhe politikave relevante për sektorin e tyre nga perspektiva gjinore, dhe për të siguruar zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe Programit të Kosovës për Barazi Gjinore brenda institucionit të tyre.²⁸ Me riorganizimin e administratës shtetërore dhe bashkimit të entiteteve të ndryshme, Zyrtarëve për Barazi Gjinore shpeshherë u janë ngarkuar detyra jashtë fushës së tyre të punës, gjë që i pengon ata të ushtrorjnë funksionet e tyre, e që shkel Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Rregulloren për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zyrtarëve Përkatës për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna.²⁹ Në vitin 2024, disa ministri nuk kanë ZBGj (Koordinatorë për Barazi Gjinore), përfshirë Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Ministrinë e Industrisë, Sipërmarrjes dhe Tregtisë. Për më tepër, ZBGj-ja e vendosur në Ministrinë e Punëve të Brendshme mbulon gjithashtu Ministrinë e Administratës Publike.³⁰

Koordinatorja (Koordinatori) Nacionale kundër Dhunës në Familje është pjesë e Ministrisë së Drejtësisë dhe ka një rol qendror në luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Koordinatorja, pozitë kjo e themeluar me Vendimin Nr. 04/82 më 11 korrik 2012, mbikëqyr Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave.³¹ Përgjegjësitë e saj janë koordinimi me entitetet qeveritare dhe joqeveritare, forcimi i kapaciteteve institucionale, mbështetja për viktimat, ndëshkimi i autorëve dhe udhëheqja e fushatave të ndërgjegjësimit. Roli i saj siguron që korniza ligjore dhe politike e Kosovës të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare, veçanërisht me Konventën e Stambollit. Para vitit 2024, ky rol i ishte dhënë zëvendësministrit të Drejtësisë, dhe nga viti 2024, ai mbahet nga Ministri i Drejtësisë.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës, për Personat e Pagjetur dhe Peticionet është një komision funksional i Kuvendit të Kosovës. Ai merret me të gjitha çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, duke siguruar respektimin e legjislacionit përkatës. Komisioni shqyrton ligjet dhe politikat për të promovuar barazinë gjinore, mbikëqyr mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të grave, si dhe ofron rekomandime për përmirësime. Ai gjithashtu merret me çështjen e personave të pagjetur, duke ofruar mbështetje legjislative dhe strategjike. Për më tepër, ai merret me peticionet nga qytetarët, duke siguruar që shqetësimet e tyre të adresohen në përputhje me procedurat ligjore. Komiteti bashkëpunon me organizata lokale dhe ndërkombëtare për të përmirësuar funksionet dhe ndikimin e tij.

Grupi i Grave Deputete në Kuvendin e Kosovës është një grup ndërpartiak i krijuar për të promovuar barazinë gjinore dhe për të përmirësuar përfaqësimin e grave në politikë. Grupi, i përbërë nga 38 anëtare, përqendrohet në avokimin ligjor, zhvillimin e politikave dhe nxitjen e dialogut mbi çështjet e grave. Arritjet kryesore përfshijnë avokimin për përfshirjen e Konventës së Stambollit në Kushtetutën

28 Po aty. Neni 12.

[Qeveria e Kosovës \(2016\). Rregullorja Nr. 12/2016 rreth Detyrave dhe Përgjegjësiave të Zyrtarëve Përkatës për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna](#)

29 Information provided by the Agency for Gender Equality, May 2024.

30 Qeveria e Kosovës (2012). [Decision 04/83](#).

31 [Amendamenti 26 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës](#), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, shtator 2020.

e Kosovës dhe ndryshimin e Kodit Penal për të adresuar më mirë dhunën në familje. Grupi gjithashtu bashkëpunon me organizata vendore dhe ndërkombëtare për të mbështetur fuqizimin e grave dhe pjesëmarrjen e tyre në politikë.

Zyrat tjera në kuadër të ZKM-së përfshijnë Zyrën për Qeverisje të Mirë (ndër të tjera për të Drejtat e Njeriut, për Mundësi të Barabarta dhe Kundër Diskriminimit), dhe Zyrën për Çështje të Komuniteteve e cila kontribuon në koordinimin e përpjekjeve për zbatimin e kornizës ligjore kombëtare për të drejtat e komuniteteve.

Për fund, Kosova ka shumë organizata bazë (ang. "grassroots organisations") të grave që veprojnë në të gjitha rajonet dhe komunat e Kosovës.

GARANTIMI I LIRISË NGA TË GJITHA FORMAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE

Analiza e politikave

Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm në kornizën ligjore që siguron mbrojtje kundër të gjitha formave të dhunës në baza gjinore. Arritja kryesore e saj ishte në vitin 2020, kur Kushtetuta e Kosovës u ndryshua për të përfshirë Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje, e njohur ndryshe si Konventa e Stambollit.³² Kjo traso i rrugën për një sërë ndryshimesh në kornizën ligjore, siç kërkohet nga Konventa. Në vitin 2022, Qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna kundër

Grave 2022-2026.³³ Strategjia dhe plani i saj i veprimit sigurojnë një platformë për bashkërendimin e veprimeve dhe palëve të interesit në identifikimin dhe parandalimin e

dhunës, në mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe mbajtjen përgjegjës të kryerësve të veprave.³⁴

Ky vizion pasqyrohet përmes katër objektivave strategjike, të cilat përfshijnë: 1) Parandalimin dhe identifikimin e dhunës përmes edukimit dhe ndërgjegjësimin; 2) Avancimin dhe harmonizimin e politikave publike me standardet ndërkombëtare; 3) Fuqizimin institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave të dhunës në familje; 4) Sigurimin e shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat.³⁵

Një hap tjetër përpara ka qenë përshtatja e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore në vitin 2023.³⁶ Ligji ofron një sërë mbrojtjesh për viktimat e dhunës, duke përfshirë detyrimin e të gjitha subjekteve përkatëse për t'i trajtuar këto raste me prioritet, mundësinë e dhënies së urdhrave të mbrojtjes urgjente për viktimat brenda 24 orëve bazuar në dokumente

32 [Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), Zyra e Kryeministrit të Kosovës 2022.

33 Po aty, faqe 8.

34 Po aty, faqe 39-47.

35 [Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në baza Gjinore](#), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, tetor 2023.

36 Po aty, neni 5 dhe 46

dhe pa seancë gjyqësore, si dhe mbrojtje të tjera që lidhen me sigurinë, qasjen në drejtësi dhe shërbime të tjera.³⁷ Gjithashtu, ligji përcakton funksionin e Koordinatorës Nacionale, e cila është "autoriteti më i lartë institucional për koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës që mbulohen nga ky ligj."³⁸ Koordinatorja Nacionale është Ministria e Drejtësisë, e cila në kuadër të këtij kapaciteti të ri kryeson edhe Grupin Koordinues Ndërmintor për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore.

Ministria e Drejtësisë ka formuar dy grupe punuese, njëri prej të cilëve është duke punuar në projektligjin kundër femicideve³⁹ dhe tjetri është përgjegjës për hartimin e akteve nënligjore për Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën me Bazë Gjinore. Këto akte nënligjore përfshijnë: 1) Projekt-rregullore për organizimin dhe funksionalizimin e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe funksionalizimin e grupit punues ndërmintor; 2) Projekt-rregullore për mekanizmat e koordinimit lokal për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore; 3) Projekt-udhëzim administrativ për mirëmbajtjen, sigurinë dhe përdorimin e sistemit dhe gjenerimin e raporteve publike që mbrojnë konfidencialitetin e viktimave; 4) Projekt-udhëzim administrativ për krijimin e një fondi emergjent për nevojat e viktimave gjatë kohës që ato ndodhen në polici; 5) Projekt-udhëzim administrativ për linjën telefonike emergjente për viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore; 6) Projekt-udhëzim administrativ për procedurat e shpërndarjes, monitorimit, licencimit dhe financimit të strehimoreve specializuara për strehimin e viktimave të abuzimit; dhe 7) Program për procedurat standarde të operimit.⁴⁰

Një tjetër zhvillim pozitiv është ndryshimi i Ligjit për Ndhimën Juridike Falas, i cili tashmë përfshin këto grupe si kategori të veçanta të përfituesve të ndihmës juridike falas: të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës, viktimat e dhunës në familje dhe dëshmitarët që varen nga ta, viktimat e dhunës me bazë gjinore, viktimat e çfarëdo lloji të dhunës seksuale, duke përfshirë ngacmimin seksual, dhe viktimat e trafikimit me qenie njerëzore.⁴¹ Para kësaj, viktimat duhej të plotësonin kriteret e kualifikimit, financiare dhe ligjore,⁴² dhe tani me këtë amendament përjashtohen këto kategori të veçanta.

Kodi Penal i Kosovës njih dhunën në familje, ngacmimin seksual, sulmin seksual, përdhunimin, shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit si shkelje penale, të dënueshme nga gjokat e deri në vite me burgim, sipas rastit.⁴³ Në kuadër të dhunës në familje, kodi kriminalizon dhunën fizike psikologjike, seksuale dhe ekonomike, si dhe keqtrajtimin ndaj anëtarëve të familjes.⁴⁴ Ai gjithashtu mbulon shkeljet e integritetit

37 [Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në baza Gjinore](#), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, tetor 2023. Neni 13.2.

38 Ministria e Drejtësisë (2024). [Decision Nr. 128/2024 on establishing the working group responsible for drafting and finalizing the Draft Law against Femicide](#).

39 Ministria e Drejtësisë (2024). [Decision Nr. 29/2024 on Establishing the working group for drafting and finalizing bylaws deriving from Law. Nr. 08/L-185 for prevention and protection from domestic violence, violence against women, and gender based violence](#).

40 [Ligji nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndhimë Juridike Falas](#), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, shkurt 2022. Neni 10A.

41 [Ligji nr.04/L-017 për Ndhimë Juridike Falas](#), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, shkurt 2012.

42 [Kodi nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës](#). Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës. Janar 2019. Neni 248, 183, 229, 227 dhe 228.

43 Po aty. Neni 248.

44 Po aty. Nenet 225- 236.

seksual, duke përfshirë një sërë aktiviteteve seksuale dhe pornografisë e fëmijëve.⁴⁵ Moshë minimale për pëlqimin për marrëveshje vullnetare për akte seksuale është 14 vjeç, nëse diferenca e moshës midis dy individëve nuk i kalon dy vjet.⁴⁶ Përndryshe është 16 vjeç. Në vitin 2023, Kodi Penal u ndryshua, me ndryshime kyçe në lidhje me luftën kundër dhunës në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën me bazë gjinore. Në këto ndryshime përfshihet kriminalizimi i testeve të virgjërisë, ashpërsimi i ndëshkimeve për ngacmimet seksuale dhe vendosja e pasojave ligjore për rastet e dhunës ndaj grave në jetën publike.⁴⁷ Në vitin 2022, Qeveria e Kosovës ka miratuar një protokoll shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, ku nuk ka marrëveshje vullnetare.⁴⁸ Protokollin është një udhëzues hap pas hapi për një reagim institucional të koordinuar ndërsektorial në menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024 i hartuar nga Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj) dhe i miratuar nga Qeveria e Kosovës, përfshin një sërë veprimesh të zbatuara në shumë sektorë që synojnë parandalimin dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore.⁴⁹ Aktualisht ABGj-ja është duke rishikuar zbatimin e këtij programi dhe po përgatitet për fazën e ardhshme. Përveç kësaj, ABGj-ja ka hartuar Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë,⁵⁰ dhe ka trajnuar akterë të ndryshëm për to. Deri më sot, ABGj-ja ka lehtësuar 19 sesione trajnimi me palët relevante të interesit në mbarë Kosovën.⁵¹ ABGj-ja gjithashtu ka iniciuar procesin e hartimit të Programit të ri për Barazi Gjinore, si dhe përditësimin e PSV-ve.

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare është shtesa më e re në kornizën përkatëse ligjore. I miratuar në janar të vitit 2024, ligji mbulon të drejtat për shërbimet sociale, ku përfitues janë fëmijët dhe të rriturit që kanë qenë viktimë të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe formave të tjera të dhunës.⁵² Në këtë ligj përfshihen edhe themelimi dhe kompetencat e institucioneve të shërbimit social, duke përfshirë qendrën për punë sociale dhe strehimoret.⁵³ Përveç shërbimeve, viktimat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore kanë të drejtën e kompensimit. Kjo e drejtë është e përcaktuar në Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të miratuar në vitin 2022.⁵⁴ Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, përdhunimit dhe dhunës në familje kanë qasje në kompensim të menjëhershëm, ndërsa llojet e kompensimit, ndër të tjera, përfshijnë dëmtimin fizik, dëmtimin e shëndetit mendor dhe vuajtjen mendore.⁵⁵

Ligji për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të Cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, parasheh përdorimin e pajisjeve elektronike në rastet e dhunës në familje, kur zbatohet një urdhër mbrojtjeje apo urdhër për mbrojtje emergjente.⁵⁶ Kjo masë është krijuar për të parandaluar përshkallëzimin

45 Po aty. Nenet 225.

46 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2023). [Ligji Nr. 08/L-188 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Penal Nr. 06/L-074 i Republikës së Kosovës](#). Article 10, 11, and 13.

47 [Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale](#), Ministria e Drejtësisë. Nëntor 2022.

48 [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024](#). Agjencia për Barazi Gjinore. Qershor 2020.

49 [Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë](#). Agjencia për Barazi Gjinore. shkurt 2013.

50 Informacioni i siguruar nga Agjencia për Barazi Gjinore, Mars 2024.

51 [Ligji nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare](#). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Janar 2024. Neni 29.

52 Po aty. Kapitulli VII.

53 [Ligji nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit](#). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nëntor 2022.

54 Po aty. Neni 8 dhe 10.

55 Ligji për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Qershor 2015. Neni 2.

56 [Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), Zyra e Kryeministrit të Kosovës 2022. Veprimi nr. II.1.12. Faqe 76.

ose vdekjen. Deri më sot, kjo nuk është zbatuar. Strategjia Kombëtare ka përfshirë në planin e veprimit “Krijimin e një sistemi të monitorimit digjital për zbatimin adekuat të urdhrave të mbrojtjes në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen Elektronike dhe monitorimin e efektivitetit të këtij sistemi.”⁵⁷ Deri më tani, specifikimet teknike për këtë sistem janë hartuar nga Policia e Kosovës dhe ai është në proces të prokurimit.⁵⁸

Në vitin 2022, Kosova i raportoi për herë të parë Grupit të Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO).⁵⁹ Pavarësisht se nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, Kosova ofroi një përditësim mbi zbatimin e Konventës së Stambollit, pasuar nga raporti i parë monitorues i GREVIO-s.

Qasja në drejtësi dhe qasja në shërbime esenciale

Policia e Kosovës (PK) zakonisht është subjekti i parë që viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje e kontaktojnë kur i raportojnë rastet e tyre. Policia e Kosovës është përgjegjëse për mbrojtjen e viktimës, hetimin e rastit dhe vlerësimin e rrezikut për kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë.⁶⁰ Ata gjithashtu u japin viktimave informacione lidhur me hapat e mëtejshëm dhe shërbimet në dispozicion, si dhe mund të lëshojnë urdhra të përkohshëm të mbrojtjes emergjente gjatë periudhave jashtë orarit të punës së gjykatave.⁶¹ Sipas planit të veprimit⁶² të strategjisë kombëtare, Policia e Kosovës tani ka një Drejtorin të caktuar për Parandalimin dhe Hetimin e Dhunës në Familje, e cila ka sektorët e saj dhe ka më shumë staf dhe resurse sesa ka pasur kur kjo çështje trajtohej në baza sektoriale.⁶³ Ata gjithashtu janë në proces të krijimit të dhomave miqësore,⁶⁴ me dhoma të themeluara tashmë në 26 nga 41 stacionet e policisë.⁶⁵ Gjatë vlerësimit të shkallës mesatare të reagimit të policisë në rastet e dhunës në familje, e matur si koha nga marrja e telefonatës e deri te mbërritja në lokacion, IPK-ja ka gjetur se në vitin 2022 ka qenë 19.2 minuta, me reagimin më të shpejtë të shënuar në Junik, për 6 minuta, dhe me reagimin më të ngadalshëm në Gjilan, për 32.8 minuta.⁶⁶

57 Raporti i inspektimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Nëntor 2023. Faqe 16.

58 Agjencia Kosovare për Barazi Gjinore (2023). Raporti i monitorimit dhe vlerësimit të arritjes së caqeve për indikatorët dhe zbatimin të aktiviteteve të planit të veprimit të PKBGJ-së 2020-2022.

59 [Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), Zyra e Kryeministrit të Kosovës 2022. Faqe 25.

60 [Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me bazë Gjinore](#), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, tetor 2023. Neni 19 dhe 28.

61 [Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), Zyra e Kryeministrit të Kosovës 2022. Nr. IV 1.11. Faqe 102.

62 Mbledhja e Fokus Grupit për dhunën në baza gjinore u mbajt më 29 shkurt 2024.

63 [Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), Zyra e Kryeministrit të Kosovës 2022. Nr. IV 1.15. Faqe 103.


64 Raporti i inspektimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Nëntor 2023. Faqe 17.

65 Raporti i inspektimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Nëntor 2023. Faqe 10.

66 [Shqetësimet lidhur me Sigurinë e Grave në Kosovë](#). Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. shkurt 2024. Faqe 8. [Nga letra në praktikë: Kosova duhet t'i mbajë zotimet ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje – Përmbledhje Ekzekutive](#). Amnesty International. 2023. Faqe 4.

Përderisa janë shënuar disa përparime në shërbimet e ofruara nga Policia e Kosovës, qëndrimi i zyrtarëve policorë ndaj viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje ka qenë shpesh problematik. Paragjykimet me dhe pa vetëdije, që burojnë nga normat tradicionale, kanë çuar në nënçmimin e përvojave dhe madje justifikimin e dhunës nga punonjësit e policisë.⁶⁷ Pas miratimit të Konventës së Stambollit, PK-ja ka organizuar një sërë trajnimesh për t'i trajtuar këto paragjykimet në mesin e policëve, dhe për t'u dhënë fund përpjekjeve për pajtimin e palëve.⁶⁸ Megjithatë, perceptimi se qëndrimi i punonjësve të policisë ndaj viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje është nënçmues dhe gjykues është mjaft i përhapur, pavarësisht nëse është kështu apo jo. Edhe nëse përvoja në stacion është profesionale, ky perceptim mund t'i pengojë viktimat aktuale ose të mundshme që t'i raportojnë rastet.

Grafiku 1. Rastet e pranuar nga ZMNV-ja, të ndara sipas gjinisë



Me rastin e pranimit të një rasti të ri, PK-ja njofton Prokurorin e Shtetit, Zyrën për Mbrojtje dhe Ndhmë Viktimave (ZMNV) dhe Qendrën për Punë Sociale (QPS), të cilëve u kërkohet të reagojnë menjëherë.⁶⁹ Hetuesit e PK-së përgatisin dosjen për Prokurorin e Shtetit, i cili më pas është përgjegjës për mbledhjen e provave dhe për vazhdimin e ndjekjes penale edhe nëse viktimat vendos të mos e bëjnë këtë.⁷⁰ Hulumtimet kanë konstatuar se prokurorët kanë marrë trajnime për dhunën në familje, dhe me rritjen e raportimit dhe trajtimit të drejtpërdrejtë të rasteve ata kanë fituar më shumë përvojë në menaxhimin e rasteve të tilla, veçanërisht në krahasim me vitin 2017.⁷¹ Kjo nuk vlen domosdo për ngacmimet seksuale dhe sulmet seksuale, ku ata kishin më pak përvojë për shkak të raportimit të ulët. Përfaqësimi i grave në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) është 27 për qind, ndërsa në Prokurorinë e Shtetit janë vetëm 31 për qind prokurore gra.⁷²

67 Mbledhja e Fokus Grupit për dhunën me bazë gjinore u mbajt më 29 shkurt 2024.

68 Po aty. Neni 19.

69 [Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), Zyra e Kryeministrit të Kosovës 2022. Faqe 26.

70 Rrjeti i Grave të Kosovës (2021). [Nga ligjet në vepra](#). Faqe 85.

71 Rrjeti i Grave të Kosovës (2024) [Barazia Gjinore: Në qendër të TI... dhe përtej një analize gjinore të digjitalizimit në Kosovë](#). Faqe 178.

72 Grupi për Studime Juridike dhe Politike (2023). [Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje](#). Faqe 13.

Nënpërfaqësimi i grave në këto entitete është një faktor shtesë që kontribuon në mungesën e perspektivës gjinore. Nënpërfaqësimi i grave në këto subjekte kontribuon edhe në mungesën e perspektivës gjinore, e cila është thelbësore për të kuptuar dhunën me bazë gjinore. Sa i përket numrit të rasteve, nga korriku i vitit 2022 deri në qershor të vitit 2023, Prokuroritë Themelore (PTH) në mbarë Kosovën kanë pranuar 3,169 raste të dhunës në familje, dhe kanë arritur të zgjidhin 3,679 raste, duke përfshirë disa raste të trashëguara.⁷³ Në fund të periudhës së sipërpërmendur, në PTH kishin mbetur 2,496 lëndë të trashëguara.

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV) është një entitet i pavarur në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, mandati i së cilës është që të sigurojë që të drejtat e viktimave të krimit janë të mbrojtura.⁷⁴ Mbrojtësit e Viktimave (MV) janë të autorizuar për të përfaqësuar ligjërisht viktimën gjatë gjithë procesit, duke përfshirë kërkesën për masa mbrojtëse dhe paraqitjen e kërkesave për kompensim.⁷⁵ MV-të mbështesin viktimat e kategorive të ndryshme të krimeve, ndërsa gratë përfaqësojnë një numër dukshëm më të lartë të viktimave që kanë nevojë për shërbimet e tyre. Grafiku i mësipërm tregon numrin e rasteve të pranuar nga ZMNV-ja në katër vitet e fundit, të ndara sipas gjinisë.⁷⁶ Për më tepër, viktimat e dhunës me bazë gjinore përfaqësojnë nga 90 për qind deri në 93 për qind të rasteve që kanë pranuar gjatë kësaj periudhë.⁷⁷ Ato gjithashtu janë të qasshme përmes një linje telefonike të ndihmës 24-orëshe, e cila është numër publik dhe pa pagesë, dhe shërben për raportimin e rasteve, si dhe për t'u ofruar telefonuesve udhëzime, informacione dhe referime. Megjithatë, ZMNV-ja ka mungesë të personelit, me 22 mbrojtës të viktimave që mbulojnë të gjithë Kosovën, dhe për shkak të burimeve të kufizuara nuk është domosdo në gjendje të sigurojë reagim të menjëhershëm.⁷⁸ Sipas raportit të IPK-së, prania e përgjithshme e MV-ve në drejtoritë rajonale të policisë në vitin 2022 ka qenë 0.4 për 10 raste të trajtuara.⁷⁹ Kjo ka qenë një rënie e ndjeshme nga viti 2021, kur ata ishin të pranishëm në 5.4 nga 10 raste. Prezencën më të ulët në vitin 2022 e ka pasur Prishtina me 0, ndërsa Mitrovica Veriore me 3.2.

73 Zyra e Prokurorit të Shtetit (n.d.). [Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave](#).

74 [Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), Zyra e Kryeministrit të Kosovës 2022. Faqe 26.

75 Të dhënat e ofruara nga Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave, Mars 2024.


76 Po aty.

77 Mbledhja e Grupit të Fokusit për dhunën me bazë gjinore u mbajt më 29 shkurt 2024.

78 Raporti i inspektimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Nëntor 2023. Faqe 12.

79 [Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), Zyra e Kryeministrit të Kosovës. 2022. Faqe 30.

Grafiku 2. Numri i grave dhe fëmijëve të strehuar në strehimoret e Kosovës 2019–2023



Qendrat për Punë Sociale (QPS) janë institucione komunale që mbështesin viktimat e dhunës në familje me qasje në shërbimet sociale dhe riintegrim. Çdo viktimitë ka një menaxher të rastit, i cili është i autorizuar të ofrojë ndihmë gjithëpërfshirëse në një gamë të gjerë shërbimesh, duke filluar nga strehimi, punësimi e deri tek asistenca sociale. Menaxheri i rastit po ashtu merr pjesë në seancat gjyqësore dhe paraqet anamnezën e rastit.⁸⁰ Nga QPS-të kërkohet që të jenë të pranishme edhe kur policia i informon për ndonjë rast të ri, por edhe reagimi i tyre është i kufizuar. Raporti i IPK-së tregon se në vitin 2022 prania e tyre e përgjithshme në drejtoritë rajonale të policisë ka qenë 3.3 për 10 raste, ku më e ulëta është shënuar në Gjilan me 0.6, ndërsa më e larta në Prishtinë me 4.8.⁸¹ Për krahasim, në vitin 2021, ata kanë qenë të pranishëm në 5.6 nga 10 raste.

Shumica e grave dhe fëmijëve që janë viktima të dhunës në familje dërgohen në një nga tetë strehimoret, të cilat janë organizata joqeveritare të kontraktuara nga qeveria për të ofruar mbrojtje dhe kujdes për viktimat.⁸² Strehimoret janë një pjesë integrale e reagimit institucional ndaj dhunës në familje, dhe roli i tyre kryesor është rehabilitimi dhe integrimi social i viktimave.⁸³ Këto strehimore ndodhen në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Novobërdë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.⁸⁴ Përveç këtyre, ekziston edhe një strehimore për viktimat e dhunës së trafikimit me njerëz, e cila drejtohet nga qeveria. Strehimoret ofrojnë strehim të përkohshëm deri në gjashtë muaj, ku viktimat mbështeten përmes procesit të rikuperimit dhe riintegrimit. Ndërmjet viteve 2019 dhe 2023, në këto strehimore janë strehuar 2,516 gra dhe fëmijë.⁸⁵ Tabela tregon ndarjen për vit. Në vitin 2023, strehimorja në Prishtinë ka pasur 148 gra dhe fëmijë, ndjekur nga ajo e Gjakovës me 125 persona, dhe e Pejës me 97 persona.⁸⁶ Strehimoret në Kosovë

80 Raporti i inspektimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Nëntor 2023. Faqe 13.

81 Zyra e Kryeministrit të Kosovës (2022). [Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#). Faqe 33 dhe 115.

82 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (2019). [Strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë](#).

83 Rrjeti i Grave të Kosovës (2023). [Pas strehimores, e pastrehë](#).

84 Ministria e Drejtësisë. (2024). [Databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje](#).

85 Po aty.

86 Zyra e Kryeministrit të Kosovës 2022. [Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#). Faqe 33 dhe 116.

strehojnë viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit, të cilat janë gra dhe fëmijë. Aktualisht nuk ka strehimore për djem mbi 13 vjeç, burra, si dhe pjesëtarë të komunitetit LGBTI+ që përjetojnë dhunë, dhe ofrimi i shërbimeve të tilla është parashikuar në strategjinë kombëtare.⁸⁷ Duke qenë se strehimoret janë OJQ, ato kanë pasur probleme me sigurimin e qëndrueshmërisë së financimit dhe shpesh kanë luftuar për t'i mbuluar operacionet e tyre. Burimet e kufizuara e kufizojnë kapacitetin dhe mundësitë për zhvillimin profesional të stafit të strehimoreve. Megjithatë, pavarësisht këtyre kufizimeve, ata vazhdojnë të ofrojnë shërbimet e parashikuara në Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.⁸⁸ Qeveria ka rritur mbështetjen për strehimoret, ku shuma e shpërndarë në vitin 2020 ka qenë pothuajse dyfishi i shumës së marrë në vitin 2016.⁸⁹ Kjo ka qenë e nevojshme me rritjen e raportimeve, duke rezultuar në rritjen e numrit të viktimave të strehuara në këto strehimore.

Reagimi i komunës ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave janë mekanizma koordinues që sjellin së bashku subjektet përkatëse në nivel komunal si reagim ndaj rasteve të tilla. Përgjegjësia kryesore e këtyre Mekanizmave Koordinues Komunalë është koordinimi i reagimit, nga identifikimi dhe referimi i rasteve deri te strehimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i viktimave të dhunës në familje.⁹⁰ Mekanizmat koordinues luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në mbështetjen e strehimoreve që ato t'i adresojnë nevojat e viktimave që strehohen aty, pasi ofrojnë qasje të lehtë të shumë palë të interesit.⁹¹ Deri më tani, ekzistojnë 20 Mekanizma Koordinues Komunalë.⁹²

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) i mbështet viktimat përmes shërbimeve ligjore, dhe tani me ligjin e ri i trajton rastet e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe të asaj në familje si një nga përfituesit e tyre. Ajo ka shtatë zyra rajonale dhe 14 mobile, katër prej të cilave mbulojnë gjashtë komuna shtesë.⁹³ Në katër vjetët e fundit, 452 gra dhe 121 burra që kanë përjetuar dhunë në familje kanë kërkuar mbështetjen e ANJF-së për shërbime të ndryshme ligjore.⁹⁴ Ndryshimet në ligj që rezultuan në përfshirjen e më shumë kategorive të kualifikuara për ndihmë ligjore juridike falas kanë reflektuar një rritje të vogël në numrin e kërkesave për mbështetje që ka marrë ANJF-ja veçanërisht në rastet e dhunës në familje. Në vitin 2020, kishte 44 raste të dhunës në familje. Në vitet 2021 dhe 2022, numri rasteve ishte 150 dhe 173, përkatësisht.⁹⁵ Në vitin 2023, pas ndryshimit ligjor, u regjistruan 206 raste të dhunës në familje, 2 raste të sulmit seksual, dhe 3 raste të ngacmimit seksual. Për më tepër, në vitin 2023, ANJF-ja filloi të mbledhë të dhëna të ndara sipas kategorive të veçanta.

87 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (2019). [Strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë](#). Faqe 13.

88 Po aty. Faqe 115.

89 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. 2022. [Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#). Faqe 24.

90 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (2019). [Strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë](#). Faqe 9.

91 Po aty. Faqe 46.

92 [Zyrat Rajonale dhe Mobile](#). Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Mars 2024.


93 Informacion nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Mars 2024.

94 Informacion nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Mars 2024.

95 Informacion nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Mars 2024.

Mbështetja me procesin e shkurorëzimit dhe të pagesave të alimentacionit janë disa nga shërbimet e kërkuara në ANJF, të cilat janë rritur në katër vjetët e fundit. Ndonëse jo të gjithë individët që kërkojnë këto shërbime janë viktime të dhunës në familje, është e rëndësishme të theksohet se gratë kërkojnë ndihmë në këto çështje shumë më tepër se burrat. Në këtë tabelë janë paraqitur kërkesat për mbështetje nga ANJF-ja për shkurorëzim dhe pagesa alimentacioni në katër vjetët e fundit, të ndara sipas gjinisë.⁹⁶

Grafiku 3. Numri i grave dhe burrave që marrin shërbime nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas për shkurorëzim dhe pagesa të alimentacionit



Megjithatë, një nga problemet është se nuk ka ndërgjegjësim të mjaftueshëm për ANJF-në dhe shërbimet që ajo ofron. Të dhënat e anketës tregojnë se 78 për qind e të anketuarve përbëheshin nga gra dhe të rinj të cilët kanë pohuar se nuk kanë dëgjuar kurrë për të.⁹⁷

Gjykatat i trajtojnë rastet e dhunës në familje, duke përfshirë procedurat penale dhe civile. Gratë janë gjithashtu të nënpërfaqësuar në nivelet vendimmarrëse në gjykata, gjë që ndikon në aftësinë për të përfshirë perspektivën gjinore në çështjet me të cilat përballen. Në nivelet vendimmarrëse të Këshillit

96 Opinion Publik për Shërbimet e Ndihmës Juridike Falas për Gratë dhe të Rinjtë e Kosovës, Fondacioni Jahjaga. 2021

97 Rrjeti i Grave të Kosovës (2024). [Barazia Gjinore: Në qendër të Tl... dhe përtej një analize gjinore të digitalizimit në Kosovë](#). Faqe 184 dhe 186.

Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Gjykatës, 31 për qind janë gra.⁹⁸ Sa i përket numrit të rasteve, nga korriku i vitit 2022 deri në prill të vitit 2023, Gjykatat Themelore në mbarë Kosovën kanë pranuar 625 raste të dhunës në familje, shumica e të cilave kanë shkuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës (258 raste), pasuar nga Gjykata Themelore në Pejë (91) dhe Gjykata Themelore në Gjiilan (82).⁹⁹ Gjykatat janë kritikuar nga subjekte të ndryshme për trajtim joadekuat të rasteve të dhunës me bazë gjinore, dhe në veçanti të dhunës në familje. Trajtimi adekuat i rasteve përfshin dënime të drejta, të cilat do të siguronin drejtësi për viktimën dhe do të shërbenin si parandalues për kryesit e mundshëm. Megjithatë, dënimet shpesh konsiderohen joadekuate në krahasim me shkëlqen penale. Pas shqyrtimit të 218 rasteve, Amnesty International zbuloi se “74 për qind e kryerësve kanë marrë dënim me burg të kushtëzuar, 45 për qind janë gjobitur dhe kanë marrë një gjobë të pezulluar.”¹⁰⁰ Gjithashtu, kjo analizë zbuloi se në gjashtë raste të dhunës ndërmjet partnerëve intimë, të dy janë dënuar si kryes të veprës, edhe pse në të gjitha këto raste gruaja ka qenë viktimja e parë dhe reagimi i dhunshëm mund të ishte cilësuar si vetëmbrojtje.¹⁰¹

Qasja në reparacione është e ulët. Derisa ligji siguron që viktimat e dhunës në familje të kenë të drejtën e kompensimit të menjëhershëm, në praktikë, shumica e të mbijetuarve nuk kanë marrë dëmshpërblime. Raporti i Amnesty International zbuloi se gjykatat nuk kanë ofruar dëmshpërblim në procedurat penale në 197 vendime gjyqësore të shqyrtuara.¹⁰² Për më tepër, shumica dërrmuese e të mbijetuarve nuk kanë aplikuar për kompensim, për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit dhe mungesës së mbështetjes ligjore. Kur 5.1 për qind e të mbijetuarve në këto raste kanë kërkuar dëmshpërblim për çështjet e tyre penale, gjykatat i kanë referuar në gjykatën civile.¹⁰³

Riintegrimi i viktimave të dhunës në familje, veçanërisht përmes strehimit dhe punësimit, mbetet sfida.¹⁰⁴ Mungesa e pavarësisë ekonomike shumë herë i vë viktimat në një pozitë, ku kthimin tek abuzuesit e shohin si zgjidhjen e tyre të vetme. Për më tepër, kushtet ekonomike janë një faktor i rëndësishëm se pse gratë e justifikojnë dhe tolerojnë dhunën.¹⁰⁵ Ato shpesh nuk kanë bazë solide ekonomike për shkak të hezitimit për ta përdorur të drejtën e tyre për trashëgimi nga familjet e tyre dhe të drejtën për pronësi të përbashkët me bashkëshortët e tyre.¹⁰⁶ Si rezultat, punësimi është imperativ për fuqizimin e viktimave për t’u shkëputur nga rrethi i dhunës. Në dhjetor 2023, Qeveria e Kosovës vendosi një masë për subvencionimin e 70 për qind të pagës bruto (deri në €300) për një periudhë gjashtëmujore për të mbijetuarat e dhunës në familje, në përpjekje për t’i mbështetur ato drejt pavarësisë ekonomike.¹⁰⁷ Për të aplikuar për këtë masë, të mbijetuarat duhet ta telefonojnë pa pagesë¹⁰⁸ Ministrinë e Drejtësisë, e cila më

98 Grupi për Studime Juridike dhe Politike (2023). [Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje](#). Faqe 20.

99 Amnesty International (2023). [Nga letra në praktikë: Kosova duhet t’i mbajë zotimet e saj ndaj të mbijetuarve të dhunës në familje – Përmbledhje Ekzekutive](#). Faqe 5.

100 Po aty. Faqe 6.

101 Po aty. Faqe 6.

102 Amnesty International (2023). [Nga letra në praktikë: Kosova duhet të mbajë zotimet e saj ndaj të mbijetuarve të dhunës në familje – Përmbledhje Ekzekutive](#). Faqe 6.

103 Mbledhja e Fokus Grupit për dhunën në baza gjinore u mbajt më 29 shkurt 2024.

104 Bërxulli D., Gashi, A., Gusia, E. (2023) Determinants of Women’s Tolerant Attitudes toward Gender-Based Violence against Women in Kosovo”, *Psychological Thought*, vëll. 16 (2), 389-405. <https://doi.org/10.37708/psyct.v16i2.865>. Faqe 399.

105 Po aty. Faqe 390.

106 Informacioni i marrë nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.

107 Numri pa pagesë për të kontaktuar për të përfituar nga kjo masë është 080010010.

108 Informacioni i marrë nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.

pas do t'i udhëzojë ato të regjistrohen në Zyrën e Punësimit brenda komunave të tyre si punëkërkuese, jo si të mbijetuara. Pas regjistrimit, Ministria e Drejtësisë kontrollon bazën e të dhënave të tyre për të konfirmuar nëse personi me të vërtetë ka përjetuar dhunë në familje, dhe më pas informacioni i tyre ndahet me pikën kontaktuese në Agjencinë për Punësim në Republikën e Kosovës (APRK), e cila përmes zyrave komunale të punësimit përpiqet të lidhë individin me një punëdhënëse. Deri më tani nga kjo masë kanë përfituar 14 gra.¹⁰⁹

Incidenca e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave

Gratë dhe vajzat mbeten caku kryesor i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në Kosovë. Normat tradicionale gjinore e kanë normalizuar historikisht dhunën si pjesë e disiplinimit të grave dhe vajzave, dhe e kanë konsideruar këtë si një çështje që duhet menaxhuar brenda shtëpisë.¹¹⁰ Për më tepër, e ndikuar nga normat gjinore, dhuna ndaj grave shpesh mund të nënçmohet nga vetë gratë. Të dhënat e anketës tregojnë se 35 për qind e grave besojnë se dhuna është provokuar nga viktima dhe 32 për qind e tyre thonë se gratë që përjetojnë dhunë shpesh i ekzagjerojnë ose i shpikin pretendimet për abuzim. Kjo ka çuar në nënraportim të rasteve, të cilat nuk pasqyrojnë se sa i përhapur është problemi. Megjithatë, disa tregues mund të gjenden në një anketë që tregon se 54 për qind e të gjitha grave kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga një partner intim që nga moshja 15 vjeç.¹¹¹ Të dhënat e IPK-së tregojnë se 81.5 për qind e viktimave të dhunës në familje të vitit 2022 kanë qenë gra, ndërsa 47 për qind e viktimave kanë përjetuar dhunë nga bashkëshortët e tyre, ndërsa 11 për qind e tyre nga partneri me të cilin jetonin.¹¹²


109 Agjencia për Barazi Gjinore. (2020). [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#). Faqe 10.

110 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (2019). [Anketa për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë](#). Faqe 8.

111 Raporti i inspektimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Nëntor 2023. Faqe 8.

112 Të dhënat e siguruar nga Drejtoria për Parandalimin dhe Hetimin e Dhunës në Familje e Policisë së Kosovës, 2024.

Grafiku 4. Rastet e dhunës në familje të raportuara në Policinë e Kosovës



Grafiku tregon numrin e rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës.¹¹³ Prishtina është rajoni me nivelin më të lartë të raportimit, me pothuajse tri herë më shumë raste se qytetet që e ndjekin, Prizreni dhe Peja.¹¹⁴ Kjo nuk reflekton domosdo se ka përhapje më të lartë të dhunës në Prishtinë. Një gjë e tillë më tepër e reflekton numrin më të madh të njerëzve në këtë rajon, dhe mundësitë më të larta për punësim dhe arsimim, të cilat kontribuojnë në rritjen e raportimit.¹¹⁵

Siç mund të shihet nga grafiku, e po ashtu edhe nga të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, viti 2022 shënon numrin më të lartë të rasteve të dhunës në familje në pesë vjetët e fundit.¹¹⁶ Grupmosha me numrin më të lartë të rasteve të raportuara është 30–40 vjeç, e pasuar nga grupmoshat 20–30 vjeç dhe 40–50 vjeç.¹¹⁷ Midis viteve 2019 dhe 2023, Policia e Kosovës ka lëshuar gjithsej 338 urdhra për mbrojtje të përkohshme, ku vetëm vitin e fundit janë lëshuar 121 sosh.¹¹⁸ Në të njëjtën periudhë, 23 gra janë vrarë si pasojë e dhunës në familje.¹¹⁹

Të dhënat nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) tregojnë se në vitin 2022 ekspozimi ndaj dhunës në familje ka qenë 1.56 raste për 1000 banorë, dhe 0.25 raste për 1 km².¹²⁰ Komuna me më së shumti raste për 1000 banorë ka qenë Fushë Kosova me 3.62 raste, ndërsa më e ulëta ka qenë Juniku me 0.31 raste. Në këtë linjë, komuna me numrin më të madh të rasteve për 1 km² ka qenë Mitrovica e Veriut me 3.09 raste, ndërsa me numrin më të vogël ka qenë komuna e Zubin Potokut me 0.01 raste.

113 [Databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje](#). Ministria e Drejtësisë. Mars 2024.

114 Mbledhja e Fokus Grupit për dhunën në baza gjinore u mbajt më 29 shkurt 2024.

115 Ministria e Drejtësisë (2024). Databaza për dokumentimin e rasteve të dhunës në familje

116 [Databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje](#). Ministria e Drejtësisë. Mars 2024.

117 Po aty.

118 Po aty.

119 Raporti i inspektimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Nëntor 2023. Faqe 6.

120 Mbledhja e Fokusit Grupit për grupet e marginalizuara në Kosovë u mbajt më 27 shkurt 2024.

Të dhënat e siguruara për dhunën me bazë gjinore janë mjaft binare, dhe kur i referohemi dhunës ndaj grave, ato përfshijnë vetëm gratë heteroseksuale.¹²¹ Duke vepruar kështu, ato përjashtojnë komunitetet LGBTI+ nga diskursi, dhe rrjedhimisht nga strategjitë për mbrojtjen e tyre nga dhuna me bazë gjinore.

Ngacmimet seksuale, sulmet seksuale dhe ndjekja

Ngacmimi seksual, siç përkufizohet në Kodin Penal të Kosovës, nënkupton “cilëndo formë të sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të natyrës seksuale, me qëllim të cenimit të dinjitetit apo që cenon dinjitetin e personit, dhe krijon një mjedis i cili është objektivisht frikësues, armiqësor, degradues ose poshtërues”.¹²² Është një shkelje e dënueshme me gjobë ose deri në tre vjet burg, e cila mund të jetë më e lartë nëse krimi është kryer në rrethana specifike më të rënda, siç theksohet në Kod. Megjithatë, ngacmimi seksual është i nënraportuar dhe përhapja e tij nuk mund të matet. Të dhënat e anketës tregojnë se 29 për qind e grave kanë përjetuar ngacmime seksuale.¹²³ Gjatë eksplorimit të nivelit të ngacmimit në vendin e punës, të dhënat e anketës treguan se vetëm 9 për qind e grave e kishin këtë përvojë, e cila ka qenë kryesisht në formë të vërejtjeve verbale të natyrës seksuale dhe komenteve të papërshtatshme.¹²⁴ Ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, Policia e Kosovës ka pranuar 84 raportime për ngacmime seksuale, 77 nga gratë dhe 7 nga burrat.¹²⁵ Këto të dhëna tregojnë se si ngacmimi seksual mbetet një nga format më të nënraportuara të dhunës me bazë gjinore.

Në vitin 2020, Qeveria e Kosovës miratoi Politikën kundër Ngacmimit Seksual në Organet e Administratës Publike të Republikës së Kosovës.¹²⁶ Kjo politikë udhëzon entet e nivelit qendror dhe lokal të administratës publike mbi masat që duhet të marrin për t'i parandaluar dhe trajtuar ngacmimet seksuale në vendin e punës. Ajo gjithashtu përcakton mekanizmat e raportimit, ku ndër të tjera u lejon individëve të raportojnë rastin e tyre përmes një përfaqësuesi të autorizuar nëse nuk mund ta raportojnë vetë.¹²⁷ Kjo politikë ka qenë një pikënisje e mirë, por kishte nevojë për një vazhdim që do të shërbente si udhëzues hap pas hapi për menaxhimin e rasteve. Në vitin 2023, Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit publikoi Manualin për Zbatimin e Politikës Kundër Ngacmimit Seksual në Administratën Publike të Republikës së Kosovës.¹²⁸ Ky manual gjithashtu nuk ofron një udhëzues hap pas hapi që njësitë e ndryshme të mund ta përdorin gjatë menaxhimit të rasteve, veçanërisht sa i përket hetimit të çështjeve të tilla.

121 Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës. (2019). [Kodi nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës](#). Neni 183.2. Faqe 74.

122 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (2019). [Anketa për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë](#). Faqe 8.

123 [Siguria dhe Shëndeti në Punë: Një studim i rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës në Kosovë në sektorin publik dhe privat](#). UN Women dhe IDRA. Mars 2023. Faqe 46.

124 Të dhënat e siguruara nga Policia e Kosovës, Mars 2024.

125 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. (2020). [Politika kundër Ngacmimit Seksual në Organet e Administratës Publike të Republikës së Kosovës](#).

126 Po aty. Neni 6.

127 Manuali për Zbatimin e Politikës kundër Ngacmimit Seksual në Organet e Administratës Publike të Republikës së Kosovës. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës (2023).

128 Informacioni i siguruar nga UN Women Kosova, 2024.

Ndërmjet viteve 2022 dhe 2023, ABGj-ja dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), me mbështetjen nga UN Women Kosova, trajnuan mbi 350 shërbyes publikë nga niveli qendror dhe lokal.¹²⁹ Për të gjithë pjesëmarrësit, ky ishte trajnimi i parë që e trajtonte këtë çështje, dhe me përjashtim të disa individëve, askush nuk ishte në dijeni për politikën qeveritare në fuqi. Pjesëmarrësit deklarorin se nuk kishin pasur raste të raportuara të ngacmimeve seksuale në institucionet e tyre, por shumë prej tyre kishin dëgjuar për raste të tilla jozyrtarisht. Nëse dikush përjeton ngacmim seksual, sipas politikës, duhet ta raportojë atë të mbikëqyrësi. Nëse ngacmuesi është mbikëqyrësi, atëherë ata mund t'i drejtohen autoritetit më të lartë ose Zyrtarit për Personel. Në varësi të situatës, personi që merr denoncimin mund ta menaxhojë vetë ose të iniciojë procedura që rasti të trajtohet nga komisioni disiplinor. Në çdo rast, pa udhëzim dhe trajnim hap pas hapi, atyre u mungojnë kapacitetet për të trajtuar çështje të tilla të ndjeshme.

Një nga çështjet e rëndësishme është se ngacmimi seksual dhe sulmi seksual shpesh ngatërrohen dhe trajtohen si të njëjtë. Edhe prokurorët priren t'i ngatërrojnë këta të dy.¹³⁰ Një hulumtim ka treguar se shumica e gjyqtarëve të intervistuar nuk ishin në dijeni se sipas Kodit të ri Penal ngacmimi seksual është vepër penale dhe nuk e përmendën dhunën seksuale si formë të dhunës në baza gjinore.¹³¹ Midis viteve 2020 dhe 2023, ka pasur 63 raportime për sulme seksuale, 56 nga gratë dhe 7 nga burrat.¹³²

Ndjekja është një formë tjetër e dhunës me bazë gjinore, e cila gjithashtu raportohet më pak. Të dhënat e anketës tregojnë se 8 për qind e grave përjetojnë ndjekje, në formën e thirrjeve, ndjekjes së qëllimshme dhe mesazheve.¹³³ Një çështje tjetër e ngritur me rritjen e përdorimit të mediave sociale është dhuna kibernetike në formën e joshjes së viktimave për të hapur linqe të ndryshme ose për të dërguar foto, të cilat më pas keqpërdoren ose përdoren për t'u bërë shantazh atyre.¹³⁴ Gratë janë shënjestrat dhe viktimat kryesore të këtyre krimeve, dhe disa prej tyre që kanë raportuar raste të tilla në Policinë e Kosovës kanë pohuar se nuk janë trajtuar seriozisht, por në radhë të parë janë fajësuar për ndarjen e fotografive.¹³⁵ Megjithatë, të dhënat e anketës tregojnë se Policia e Kosovës mbetet autoriteti i parë tek i cili dikush drejtohet nëse ndihet i kërcënuar, siç është raportuar nga 57 për qind e grave të anketuara.¹³⁶

129 Rrjeti i Grave të Kosovës (2021). [Nga ligjet në vepra](#). Faqe 80.

130 Po aty. Faqe 91.

131 Të dhënat e siguruara nga Policia e Kosovës, mars 2024.

132 [Anketa për Mirëgenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë](#). Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. 2019. Faqe 44.

133 Rrjeti i Grave të Kosovës (2024). [Barazia Gjinore: Në qendër të TI... dhe përtej një analize gjinore të digjitalizimit në Kosovë](#). Faqe 175.

134 Po aty. Faqe 176.

135 Rrjeti i Grave të Kosovës (2024). [Barazia Gjinore: Në qendër të TI... dhe përtej një analize gjinore të digjitalizimit në Kosovë](#). Faqe 207.

136 Të dhënat e siguruara nga Policia e Kosovës, Mars 2024.

Programet për rehabilitimin e kryerësve të dhunës

Midis viteve 2020 dhe 2023, 2,566 burra dhe 25 gra u arrestuan për dhunë në familje.¹³⁷ Në vitin 2022, numri i personave të ndaluar për 10 raste të dhunës në familje ishte 3.9, që tregon një rritje nga viti 2021, kur ishte 2.5.¹³⁸ Numri më i madh ishte në Gjakovë me 5.8 persona të ndaluar për 10 raste, ndërsa më i ulët ishte në Mitrovicën e Jugut me 1.8. Shumica e kryesve të dhunës në familje janë burra. Në vitin 2023, 86.40 për qind e kryesve ishin meshkuj, ndërsa 13.6 për qind femra.¹³⁹ Shumica e këtyre kryesve të dhunës ishin nga rajoni i Prishtinës, pasuar nga Prizreni dhe Peja. Për sa i përket grupmoshës, shumica e kryesve të dhunës janë nga 30 deri në 40 vjeç, të ndjekur nga 20 deri në 30 vjeç dhe nga 40 deri në 50 vjeç.¹⁴⁰

Neni 16 i Konventës së Stambollit kërkon që vendet të hartojnë dhe zbatojnë programe për rehabilitimin e kryerësve të dhunës si një mjet për të transformuar qëndrimet dhe sjelljen e autorëve në një përpjekje për të parandaluar dhunën e mundshme në të ardhmen.¹⁴¹ Fillimisht ka pasur: 1) dy iniciativa eksperimentale për programet e rehabilitimit të kryerësve të dhunës, të zbatuara nga Shtëpia e Sigurt në Gjakovë dhe Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime – SIT në Prishtinë; 2) disa programe të menaxhimit të zemërimit të disponueshme në burg, por pa specifika për kryerësit e dhunës në familje, dhe 3) qasje të kufizuara në institucionet shëndetësore që ofrojnë trajtim.¹⁴² Në vitin 2022 u miratuan kurrikulat për trajnimin e profesionistëve në ofrimin e programeve për kryerësit e dhunës në familje. Këto planprograme ofrojnë një kuadër gjithëpërfshirës për punën me kryerësit e dhunës në familje.¹⁴³ Duke u bazuar në këto planprograme, në Qendrën Korrektuese në Dubravë është lansuar Programi Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave, i cili do të shërbejë si pilot.¹⁴⁴ Ky program mbulon 10 module të zbatuara përgjatë 24 sesioneve.¹⁴⁵

Trafikimi me njerëz

Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit mbulon parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit me njerëz si dhe asistencën dhe mbrojtjen e viktimave.¹⁴⁶ Në vitin 2021, u miratuan Procedurat e reja Standarde të Veprimit për Personat e Trafikuar në Kosovë, me masa specifike që duhet të ndërmerren në të gjitha fazat.¹⁴⁷ Në vitin 2022, Qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë Kombëtare kundër Trafikimit 2022–2026 dhe Planin Kombëtar të

137 Raporti i inspektimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, (2023). Faqe 11.

138 Ministria e Drejtësisë (2024). [Databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje](#).

139 Po aty.

140 Oddone, C and Morina, D. [Implementing perpetrator programmes in Kosovo* Policy Brief](#). Këshilli i Evropës. 2023. Faqe 2.

141 Po aty. Faqe 3.

142 Ministria e Drejtësisë (2022). [Curricula for training professionals in offering programs for perpetrators of domestic violence](#).

143 Ministria e Drejtësisë (2024). [National Program for Treatment of Perpetrators of Violence](#).

144 Këshilli i Evropës (2024). [National Program for Treatment of Perpetrators of Violence - Leaflet](#).

145 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2013). [Ligji nr. 04/I218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit](#).

146 Ministria e Punëve të Brendshme (2021). [Procedurat Standarde të Veprimit për Personat e Trafikuar në Kosovë](#).

147 Ministria e Punëve të Brendshme (2022). [Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit 2022-2026 dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2022-2024](#). Faqe 11.

Veprimet 2022–2024. Strategjia ka pesë objektiva duke përfshirë forcimin e mekanizmave institucionalë, parandalimin, përmirësimin e shërbimeve për viktimat, hetimin dhe ndjekjen penale të trafikantëve, si dhe bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar.¹⁴⁸

Policia e Kosovës ka Drejtori për Trafikim me Qenie Njerëzore, e cila i heton rastet e trafikimit me qenie njerëzore.¹⁴⁹ Në vitin 2022, Policia e Kosovës ka hetuar 16 raste të trafikimit, 14 raste të trafikimit për eksploatim seksual dhe dy raste për motive punësimi, ku gjithsej kishte 39 të dyshuar.¹⁵⁰ Në vitin 2022, kishte 21 viktima, 17 për trafikim seksual dhe katër për trafikim për motive punësimi. Në mesin e këtyre viktimave ishin 14 vajza, gjashtë gra dhe një burrë.¹⁵¹

Kodi Penal i Kosovës e ka kriminalizuar trafikimin me qenie njerëzore, duke përfshirë këtu lehtësimin ose detyrimin e prostitucionit, përdorimin e shërbimeve seksuale të viktimës së trafikimit dhe mbajtjen e dokumenteve identifikuese të viktimave të skllavërisë ose trafikimit.¹⁵² Megjithatë, shqiptimi i ndëshkimeve nuk ka qenë në përputhje me kodin. Një raport i Departamentit të Shtetit të ShBA-së ka zbuluar që “gjyqtarët kanë vazhduar të shqiptojnë dënime nën dënimin minimal prej pesë vjetësh burgim” dhe se “gjykatat nuk kanë zvogëluar numrin e përgjithshëm të rasteve të grumbulluara (backlog) të trafikimit”.¹⁵³

Ekziston vetëm një qendër e licencuar për të ofruar ndihmë për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, e cila është OJQ Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (MVPT).¹⁵⁴ “Midis viteve 2015 dhe 2020, MVPT-ja kishte ofruar rehabilitim për 187 përfitues (40 të rritur dhe 147 fëmijë), nga të cilët 101 ishin banorë në qendër dhe 86 frekuentonin qendrën në baza ditore pa qenë banorë atje”.¹⁵⁵

148 Policia e Kosovës. Arritur në mars 2024. [Departamenti i Hetimeve](#).

149 Zyra për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz. Departamenti Amerikan i Shtetit (2023). [2023 Trafficking in Persons Report: Kosovo](#).

150 Po aty.

151 Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (Janar 2019). [Kodi nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës](#). Neni 166, 228 dhe 234.

152 Po aty.

153 [Raporti i dytë për përputhshmërinë e Kosovës me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore](#). GRETA. Këshilli i Evropës. Tetor 2021. Faqe 27.

154 Po aty.

155 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2008). [Ligji 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues](#).

PROMOVIMI I SHËNDETIT DHE TË DREJTAVE SEKSUALE DHE RIPRODHUESE

Ligji për Shëndetin Riprodhues ndër të tjera mbulon qasjen në informacion, planifikimin familjar, riprodhimin e asistuar, infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS.¹⁵⁶ Megjithatë, tema në vetvete është ende tabu në Kosovë, veçanërisht në zonat rurale. Sipas raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP) për shëndetin seksual dhe riprodhues, Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), së bashku me kujdesin dytësor dhe tretësor, janë përgjegjëse për ofrimin e informacionit për pacientët lidhur me këtë temë. Mirëpo, kjo bëhet më së shumti përmes konsultimeve të drejtpërdrejta me mjekët për shëndetin e tyre, dhe jo përmes takimeve të posaçme me fokus edukimin seksual.¹⁵⁷ Teksa qasja në informacion mund të jetë e kufizuar, qasja në shërbimet profesionale konsiderohet e lartë. Përqindja e grave të moshës 15–49 vjeç me lindje të gjallë në dy vjetët e fundit, lindja e fundit e të cilave është përcjellë nga personel i kualifikuar shëndetësor është 99.5 për qind.¹⁵⁸

Qasja në produktet e higjienës menstruale ka qenë çështje e debatit publik, me organizatat e shoqërisë civile që avokojnë që këto produkte të lirohen nga taksat. Gratë vlerësohet se shpenzojnë €56 në vit për këto produkte, përfshirë edhe tatimin mbi vlerën e shtuar prej 18 për qind, që e shton barrën financiare për gratë, të cilat veçse janë të nënpërfaqësuar në tregun e punës.¹⁵⁹

Edukimi seksual, përdorimi i kontraktivëve dhe lindjet e adoleshentëve

Edukimi seksual nuk mësohet në asnjë nivel të arsimit formal në Kosovë, për shkak të mentalitetit dhe stigmatizimit që vjen prej tij. Si rezultat, ka mungesë informacioni për të. Të dhënat e sondazhit tregojnë se vetëm 40 për qind e të rinjve përdorin kontraktivë, që është dukshëm më e ulët se bashkëmoshatarët e tyre në Evropë, 71 për qind

156 Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës (2021). [Raporti Ex Officio nr. 577/2021 për shëndetin seksual dhe riprodhues](#). Faqe 49.

157 "Anketa e Treguesve të Shumëfishtë në Kosovë (MICS) 2019-2020", UNICEF, faqe 13.

158 Beka, Elirjeta (2024). [Policy Brief: Menstruation isn't a luxury. Why are we taxing it?](#) Kosovo Women's Network. Page 2.

159 Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sporteve (2024). [Strategjia Shtetërore për Rininë 2024-2032](#). Faqe 11.

e të cilëve përdorin mbrojtje.¹⁶⁰ Ka pasur përpjekje nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe UNFPA-ja për ngritjen e kapaciteteve të mësimit në menaxhimin e këtij diskutimi. Në mënyrë të veçantë, u zhvillua një Doracak i caktuar për Mësimit për Edukimin Gjithëpërfshirës Seksual, i cili mbulon informacione të përshtatura për nivele të ndryshme të arsimit fillor dhe të mesëm.¹⁶¹ Megjithatë, shumica e mësimit dhe prindërve refuzojnë shpërndarjen e kësaj përmbajtjeje të nxënësit e këtyre niveleve.

Sipas MICS-it, duke parë metodat e përdorura nga gratë që aktualisht janë të martuara ose në lidhje, tërheqja është metoda kryesore e përdorur si kontracepsion, e ndjekur nga pajisjet intrauterine, prezervativët për burra dhe pilulat.¹⁶² Në anën tjetër, 33.3 për qind e tyre kanë raportuar se nuk përdorin metoda për mbrojtje, dhe kjo përqindje është pak më e lartë në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, 37.9 për qind e të cilëve nuk përdorin asnjë metodë.¹⁶³ Në përgjithësi, përqindja e grave të moshës riprodhuese (15–49 vjeç) të cilat kanë nevojë për planifikim familjar të plotësuar me metoda moderne është 12.5 për qind.¹⁶⁴ Sa u përket lindjeve të adoleshentëve, shkalla e lindjeve tek adoleshentët në Kosovë është 13 lindje për 1000 gra, ndërsa shkalla në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është 78.¹⁶⁵

Kontraktivët janë pjesë e listës së barnave esenciale në Kosovë dhe janë në dispozicion falas në barnatoret e qendrave kryesore të mjekësisë familjare me receta të mjekut. Megjithatë, ato nuk janë gjithmonë në dispozicion sepse mund të mos porositen fare ose të mos jenë në sasi të mjaftueshme për t'i përmbushur nevojat.¹⁶⁶ Përveç furnizimit të ulët, ka pasur disa raste të diskriminimit, ku farmacistët u kanë thënë pacientëve nga minoritetet etnike se nuk kanë kontraktivë në stok, por kur të njëjtët pacientë kanë ardhur me përfaqësues të shoqërisë civile, kontraktivët janë vënë në dispozicion.¹⁶⁷

Pilulat kontraktive emergjente janë një formë alternative e parandalimit të shtatzënisë dhe mund të blihen pa receta të mjekut. Kjo i përjashton profesionistët nga udhëzimi i grave në vendimet e tyre, duke rritur njëkohësisht rrezikun e shtatzënisë të padëshiruara për shkak të efektit të tyre të kufizuar.¹⁶⁸ Shkalla e përdorimit të tyre nuk mund të përcaktohet, por shqetësimet për tejkalimin e niveleve të rekomanduara po rriten gjithnjë e më shumë.

160 Po aty. Faqe 50.

161 UNICEF (2020). [Anketa e Treguesve të Shumëfishtë në Kosovë \(MICS\) 2019-2020](#). Faqe 118.

162 UNICEF (2020). [Anketa e Treguesve të Shumëfishtë në Kosovë \(MICS\) 2019-2020](#). Faqja 118 dhe 122.

163 UNICEF (2020). [Anketa e Treguesve të Shumëfishtë në Kosovë \(MICS\) 2019-2020](#). Faqe 120

164 UNICEF (2020). [Anketa e Treguesve të Shumëfishtë në Kosovë \(MICS\) 2019-2020](#). Faqe 105-106.

165 Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës (2021). [Raporti Ex Officio nr. 577/2021 për shëndetin seksual dhe riprodhues](#). Faqe 66.

166 Po aty.

167 Informatat e siguruar nga Sekretariati i Shoqatës së Obstetërve dhe Gjinekologëve të Kosovës.

168 [Ligji nr. 03/L-110 për Ndërprerjen e Shtatzënisë](#). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Shkurt 2009. Faqe 2,4

Aborti

Në Kosovë, gratë kanë të drejtë të abortojnë. Kjo e drejtë përcaktohet në Ligjin nr. 03/L-110 për Ndërprerjen e Shtatzënisë. Sipas këtij ligji, gratë mund ta ndërpresin shtatzëninë për shkak të zgjedhjes së tyre (neni 5) ose për shkak të arsyeve mjekësore (neni 15).¹⁶⁹ Megjithatë, sipas nenit 14, abortimi selektiv për shkak të gjinisë është i ndaluar. Abortet duhet të bëhen nga profesionistë të licencuar të obstetrikës dhe gjinekologjisë dhe pacientëve duhet t'u ofrohet kujdes specifik para dhe pas procesit. Megjithatë, kjo nuk ndodh gjithmonë. Sipas raportit për shëndetin seksual dhe riprodhues të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, shumë pacientë që kanë përfunduar shtatzëninë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), kanë marrë trajtim të padinjitetshëm dhe të pandjeshëm, gjë që e ka bërë përvojën edhe më traumatizuese.¹⁷⁰ Në përgjithësi, aborti mund të kryhet në klinika private dhe publike. Megjithatë, për shkak të mungesës së një sistemi që mbledh të dhëna nga të gjitha këto entitete dhe për shkak të ndjeshmërisë së çështjes, nuk ka statistika gjithëpërfshirëse mbi numrin total të aborteve.

Zbulimi i hershëm i kancerit të qafës së mitrës dhe gjirit

Hulumtimi i kryer për raportin mbi shëndetin seksual dhe riprodhues të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës tregon se shumica e grave nuk bëjnë PAP teste të rregullta, ku 44 për qind e të anketuarve thonë se nuk e kanë bërë kurrë një të tillë dhe 37 për qind thonë se e kanë bërë.¹⁷¹ Shumica dërrmuese e atyre që bëjnë PAP testet 76 për qind, i bëjnë në sektorin privat, ndërsa 24 për qind e tyre i bëjnë në sektorin publik. Nga ata që nuk e kishin bërë PAP testin, 64 për qind thanë se nuk kishin nevojë, 30 për qind pohuan se nuk kishin ndonjë informacion, ndërsa 6 për qind pohuan se ndienin turp. "Që nga viti 2016 mbi 15 mijë gra i janë nënshtruar PAP testit dhe sipas rezultateve të marra disa janë referuar për analiza shtesë ose trajtim sipas nevojës. Në vitin 2023, 94 gra (4.2 për qind) nga 2,246 që iu nënshtruan testit PAP rezultuan pozitive për qelizat epiteliiale jonormale dhe më pas u referuan për teste dhe trajtim të mëtejshëm."¹⁷²

Hulumtimi i IAP-së zbuloi se 61 për qind e të anketuarve nuk kishin bërë kurrë mamografi ose ultrazë të gjirit dhe vetëm 18 për qind kishin bërë. Pjesa e mbetur prej 21 për qind pohuan se nuk kishin informata. Nga të anketuarit që nuk i kanë bërë këto analiza, 64 për qind e tyre kanë thënë se nuk kanë nevojë, ndërsa 36 për qind e tyre kanë pohuar se nuk kanë informacion për të.

169 Institucioni i Avokatit Popullit të Kosovës (2021). [Raporti Ex Officio nr. 577/2021 për shëndetin seksual dhe riprodhues](#). Faqe 71-72.

170 Institucioni i Avokatit Popullit të Kosovës (2021). [Raporti Ex Officio nr. 577/2021 për shëndetin seksual dhe riprodhues](#). Faqe 54.

171 [Empowering Women's Health: Milestones and Collaborative Efforts in Cervical Cancer Prevention in Kosovo](#). UNFPA Kosovë. Janar 2024.

172 Raçi, PZ, Raçi, F. & Hadri, T. [Kosovo women's knowledge and awareness of human papillomavirus \(HPV\) infection, HPV vaccination, and its relation to cervical cancer](#). BMC Women's Health 21, 354 (2021). Faqe 1.

Vaksinat kundër HPV-së

Virusi i Papillomës Njerëzore (HPV) është një infeksion i zakonshëm seksualisht i transmetueshëm që përbën rrezik për zhvillimin e kancerit të qafës së mitrës. Një studim i bërë për HPV-në në Kosovë dhe lidhjen e tij me kancerin e qafës së mitrës, tregon se përhapja e përgjithshme e HPV-së është 13.1 për qind.¹⁷³ Megjithatë, ka mungesë informacioni për të dhe rreziqet e tij. Shumica dërrmuese e të anketuarve të këtij studimi (66.4 për qind) nuk kishin asnjë informacion për HPV-në dhe vetëm 27.6 për qind e tyre e dinin që HPV-ja mund të çonte në kancer të qafës së mitrës. Fatmirësisht, ekziston një vaksinë kundër HPV-së, por siç tregon studimi, 70.1 për qind e të anketuarve nuk ishin në dijeni për të. Kjo vaksinë nuk ishte në dispozicion në Kosovë deri në vitin 2022, kur Qeveria e Kosovës prokuroi kontigjentin e parë prej 300 vaksinash kundër HPV-së që do të përdorehin për vajzat nga moshë 12 deri në 26 vjeç.¹⁷⁴ Vakcina kundër HPV-së është shtuar në Planin e Veprimtimit për Vaksinimin 2022–2025.¹⁷⁵

Shëndeti seksual dhe riprodhues i grave me aftësi të kufizuara

Gratë me aftësi të kufizuara hasin në sfida të ndryshme kur qasen në shërbimet e kujdesit shëndetësor, veçanërisht në ato që lidhen me shëndetin seksual dhe riprodhues. Për shkak të mungesës së interpretuesve të siguruar nga qeveria, gratë me aftësi të kufizuara në dëgjim duhet të mbështeten tek anëtarët e familjes për interpretim në gjuhën e shenjave¹⁷⁶, dhe kjo ngre shqetësime në lidhje me privatësinë dhe saktësinë e informacionit të transmetuar. Ka pasur raste kur gratë me aftësi të kufizuara fizike kanë hasur në stigmatizim dhe trajtim të papërshtatshëm në vizitën gjinekologjike, ku u është thënë se nuk duhet të mbesin shtatzënë për shkak të aftësisë së kufizuar, pa bërë asnjë analizë apo ekzaminim të mëtejshëm.¹⁷⁷

HIV/AIDS dhe IST

Rasti i parë me HIV/AIDS në Kosovë është regjistruar në vitin 1986. Që atëherë deri në fund të vitit 2023, në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë janë regjistruar gjithsej 181 raste, prej të cilëve 80 për qind janë burra dhe 20 për qind janë gra.¹⁷⁸ Gjatë gjithë kësaj periudhe, 51 prej këtyre individëve kanë vdekur nga HIV/AIDS-i. Shifrat të burrat janë veçanërisht shqetësuese, sepse 40 nga 144 rastet e burrave të diagnostikuar me HIV/AIDS (27.8 për qind) janë regjistruar vetëm në dy vjetët e

173 UNFPA Kosovë (2022). [Strengthening the Pillars: Cervical Screening and Prevention](#).

174 Ministria e Shëndetësisë. (2023) [Tre vakcina të reja në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve](#).

175 Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës (2021). [Raporti Ex Officio nr. 577/2021 për shëndetin seksual dhe riprodhues](#). Faqe 51.

176 Po aty. Faqe 63.

177 "Raportet vjetore të situatës epidemiologjike me HIV/AIDS dhe IST në Kosovë", Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë, Departamenti i Epidemiologjisë.


178 "Raportet vjetore të situatës epidemiologjike me HIV/AIDS dhe IST në Kosovë", Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë, Departamenti i Epidemiologjisë.

fundit.¹⁷⁹ Ky është më shumë se numri total i grave të diagnostikuara që në fillim. Terapia antiretrovirale (ARV) është në dispozicion në Klinikën e Sëmundjeve Infektive në QKUK, dhe shumica e njerëzve që jetojnë me HIV/AIDS trajtohen atje.¹⁸⁰ Disa individë nuk janë kthyer pas marrjes së rezultateve, dhe kësaj nuk përcillen.

Përderisa ka raste të HIV/AIDS-it në Kosovë, ekziston një mungesë e përgjithshme e vetëdijes për transmetimin e HIV-it. “Përqindja e grave dhe burrave të moshës 15–24 vjeç që identifikojnë saktë dy mënyrat e parandalimit të transmetimit seksual të HIV-it, të cilët e dinë se një person me pamje të shëndetshme mund të jetë HIV pozitiv dhe që i refuzojnë dy keqkuptimet më të zakonshme në lidhje me transmetimin e HIV-it ” është 10.5 për qind te gratë dhe 10.1 për qind te burrat.¹⁸¹ Përqindja është më e ulët në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët janë në 2.7 për qind dhe 5.8 për qind respektivisht.

Në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKSHPK) janë regjistruar raste të infeksioneve seksualisht të transmetueshme (IST), të cilët kanë të dhëna nga sektori publik dhe disa laboratorë të sektorit privat. Më poshtë janë të dhënat për IST-të në 10 vjetët e fundit, të siguruar nga IKSHPK-ja.¹⁸²

Grafiku 5. Numri i rasteve të infeksioneve seksualisht të transmetueshme midis grave dhe burrave 2014–2023



179 Informacioni i marrë nga përfaqësuesit e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë.

180 UNICEF (2020). *Anketa e Treguesve të Shumëfshhtë në Kosovë (MICS) 2019-2020*. Faqe 15.

181 “Raportet vjetore të situatës epidemiologjike me HIV/AIDS dhe IST në Kosovë”, Institut Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë, Departamenti i Epidemiologjisë.

182 Informacioni i marrë nga përfaqësuesit e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë, mars 2024.

Të dhënat tregojnë se më shumë gra sesa burra janë diagnostikuar me IST. Numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara të IST-ve ka rënë ndjeshëm në katër vjetët e fundit, për dy arsye kryesore: 1) shumica e rasteve tani diagnostikohen në laboratorë private, të cilët nuk i raportojnë rastet e IST-ve tek IKSHPK-ja, dhe 2) ndryshime në kategorizimet nga OBSH-ja dhe ECDC-ja, për shkak të së cilave këto shifra nuk përfshijnë disa infeksione që janë regjistruar më parë si IST.¹⁸³ Si rezultat, shtrirja e përhapjes së IST-ve nuk mund të përcaktohet.

183 Gazeta e Republikës së Kosovës (2010). [Ligji nr. 03/L-212 për Punën](#).

PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE DHE SOCIALE DHE FUQIZIMI I VAJZAVE DHE GRAVE

Ekonomia

Analizë e shkurtër e politikave

Ligji nr. 03 L-212 për Punën inkorporon dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke e shtrirë zbatimin e tij në marrëdhëniet punëdhënës-punonjës si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Ky ligj përfshin dispozita për të drejtat e pushimit të lehonisë dhe atësisë, dhe mbrojtje për punëtorët që ushqejnë fëmijët me gji dhe punëtorët shtatzëna.¹⁸⁴ Sipas ligjit, gratë kanë të drejtë për pushim të lehonisë deri në 12 muaj, ndër dispozitat më të gjata të pushimit të lehonisë në botë.

Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë 70 përqind të pagës së rregullt për gjashtë muajt e parë. Pas kësaj, punëdhënësi paguan 50 përqind të pagës mesatare të Kosovës për tre muajt e ardhshëm.

Tre muajt e fundit të pushimit të lehonisë do të jenë pa pagesë, nëse gratë zgjedhin t'i marrin ato. Burrat, nga ana tjetër, kanë të drejtë vetëm për tri ditë pushim të atësisë.¹⁸⁵ Duhet të theksohet se përderisa Kosova ka një nga dispozitat më të gjata të pushimit të lehonisë në botë, analiza statistikore zbulon se pushimet më të gjata zvogëlojnë gjasat që gratë të kthehen në punë.¹⁸⁶ Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara vendos një kuotë të detyrueshme si për punëdhënësit publikë ashtu edhe për ata privatë, për t'i ndihmuar individët me nevoja të

184 Po aty.

185 Rrjeti i Grave të Kosovës (2019). [Diskriminimi me bazë gjinore dhe punësimi në Kosovë](#).

186 Gazeta e Republikës së Kosovës (2009). [Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara](#).

veçanta. Sipas ligjit, punëdhënësit duhet të punësojnë një person me nevoja të veçanta për çdo 50 punonjës.¹⁸⁷

Gjendja aktuale

Varfëria është shumë e përhapur në Kosovë, ku 18 për qind e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë dhe 5.1 për qind në varfëri ekstreme.¹⁸⁸ Varfëria është më e përhapur në zonat rurale, ku banojnë 64.4 për qind e të varfërve dhe 63.7 për qind e të varfërve në varfëri ekstreme.¹⁸⁹ Varfëria prek më shumë gratë se burrat, ku 19 për qind e grave dhe 17 për qind e burrave jetojnë nën kufirin e varfërisë.¹⁹⁰ Treguesit e fuqisë punëtore për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe punësimin e tyre janë ndër më të këqijtë në rajon, edhe pse Strategjia Kombëtare e Zhvillimit e ka vënë në pah punësimin e grave si prioritet.

Shkalla e papunësisë dhe pasivitetit në tregun e punës në Kosovë është jashtëzakonisht e lartë në sektorë të ndryshëm. Kosova ka një shkallë të papunësisë prej 12.6 për qind dhe një shkallë të pasivitetit në fuqi punëtore prej 61.4 për qind.¹⁹¹ Shqetësuese është edhe papunësia e të rinjve në shkallën prej 29 për qind. Gratë dhe vajzat përballen me papunësinë dhe mungesën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në shkallë shumë më të lartë se burrat. Për shembull, 44.5 për qind e burrave janë pasivë (që do të thotë se nuk janë duke punuar dhe nuk kërkojnë punë), krahasuar me 78 për qind të grave.¹⁹² Gjithsej 80,775 individë janë regjistruar si të papunë në zyrat e punësimin në Kosovë në vitin 2022, 39,169 (48.5 për qind) gra dhe 41,606 (51.5 për qind) burra.¹⁹³ Në vitin 2022, gjithsej 4,460 persona janë punësuar me ndërmjetësime të rregullta në punësim nga Zyrat e Punësimin dhe 2,012 përmes Masave Aktive të Tregut të Punës. Gratë përbënin 2,147 nga ato të punësuar në ndërmjetësime të rregullta (48.1 për qind) dhe 1,249 përmes masave aktive të tregut të punës (62.1 për qind). Burrat përbëjnë 2,313 të ndërmjetësimeve të rregullta në punësim (51.9 për qind) dhe 763 të masave aktive të tregut të punës (37.9 për qind).¹⁹⁴

187 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019). [Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës](#).

188 Po aty.

189 Po aty.

190 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2022). [Anketa e Fuqisë Punëtore](#).


191 Po aty.

192 <https://apr.krs-gov.net/Content/Publication/Detail?ide=YHo303Z9ZlkiDkIsaë1HUA%3D%3D>

193 Po aty.

194 Instituti Musine Kokalari (2022). [Who Cares? Unpaid Care work in Kosovo](#).

Grafiku 6. Treguesit kryesorë të tregut të punës, të ndarë sipas gjinisë, ASK



Është e rëndësishme të theksohet se gratë dhe burrat përmendin arsye të ndryshme për pasivitetin në tregun e punës. Burrat deklarojnë se pjesëmarrja e tyre në arsim dhe trajnime është arsyeja kryesore e pasivitetit të tyre, ndërsa gratë përmendin përgjegjësitë e kujdesit të papaguar, përfshirë kujdesin ndaj fëmijëve, si një nga arsyet kryesore. Në fakt, gratë në Kosovë kalojnë 6.2 orë më shumë në punë të kujdesit të papaguar, 44 për qind më shumë kohë krahasuar me burrat, të cilët kalojnë 3.5 orë në punë të papaguar.¹⁹⁵ Puna e papaguar në Kosovë është vlerësuar të kapë vlerën prej €2,824,248,757 apo 33 për qind të GDP-së së Kosovës.¹⁹⁶

Tabela 1. Treguesit shtesë të punësimit, të ndarë sipas gjinisë, 2022

Treguesi	Burra (%)	femra (%)	Total
I papunë i regjistruar në ZP	51.5%	48.5%	80,775
I punësuar me ndërmjetësim të rregullt të ZP	51.9%	48.1%	4460
Të punësuar përmes masave aktive të tregut të punës	37.9%	62.1%	2012

Gratë që janë aktive në tregun e punës vazhdojnë të përballen me mundësi të pabarabarta dhe diskriminim, pavarësisht mbrojtjes ekzistuese ligjore. Diskriminimi i bazuar në gjini është i përhapur në punësim, me punëdhënësit që diskriminojnë gratë për shkak të dispozitave ekzistuese të pushimit të lehonisë.¹⁹⁷ Për shkak të faktit se, siç u diskutua më lart, barra për pagesën e pushimit të lehonisë bie mbi punëdhënësin, shumë punëdhënës të sektorit privat hezitojnë të punësojnë gra që janë shtatzëna ose që mund të planifikojnë të krijojnë familje.¹⁹⁸ Hulumtimet tregojnë gjithashtu se pak punëdhënës

195 Po aty.

196 Rrjeti i Grave të Kosovës (2016). "Arritja e ekuilibrit: Opsionet e politikave që synojnë të informojnë amandamentimin e Ligjit të Punës".

197 Rrjeti i Grave të Kosovës (2019). [Diskriminimi me bazë gjinore dhe punësimi në Kosovë](#).

198 Po aty.

kanë politika dhe masa për t'i identifikuar dhe parandaluar rreziqet për punëtorët shtatzëna.¹⁹⁹ Në fund, pavarësisht diskriminimit në tregun e punës, numri i rasteve të raportuara është jashtëzakonisht i ulët. Ekzistojnë disa arsye për këtë, duke përfshirë frikën nga humbja e vendeve të punës, procedurat e gjata dhe të lodhshme, shqetësimet për anonimitetin, mosbesimin në institucionet publike dhe vështirësitë në dokumentimin e rasteve.²⁰⁰

Për të promovuar barazinë gjinore dhe për të fuqizuar gratë në vendin e punës, në treg dhe komunitet, njëzet e dy kompani private në Kosovë janë angazhuar për Parimet për Fuqizimin e Grave (PFG).²⁰¹ Këto kompani²⁰² përfshijnë sektorë të ndryshëm si: media, shitjet me pakicë, bankat, arsimit privat, shërbimet e taksave dhe këshillimit. Të udhëhequra nga standardet ndërkombëtare të punës dhe të drejtave të njeriut, këto parime theksojnë interesin dhe përgjegjësinë e bizneseve për barazinë gjinore dhe plotësojnë Direktivat e BE-së për balancimin e jetës profesionale dhe personale, siç është theksuar në një studim global të vitit 2021 të mbështetur nga Bashkimi Evropian.²⁰³

Papunësia dhe varfëria mbeten të larta edhe për minoritetet kombëtare, veçanërisht për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, megjithëse të dhënat e ndara sipas gjinisë për këtë nuk janë në dispozicion. Në vitin 2020, pothuajse gjysma (48 për qind) e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve ekonomikisht aktivë në moshë pune në Kosovë ishin të papunë.²⁰⁴ Një çështje tjetër e rëndësishme është joformaliteti. Puna joformale është forma më e zakonshme e punësimit për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, që përbën 70 për qind të punësimit të tyre total, që është dukshëm më shumë se 46 për qind e popullsisë shumicë.²⁰⁵ Diskriminimi gjithashtu luan një rol, pasi që 40 për qind e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve kanë raportuar diskriminim gjatë procesit të punësimit.²⁰⁶ Papunësia në mesin e serbëve në Kosovë është gjithashtu e lartë. Sipas Komisionit Evropian, papunësia në mesin e popullatës serbe të Kosovës është vlerësuar në 30.5 për qind në vitin 2018, krahasuar me një normë prej 15.9 për qind në mesin e shqiptarëve të Kosovës. Për më tepër, pjesëmarrja e serbëve në Kosovë në tregun e punës është shumë më e ulët se ajo e shqiptarëve etnikë.

Sipas Bankës Botërore, në vitin 2017, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për popullatën serbe të Kosovës ishte rreth 39 për qind, krahasuar me një normë prej 63.9 për qind në mesin e shqiptarëve etnikë të Kosovës. Situata me tregun e punës për serbët në Kosovë komplikohet edhe më shumë nga fakti se ata janë të izoluar gjeografikisht, pasi shumica e tyre jetojnë në pjesën veriore të vendit. Për më tepër, pavarësisht kërkesave ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, ata mbeten shumë të nënpërfaqësuar, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.²⁰⁷

199 Po aty.

200 [Women Empowerment Principles \(WEPs\)](#)

201 [WEPs Signatories in Kosovo](#)

202 [A snapshot of 350 companies in G7 countries \(2021\) United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women funded by European Union](#)

203 Dokumenti Punues i Stafit të Komisionit (2019). [Roma inclusion measures reported under the EU Framework for NRIS.](#)

204 Grupi i Bankes Boterore (2019). [Thyerja e ciklit të përjashtimit të romëve në Ballkanin Perëndimor.](#)

205 Po aty.

206 Farnsworth, Morina dhe Nuhiu (2018). [Gender, LGBTI, and Persons with Disabilities Assessment.](#)

207 Gashi et. al. (202). [Are women really paid more than men in Kosovo? Unpicking the Evidence](#), South East European Journal of Economics and Business.

Të dhënat zyrtare mbi hendekun e pagës gjinore në Kosovë nuk janë të disponueshme. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se gratë në Kosovë fitojnë rreth €0.74 € për çdo €1.00 që fitojnë burrat.²⁰⁸ Ky hendek i pagës vazhdon të ekzistojë sepse burrat priren të zënë pozita më të paguara në të gjithë sektorët. Hendeku është më i theksuar në sektorët që dominohen nga burrat, por mbetet edhe në fusha si shëndetësia dhe arsimit, ku gratë janë më të pranishme, por ku burrat ende mbajnë pozita më të paguara.²⁰⁹

Aftësimi profesional

Analizë e shkurtër e politikave

Ligjet për Aftësimin dhe Arsimin Profesional në Kosovë janë të dizajnuara që të jenë jodiskriminuese, duke siguruar qasje të barabartë për të gjitha gratë, burrat, vajzat dhe djemtë me prejardhje të ndryshme. Ligji për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve²¹⁰ garanton që si burrat ashtu edhe gratë mund të marrin pjesë në të gjitha programet e edukimit dhe trajnimit për të rriturit. Gjithashtu, Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional²¹¹ thekson se bazohet në parimin e përfshirjes.

Situata aktuale

Sa i përket aftësimin profesional, në vitin 2022, 2,797 individë u regjistruan në programet e organizuara nga Qendrat e Aftësimin Profesional (QAP) për t'i përmirësuar aftësitë e tyre profesionale dhe për të rritur punësueshmërinë e tyre. Kjo përfshinte 35.4 për qind gra dhe 64.6 për qind burra.²¹² Këto programe janë krijuar për të rritur punësueshmërinë duke ofruar aftësi të përshtatshme dhe të kërkuara në sektorë të ndryshëm. Ato përfshinin fusha të tilla si teknologjia e informacionit, ndërtimtaria, kujdesi shëndetësor, bujqësia dhe industrinë e shërbimeve, si hoteleria dhe shërbimi ndaj klientit. Objektivi ishte që trajnimi të përputhej ngushtë me kërkesat e tregut, duke rritur kështu mundësinë e punësimit për pjesëmarrësit.²¹³

Aftësitë e mësuara përfshinin teknikat si programimi dhe teknikat e ndërtimit, e deri tek aftësitë e buta, si komunikimi dhe puna në grup, duke ofruar një qasje gjithëpërfshirëse zhvillimi për fuqinë punëtore. Të dhënat tregojnë se edhe pse gratë dhe burrat janë të regjistruar proporcionalisht si të papunë, gratë mbeten të nënpërfaqësuar në pjesëmarrjen në QAP. Janë vënë re disa arsye për këtë nënpërfaqësim, duke përfshirë perceptimet shoqërore se këto institucione u shërbejnë kryesisht profesioneve "të burrave", mungesën e vetëdijesimit për opsionin e arsimit profesional, dhe perceptimi se ai [arsimi profesional] është inferior ndaj arsimit të lartë.²¹⁴ Për më tepër, programet e QAP-ve janë më në dispozicion në qytete, duke e bërë të vështirë qasjen nga gratë dhe minoritetet që jetojnë në zona më të largëta. Për shembull, QAP-të ndodhen në shtatë qytete kryesore në Kosovë, duke e bërë më sfiduese qasjen për njerëzit që jetojnë në zonat rurale. Kjo gjë përbën problem veçanërisht për gratë për shkak të shqetësimeve mbi

208 Po aty.

209 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji nr. 02/L-24 për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve](#).

210 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional](#).

211 Po aty.

212 Po aty.


213 Po aty.

214 Qeveria e Republikës së Kosovës (2020). [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#).

sigurinë.²¹⁵ Nuk ka të dhëna në dispozicion për pjesëmarrjen e grave dhe burrave me prejardhje të ndryshme të pakicave në QAP në Kosovë. Disa veprime janë ndërmarrë e disa politika janë dizajnuar nga institucionet për ta përmirësuar këtë situatë. Këtu përfshihet Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2023 i cili përshkruan rolet dhe përgjegjësitë e këshilltarëve të karrierës brenda institucioneve për Arsim dhe Aftësim Profesional. Ky udhëzim ka për synim që të sigurojë që këshilltarët e karrierës t'i këshillojnë studentët, vajzat dhe djemtë, në procesin e përzgjedhjes së karrierës së tyre duke ofruar informacione relevante të cilat ndërlidhen me kërkesat e tregut të punës dhe aspiratat e vetë studentëve. Për më tepër, që nga viti 2021 në mënyrë që të përmirësohet përfaqësimi i grave në fushat e studimit që kanë të bëjnë me teknologji dhe për t'i mbështetur ato në zhvillimin profesional, MASHTI-i e ka dizajnuar skemën e bursave që synojnë vajzat me qëllim të zvogëlimit të hendekut gjinor dhe për t'i përmbushur kërkesat aktuale të tregut të punës. Një total prej 90 bursash ndahen çdo vit, secila me vlerë prej €500, si pjesë e një nisme më të gjerë për t'i pajisur gratë dhe vajzat me aftësitë e nevojshme për profesionet teknike, ku ato zakonisht janë të nënpërfaqësuar. Në vitin 2023, MASHTI-i dha 1,882 bursa, me vlerë nga €1,000 secila, për gra dhe vajza që ndjekin studime në fushat STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë).²¹⁶

Ndërmarrësia

Grafiku 7. Pronësia e ndërmarrjeve në Kosovë 2022



Gratë në Kosovë janë të nënpërfaqësuar si pronare të ndërmarrjeve. Në vitin 2022, gratë zotëronin 21.9 për qind të të gjitha ndërmarrjeve në Kosovë.²¹⁷ Megjithatë, gratë zotërojnë afërsisht 30 për qind të të gjitha ndërmarrjeve të reja që regjistrohen çdo vit në Kosovë.²¹⁸ Në vitin 2021, 70 për qind e ndërmarrjeve të drejtura nga gratë ishin biznese mikro me më pak se nëntë punonjës, 24 për qind ishin biznese të vogla, 5 për qind ishin biznese të mesme dhe më pak se 1 për qind ishin biznese të mëdha.²¹⁹ Bizneset e vogla

përbënin afërsisht 24 për qind të të gjitha bizneseve në pronësi të grave, ndërsa bizneset e mesme përbënin rreth 5 për qind, dhe bizneset e mëdha përbënin më pak se 1 për qind. Shumica e ndërmarrjeve në pronësi të grave (32 për qind) fokusohen në tregtinë me shumicë dhe pakicë, 20 për qind fokusohen në shërbime "të tjera", dhe 11 për qind në prodhim.²²⁰ Sektorët me numrin më të vogël të ndërmarrjeve të

215 Për më shumë shih: <https://masht.rks-gov.net/lista-e-perfituesve-te-bursave-ne-drejtimit-deficitare-dhe-drejtimit-teknike-per-vajza-ne-iaap-per-vitin-2023-2024/> dhe <https://kallxo.com/lajm/mashti-ndan-90-bursa-per-nxenes-ne-drejtimit-deficitare-dhe-vajzat-ne-drejtimit-teknike/>

216 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2022). [Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet](#).

217 Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve. [Raportet e Indikatorëve Bazë të Performancës](#).

218 Këshilli i Bashkëpunimit (2021). Gratë në Ndërmarrësi në Kosovë.

219 Po aty.

220 Po aty.

grave përfshijnë energjinë elektrike, gazin, avullin, furnizimin me ajër të kondicionuar dhe ndërtimin.²²¹ Kryesisht për shkak të mungesës së kolateralit, mbi 88 për qind e grave ndërmarrëse hapin biznese me vetëfinancim, pa kredi apo mbështetje tjetër të jashtme.²²² Në total, 5,253 (15,8 për qind) biznese janë në pronësi të individëve të komuniteteve pakicë etnike në Kosovë.²²³ Nga numri i përgjithshëm i bizneseve në pronësi të pakicave, 79 për qind janë në pronësi të burrave dhe 21 për qind në pronësi të grave. Megjithatë, duket se ka një trend të rritjes së bizneseve në pronësi të grave. Në vitin 2018, 30 për qind e të gjitha bizneseve të reja të regjistruara ishin në pronësi të grave, ndërsa 32 për qind e bizneseve të reja në vitin 2021 ishin të regjistruara nga gratë.²²⁴ Që nga viti 2018, vetëm 19 për qind e përfituesve të subvencioneve nga Agjencia Kosovare për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve (KIESA) kanë qenë ndërmarrje në pronësi të grave, ndërsa 81 për qind në pronësi të burrave.²²⁵

Qeveria e Kosovës ka mbështetur në mënyrë të konsiderueshme bizneset e grave përmes Fondit të Rimëkëmbjes Ekonomike. Në vitin 2021, Agjencia për Barazi Gjimore alokoi €2 milionë, duke ndihmuar 108 qendra kujdesi për fëmijë të drejtuara nga gra dhe 273 biznese të vogla që u përkasin grave.²²⁶ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë mbështeti me €470.000 32 biznese të drejtuara nga gratë. Fondi i Garancisë së Kredive gjithashtu ofroi garanci kolaterale për bizneset e drejtuara nga gra, duke mbështetur 269 biznese me 8.6 milionë euro deri në fund të vitit 2021.

Ekonomia joformale

Ekonomia joformale në Kosovë përfshin punëtorë, punë dhe aktivitete ekonomike, që nuk janë të rregulluara apo të mbrojtura nga shteti. Ky segment i ekonomisë përfshin një gamë të gjerë aktiviteteve nga prodhimi bujqësor në shkallë të vogël deri te bizneset dhe ofruesit e shërbimeve të peregjistruara. Sektori joformal karakterizohet nga mungesa e kontratave formale, sigurisë së punës dhe përfitimeve sociale, duke kontribuar në cenueshmërinë ekonomike të atyre që janë të përfshirë. Megjithatë, ajo siguron të ardhura thelbësore për shumë familje, duke vepruar si një rrjet i sigurisë në kohë vështirësish ekonomike. Në vitin 2022, rreth 42 për qind e kosovarëve ishin të përfshirë në punë joformale. Brenda këtij grupi, gratë kishin pothuajse dy herë më shumë gjasa të përfshiheshin në aktivitete joformale krahasuar me burrat, duke përbërë 65 për qind të fuqisë punëtore joformale.²²⁷ Gratë në sektorin joformal të Kosovës shpesh angazhoheshin në punë me pagesë të ulët, të paqëndrueshme, dhe me mungesë të mbrojtjes sociale. Ky çekuilibër është i rrënjësor në rolet tradicionale gjimore dhe barrën e punës së papaguar të kujdesit, e cila kufizon shumë gra në punë me kohë të pjesshme ose sezonale, kryesisht në bujqësi dhe industri të shërbimeve. Zonat rurale dhe grupmosha 46–64 vjeç shohin pjesëmarrje më

221 Rrjeti i Grave të Kosovës (2018). Analiza Gjimore e Kosovës.

222 Instituti GAP, profili e biznesit (2023). [Ndërmarrësia e grave dhe pakicave etnike në Kosovë.](#)

223 Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve. [RAPORTI I INDIKATORËVE BAZË TË PERFORMANCËS PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE NË KOSOVË PËR VITIN 2021.](#)

224 Rrjeti i Grave të Kosovës. [Barazia Gjimore: Në qendër të TI... dhe përtej një analize gjimore të digjitalizimit në Kosovë.](#)

225 Agjencia Kosovare për Barazi Gjimore (2023). [Monitoring and evaluation report on the achievement of the objectives for the indicators and the implementation of the activities of KPGI Action Plan 2020–2022.](#)

226 https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2024/02/KËN_In-the-Shadows-2.pdf

227 Po aty.

të lartë të grave në punën joformale, duke theksuar nevojën për mbështetje të synuar për integrimin e këtyre grave në ekonominë formale.²²⁸

Shkalla e lartë e joformalitetit në Kosovë rrjedh nga evazioni fiskal, ndjekja e përfitimeve të asistencës sociale dhe presionet familjare. Shumë individë, veçanërisht gratë, hyjnë në punë joformale për shkak të mundësive të kufizuara për punë formale dhe pritjeve shoqërore. Sfidat, si transporti publik i dobët dhe rolet e ngurta gjinore, kufizojnë më tej qasjen në punë formale, duke shtyrë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, veçanërisht gratë, në sektorin joformal.²²⁹


228 Po aty.

229 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2024). Law No 08/L-255 on Social and Family Services.

MBROJTJA SOCIALE DHE CENUESHMËRIA SOCIALE

Kosova ka një sistem të hollësishëm të mbrojtjes sociale, i rregulluar nga disa ligje dhe udhëzime administrative. Sistemi i mbrojtjes sociale në Kosovë shërben si një rrjet sigurie për gratë dhe burrat në nevojë. Ai përfshin pensionet, ndihmën sociale të synuar dhe programe të tjera më të vogla për të mbështetur grupet e cenueshme, si veteranët dhe personat me aftësi të kufizuara.

Grafiku 8. Përfituesit e Pensionit Bazik në Kosovë, 2024



Siç u përmend më lart, Kushtetuta e Republikës së Kosovës siguron kornizën ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e mirëqenies sociale në Kosovë, duke përcaktuar të drejtat e qytetarëve, përfshirë të drejtën për mbrojtje sociale. Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare²³⁰ rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe

familjare, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse. Ai përcakton rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve publike, subjekteve private dhe OJQ-ve të përfshira në ofrimin e shërbimeve për të siguruar mirëqenien dhe dinjitetin e të gjithë individëve në nevojë. Shërbimet klasifikohen në kategori primare, sekondare dhe terciare sipas ligjit, duke adresuar nivele të ndryshme të nevojës dhe duke ofruar mbështetje si ndihma për strehim, ndërhyrjet emergjente, institucionet rezidenciale dhe strehimi familjar. Ligji përcakton të drejtat dhe shërbimet e disponueshme për grupet e cenueshme, përfshirë fëmijët pa kujdes prindëror, viktimat e abuzimit, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Për më tepër, ai përshkruan parimet e ofrimit të shërbimeve, me theksin te respektimi i dinjitetit njerëzor, mosdiskriminimi dhe transparencja. Ligji kërkon licencimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të ofruesve të shërbimeve, si dhe dispozita për mbikëqyrje dhe inspektim të rregullt për të siguruar përputhshmërinë me standardet e përcaktuara. Financimi i këtyre shërbimeve vjen kryesisht nga buxheti i shtetit, me dispozita për partneritete publiko-private për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve. Gjithashtu, Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës rregullon krijimin, menaxhimin dhe funksionimin e fondeve pensionale për të siguruar siguri financiare për pensionistët.²³¹ Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë siguron mbështetje financiare për individët me aftësi të kufizuara që

230 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2012). Law No.04/L-101 on Pension Funds of Kosovo.

231 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2003). [Law No 2003/23 on Disability Pensions in Kosovo](#).

nuk mund të punojnë.²³² Ligji për Personat e Verbër siguron mbështetje të veçantë financiare dhe sociale për individët me të meta të shikimit.²³³ Ligji për Pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës ofron përfitime pensionale për anëtarët e forcave të sigurisë pas daljes në pension.²³⁴ Ligji për pensionet e veteranëve siguron mbështetje financiare dhe përfitime për individët që kanë shërbyer në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.²³⁵

Skemat e Ndhmës Sociale

Ndhma Sociale në Kosovë rregullohet nga Ligji për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë.²³⁶ Ky ligj përcakton dy lloje ndihmash: SNS Kategoria 1 dhe SNS Kategoria 2. Për të përfituar nga SNS Kategoria 1, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë të varur dhe asnjëri prej tyre nuk mund të jetë i punësuar.²³⁷ SNS Kategoria 2 është për familjet ku të paktën një anëtar është i aftë për punë dhe ka një fëmijë nën 5 vjeç ose një jetim nën 15 vjeç.²³⁸ Gjithashtu, aplikantët për të dyja kategoritë nuk duhet të kenë pronë më të madhe se pesë hektarë, bagëti, pajisje për përdorim personal ose biznes apo automjete. Anëtarët e familjes që marrin pension bazë ose pension për aftësi të kufizuara nuk përfshihen gjatë llogaritjes së përfitimit të asistencës sociale të familjes.²³⁹

Tabela 2. Përfituesit e SNS në Kosovë, të ndarë sipas kategorisë dhe gjinisë, 2024

SNS Kategoria 1			
Gjinia	Gra	Burra	Totali
Përfitues të drejtpërdrejtë	47.0%	52.9%	14173
Anëtarë të familjes	53.9%	46.0%	34826
SNS Kategoria 2			
Gjinia	Gra	Burra	Totali
Përfitues të drejtpërdrejtë	11.4%	88.5%	5063
Anëtarë të familjes	39.0%	60.9%	20563

Në vitin 2024, ndarja e përfituesve të SNS-it në Kosovë sipas gjinisë tregon se burrat përbëjnë shumicën e përfituesve të drejtpërdrejtë, sidomos në SNS Kategorinë 2, ku 88.5 për qind e përfituesve të drejtpërdrejtë janë burra, krahasuar me 11.4 për qind që janë gra. Në SNS Kategorinë 1, 52.9 për qind e

232 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2012). [Law No 04/L-092 for Blind Persons](#).

233 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2012). [Law No.04/L-084 on Pensions of Members of the Kosovo Security Force](#).

234 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2012). [Law No.04/L-2611 on Kosovo Liberation Army War Veterans](#).

235 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2003). [Law No. 2003/15 on the Social Assistance Scheme in Kosovo](#).

236 Ibid. Seksioni 4.a

237 Po aty. Seksioni 4.b

238 Po aty.

239 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2024). Statistikat e Mirëqenies Sociale.


përfituesve të drejtpërdrejtë janë burra, ndërsa 47.0 për qind janë gra. Megjithatë, kur merren parasysh anëtarët e familjes, gratë përbëjnë një përqindje më të lartë të atyre që janë në nevojë. Në SNS Kategoria 1, 53.9 për qind e anëtarëve të familjes janë gra, ndërsa në SNS Kategoria 2, 39.0 për qind janë gra. Kjo nxjerr në pah se, megjithëse burrat kanë më shumë gjasa të jenë përfitues të drejtpërdrejtë të ndihmës sociale, gratë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të atyre që mbështeten nga kjo ndihmë.

Skemat Pensionale

Tabela 3. Përfituesit e skemave të ndryshme të pensioneve, të ndarë sipas gjinisë, 2024

	Burra	Gra	Totali
Pensionet e invaliditetit	47.9%	52.0%	19,654
Pensionet e veteranëve	90.52%	9.4%	36,972
Familjet e dëshmorëve	49.7%	50.2%	12 859

Grafiku 9. Përfituesit e pensionit kontributpagues, 2024



Në Kosovë, dy lloje kryesore pensioni janë të disponueshme për individët mbi moshën 65 vjeç: pensioni bazik i moshës, të cilin e marrin të gjithë qytetarët e moshuar pa përjashtim, dhe pensioni kontributpagues, i cili u jepet atyre që kanë kontribuar përmes punësimit të tyre. Në vitin 2024, 145,901 individë në Kosovë morën pensionin bazik, shumica prej të cilëve ishin gra.²⁴⁰ Duke qenë se gratë përbëjnë pjesën më të madhe të popullsisë joaktive në tregun e punës, ato kanë më shumë gjasa të përfitojnë pensionin bazik se atë kontributpagues. Ndryshe nga kjo, 48,215 individë morën pensionin kontributpagues²⁴¹, shumica prej të cilëve janë burra, për shkak të përfshirjes më të lartë të burrave në tregun e punës.

Tabela nxjerr në pah shpërndarjen gjinore të përfituesve të pensioneve në Kosovë për vitin 2024. Për pensionet e invaliditetit, 47.9 për qind janë burra dhe 52.0 për qind janë gra, me një total prej 19,654

240 Po aty.

241 Kombet e Bashkuara. [Konventa për të Drejtat e Fëmijës](#).

përfituesish. Pensionet e veteranëve tregojnë një pabarazi të theksuar gjinore, ku 90.52 për qind e 36,972 përfituesve janë burra dhe vetëm 9.4 për qind janë gra. Ndryshe nga kjo, pensionet për familjet e dëshmorëve janë të shpërndara më në mënyrë të barabartë, ku 49.7 për qind janë burra dhe 50.2 për qind janë gra nga gjithsej 12,859 përfitues.

Arsimi

Analizë e shkurtër e politikave

Korniza ligjore në Kosovë garanton të drejta të barabarta për të gjitha gratë, burrat, vajzat dhe djemtë me prejardhje të ndryshme për qasje dhe përfitim nga mundësitë e arsimit. Kosova ka përfshirë në kushtetutën e saj dhe në këtë mënyrë ka bërë drejtpërdrejt të zbatueshme disa konventa që sigurojnë barazinë gjinore në arsim. Kjo përfshin Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, e cila garanton të drejtën e të gjitha vajzave dhe djemve për arsim,²⁴² si dhe Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 03 të CEDAW-it, i cili kërkon eliminimin e praktikave dhe paragjytimeve që pengojnë pjesëmarrjen e barabartë të vajzave në arsim.²⁴³ Ligji për Edukimin në Fëmijëri të Hershme, i miratuar së fundmi, garanton mundësi të barabarta në arsimin parashkollor, duke siguruar që të gjithë fëmijët, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike apo ndonjë përkatësi tjetër, të kenë qasje në programet e edukimit të hershëm. Ai thekson nevojën për një mjedis arsimor gjithëpërfshirës që mbështet barazinë gjinore, duke i lejuar kështu djemtë dhe vajzat të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga mundësitë edukative.²⁴⁴ Përveç kësaj, Ligji për Arsimin në Komunitet e Kosovës synon “të promovojë një sistem arsimor jodiskriminues në të cilin e drejta e çdo personi për arsim respektohet, dhe mundësitë për mësim cilësor janë në dispozicion të të gjithëve”.²⁴⁵ Për më tepër, Ligji për Arsimin Parauniversitar thekson se të gjitha vajzat dhe djemtë duhet të përfshihen në mënyrë të barabartë në sistemin arsimor, dhe siguron që të mos ketë diskriminim në bazë të seksit, statusit martesor ose arsyeve të tjera sa i përket qasjes në arsimin parauniversitar.²⁴⁶ Ai gjithashtu përcakton se arsimi parauniversitar duhet të nxisë një frymë të barazisë gjinore dhe të përfshijë promovimin e barazisë gjinore në planifikimin, menaxhimin dhe ofrimin e arsimit.²⁴⁷ Në fund, Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës siguron mundësi të barabarta dhe qasje jodiskriminuese për të gjithë studentët dhe stafin brenda institucioneve të arsimit të lartë.²⁴⁸ Ai thekson diversitetin në programet arsimore, mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës, dhe barazinë në mundësitë e punësimit dhe kërkimit.²⁴⁹

242 Divizioni për Avancimin e Gruas, Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale. “[CEDAW General Recommendation No. 3: Education and Public Information Campaigns](#).”

243 Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme](#), 2023.

244 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2008). [Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Kosovës](#).

245 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji nr. 04/L-32 për Arsimin Parauniversitar](#).

246 Po aty.

247 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës](#).

248 Po aty.

249 Banka Botërore (2024). [Literacy in Kosovo](#).

Situata aktuale

Tabela 4. Numri i mësimdhënësve të ndarë sipas gjinisë dhe nivelit arsimor

Niveli i arsimit	Nr. i mësimdhënësve	Burra (%)	Gra (%)
Parashkollor	649	0.3%	99.7%
Parafillor, Fillor dhe i Mesëm i Ulët	27699	38.3%	61.7%
E mesme e lartë	8018	64.2%	35.8%

Shkalla e përgjithshme e analfabetizmit në Kosovë është rreth 3.5 për qind. Ekziston një pabarazi e dukshme në këtë shkallë mes gjinive. Për gratë, shkalla e analfabetizmit është rreth 5 për qind, ndërsa për burrat është më e ulët, rreth 2 për qind.²⁵⁰ Kosova ka një nivel më të lartë analfabetizmi krahasuar me vendet fqinje, veçanërisht mes grave. Për krahasim, shkalla e analfabetizmit për gratë në Shqipëri është rreth 2.2 për qind, ndërsa për burrat është afërsisht 0.3 për qind.²⁵¹ Në Serbi, shkalla e përgjithshme e analfabetizmit është rreth 0.3 për qind, me 0.4 për qind për gratë dhe 0.2 për qind për burrat. Në Maqedoninë e Veriut, shkalla e përgjithshme e analfabetizmit është rreth 1.6 për qind, me 2.4 për qind për gratë dhe 0.9 për qind për burrat.

Barazia gjinore në tekstet shkollore dhe kurrikulat në Kosovë mbetet një fushë ku ka hapësirë të madhe për përmirësim. Studimet tregojnë se tekstet shkollore vazhdojnë të ruajnë rolet tradicionale gjinore dhe stereotipet, duke forcuar paragjykimet dhe duke penguar barazinë gjinore. Tekstet shpesh paraqesin burrat në role dominuese dhe gratë në pozita pasive, dytësore, gjë që kontribuon në përforcimin e stereotipeve gjinore tek nxënësit.²⁵² Këto paraqitje mund të luajnë një rol në ruajtjen e stereotipeve gjinore, duke formësuar perceptimet e nxënësve dhe duke kufizuar të kuptuarit e tyre për rolet dhe mundësitë gjinore. Paraqitjet e tilla të pabalancuara në tekstet shkollore dhe kurrikula mund të reflektojnë dhe përforcojnë paragjykimet shoqërore, duke kufizuar potencialin e djemve dhe vajzave për të imagjinuar veten në role të ndryshme.

Burrat janë dukshëm të nënpërfaqësuar si mësimdhënës në arsimin parashkollor, duke përbërë vetëm 0.3 për qind, krahasuar me 99.7 për qind të grave.²⁵³ Në mënyrë të ngjashme, në nivelet parashkollore, filllore dhe të mesme të ulëta, burrat përbëjnë 38.3 për qind të mësimdhënësve, ndërsa gratë përbëjnë 61.7 për qind.²⁵⁴ Në të kundërt, gratë janë të nënpërfaqësuar në nivelin e mesëm të lartë, me 35.8 për qind. Gratë janë gjithashtu të nënpërfaqësuar si profesorë universitarë në të gjitha universitetet publike në Kosovë, duke përbërë vetëm 32.8 për qind nga 405 profesorë të rregullt dhe 38.3 për qind nga 349 profesorë me kohë të pjesshme. Përfaqësimi është më i balancuar kur shikohen universitetet

250 Banka Botërore (2024). Literacy in Albania.

251 Agjencia për Barazi Gjinore në Kosovë (2019). [Preventing Gender Stereotypes and Promoting Gender Equality in School Textbooks and Materials](#).

252 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës (2023). [Statistikat e Arsimit 2022/2023](#).

253 Po aty.

254 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës (2023). [Statistikat e Arsimit 2022/2023](#).

private, ku gratë përbëjnë 42.6 për qind të profesorëve të rregullt dhe 36.2 për qind të profesorëve me kohë të pjeshme.

Arsimi parauniversitar

Tabela 5: Numri i nxënësve të ndarë sipas gjinisë dhe nivelit arsimor.

Niveli i arsimit	Gjithsej nxënës	Djem (%)	Vajza (%)
Parashkollor	5420	51.9%	48.1%
Parafillor	18,946	51.3%	48.7%
Filllore dhe e mesme e ulët	212,967	51.4%	48.5%
E mesme e lartë	63,029	50.5%	49.5%

Sektori i arsimit parauniversitar luan një rol kyç në avancimin e barazisë gjinore duke fuqizuar gratë dhe duke sfiduar stereotipet ekzistuese midis të gjithë nxënësve. Në përgjithësi, nuk ka pabarazi të mëdha gjinore në vijimin e arsimit parauniversitar në Kosovë. Në vitin 2022, arsimit parashkollor (para se të fillojë arsimit zyrtar, zakonisht për fëmijët nën 5 vjeç) frekuentohet nga 5,420 fëmijë me 48 për qind vajza dhe 51.9 për qind djem.²⁵⁵ Arsimin parafillor për fëmijët e moshës 5-6 vjeç e ndjekin 48.7 për qind vajza dhe 51.3 për qind djem. Po kështu, në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët numërohen 212,967 nxënës, 48.5 për qind vajza dhe 51.4 për qind djem. Në fund, 49.5 për qind janë vajza dhe 50.4 për qind djem në arsimin e mesëm të lartë.²⁵⁶

Tabela 6. Të dhëna të ndara sipas gjinisë për shkollat e mesme të larta

Lloji i shkollës	Vajza	Djem	Total
Shkolla profesionale	42%	58%	34006
Gjimnazi	50%	50%	63029

Në Kosovë ekzistojnë dy lloje të arsimit profesional, shkollat profesionale dhe gjimnazet. Shkollat profesionale ofrojnë aftësi praktike dhe njohuri për karriera specifike, duke synuar aftësimin e punëtorëve të ardhshëm, ndërsa gjimnazet ofrojnë arsimim më të gjerë akademik me qëllim të përgatitjes së studentëve për arsimin universitar dhe të lartë. Djemtë dhe vajzat janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë në gjimnaze me 50 për qind. Megjithatë, djemtë janë të mbipërfaqësuar (në 58 për qind) në shkollat profesionale. Ky ndryshim mund të lidhet me faktorë të shumtë, duke përfshirë arritjet më të larta akademike të vajzave në arsimin fillor dhe të mesëm, mungesën e orientimit për karrierë në institucione dhe stereotipet mbizotëruese gjinore së bashku me rolet tradicionale.²⁵⁷ Nacionet stereotipike mbi atë se cilat karriera janë të përshtatshme për gratë e cilat për burrat vazhdojnë të ndikojnë në zgjedhjet

255 Po aty.

256 Këshilli i Evropës. Analiza Gjinore Ndërsektoriale në Arsimin Parauniversitar

257 Qendra për Studime Sociale dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, [Stereotipet Gjinore dhe Zgjedhjet në Karrierë në Kosovë](#), 2019.

arsimore në Kosovë.²⁵⁸ Për më tepër, kalimi nga shkollat profesionale në arsimin universitar mbetet mjaft i lartë, duke treguar pamjaftueshmërinë e sistemit të shkollave profesionale për të ofruar një futje më të shpejtë në tregun e punës për studentët e saj. Përveç kësaj, shkalla e përfundimit të universitetit mbetet e ulët, duke zbuluar joefikasitete në sistemin publik të formimit të aftësive. Shumica e profileve të arsimit profesional nuk u përmbahen standardeve profesionale, duke rezultuar në një mungesë të përputhshmërisë me kërkesat e tregut të punës. Zhvillimi i një kurrikule bazë për arsimin profesional ka filluar, por mësimi në vendin e punës ende nuk është pjesë sistematike e kurrikulave. Megjithëse partneritetet midis shkollave profesionale dhe bizneseve kanë nisur viteve të fundit, ato kanë nevojë për përmirësim. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) prezantoi arsimin profesional dual për 12 profile në vitin 2023, me plane për të zgjeruar numrin e profileve pas vitit 2024 në varësi të kërkesës së bizneseve. Mundësitë për mësim gjatë gjithë jetës dhe njohja e kualifikimeve të arsimit për të rritur (ose e të nxënës paraprak) mbeten të kufizuara.

Tabela 7: Normat e braktisjes, të ndara sipas nivelit arsimor dhe gjinisë 2022/2023

Niveli i arsimimit	Total	Djem	Vajza	% Djemve	% Vajzave
Fillore dhe e Mesme e Ulët (Kl. 1-9)	191	102	89	53.4%	46.6%
E mesme e lartë (Kl. 10-12)	1005	792	213	78.8%	21.1%
Total	1,196	894	302	74.7%	25.2%

Në vitin shkollor 2022/23 në Kosovë, braktisja e shkollës fillore dhe të mesme të ulët ishte 53.40 për qind nga ana e djemve dhe 46.60 për qind nga ana e vajzave. Në arsimin e mesëm të lartë, 78.81 për qind që e kishin braktisur ishin djem dhe 21.19 për qind ishin vajza. Në përgjithësi, 74.75 për qind e të gjithë atyre që braktisën shkollën ishin djem dhe 25.25 për qind ishin vajza, që tregon se djemtë kanë më shumë gjasa të braktisin shkollën.²⁵⁹ Trend i ngjashëm është vërejtur në vitin 2021 dhe në vitet e mëparshme.²⁶⁰ Të dhënat sugjerojnë se shkalla e braktisjes së shkollës ndikohet nga normat gjinore dhe pritshmëritë shoqërore, ku djemtë pritet të mbështesin financiarisht familjet e tyre sa më shpejt që të jetë e mundur.²⁶¹ Në përgjithësi, fëmijët me prejardhje rome, ashkali dhe egjiptiane mbeten të nënpërfaqësuar në arsimin parauniversitar. Vajzat rome dhe ashkali janë shumë të nënpërfaqësuar në arsimin e mesëm të lartë ndërsa vajzat egjiptiane janë të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.²⁶² Martesat e hershme duket se kontribuojnë ndjeshëm në shkallën e braktisjes së shkollës së vajzave brenda këtyre tri komuniteteve.²⁶³ Vajzat me nevoja të veçanta arsimore janë të nënpërfaqësuar në arsimin parauniversitar. Në vitin akademik 2022/23, nga 313 nxënës me aftësi të kufizuara që ndiqnin arsimin parauniversitar, vetëm 33 për qind ishin vajza.²⁶⁴ Megjithatë, nuk ka të dhëna që tregojnë se ka më shumë djem me aftësi të kufizuara sesa vajza, gjë që sugjeron se vajzat me aftësi të kufizuara mund të mos sillen në shkollë sa djemtë.

258 Korrespondencë me MASHTI-n, mars 2024.

259 Po aty.

260 Këshilli i Evropës (2020). [Analiza Ndërsektoriale në Arsimin Parauniversitar](#).

261 Po aty.

262 Diskutim në fokus grup.

263 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës (2023). [Statistikat e Arsimit 2022/2023](#).

264 [Kushtetuta e Republikës së Kosovës](#). Neni 46.

Arsimi terciar

Tabela 8: Numri i të diplomuarve në universitetet publike, i ndarë sipas gjinisë

Universiteti	Diploma Bachelor			Diploma Master		
	Numri i të diplomuarve	Burra (%)	Gra (%)	Numri i të diplomuarve	Burra (%)	Gra (%)
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"	3,543	32.0%	68.0%	1057	35.4%	64.6%
Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"	724	17.7%	82.3%	84	36.9%	63.1%
Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka"	308	22.1%	77.9%	38	55.3%	44.7%
Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"	272	28.3%	71.7%	124	32.3%	67.7%
Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj	180	33.3%	66.7%	19	47.4%	52.6%
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"	336	26.5%	73.5%	57	29.8%	70.2%
Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"	66	24.2%	75.8%	0	0	0
Fakulteti i Studimeve Islame	37	54.1%	45.9%	10		
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	38	89.5%	10.5%	0	30%	70%
Total	5504	29.5%	70.5%	1389	36%	64%

Gjatë dekadës së fundit, gratë kanë tejkaluar vazhdimisht burrat në marrjen e diplomës bachelor. Në vitin akademik 2021/22, gratë përbënin 70.5 për qind të të gjithë të diplomuarve me diplomë bachelor nga universitetet publike në Kosovë, duke i kaluar burrat pothuajse në të gjitha institucionet. Përjashtimet e vetme ishin Universiteti i Studimeve Islame dhe Akademia për Sigurinë Publike, ku burrat përbënin 54.1 për qind dhe 89.5 për qind të të diplomuarve, përkatësisht. Në mënyrë të ngjashme, gratë tejkalojnë burrat në marrjen e diplomave master, me 64 për qind të të gjitha diplomave master në vitin 2022/23 që janë marrë nga gratë. Në fund, më shumë gra se burra kanë doktoruar në vitin 2022/23, (56 për qind), një trend që vazhdon nga vitet e mëparshme. Gjithashtu, shumica dërrmuese e studentëve që diplomojnë në universitetet private në Kosovë janë gra. Konkretisht, në vitin akademik 2021/22, gratë përbënin 72.1 për qind të gjithsej 6,881 të diplomuarve. Fatkeqësisht, suksesi më i lartë i grave në arsimin terciar nuk përkthehet në hyrje të suksesshme në tregun e punës, siç u pa më lart. Për më tepër, ndarja gjinore vazhdon në arsimin terciar, ku burrat janë të nënpërfaqësuar ndjeshëm në fushën e arsimit dhe gratë janë të nënpërfaqësuar në shkencat kompjuterike, bujqësi, biznes dhe gjeoshkenca. Megjithatë, MASHTI-i nuk mbledh dhe publikon të dhëna të ndara sipas fushave të studimit që nga viti 2018.


Të drejtat pronësore dhe trashëgimore

Kosova ka një kornizë të fortë ligjore që garanton të drejta të barabarta të pronësisë dhe trashëgimisë për gratë dhe burrat. Në nenin 46 të Kushtetutës përcaktohet se e drejta në pronë është e garantuar për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe se askush nuk duhet të privohet arbitrarisht.²⁶⁵ Ligji për Trashëgiminë thekson se të gjithë janë të barabartë për të trashëguar pronën në të njëjtat kushte.²⁶⁶ Ligji thotë se e drejta për të hequr dorë nga trashëgimia ekziston si opsion përderisa nuk ndodh me detyrim.²⁶⁷ Ligji për Familjen thotë se prona që i takon njërit prej bashkëshortëve në momentin e lidhjes së martesës mbetet në pronësi të veçantë. Megjithatë, prona e fituar gjatë martesës është në pronësi të përbashkët.²⁶⁸

Gjendja aktuale

Megjithatë, përkundër kësaj kornize të fortë ligjore që u jep të drejta të barabarta pronësore burrave dhe grave, gratë në Kosovë vazhdojnë të përballen me sfida të konsiderueshme sa u përket të drejtave pronësore. Edhe pse ka pasur një rritje të ngadaltë por të qëndrueshme të pronësisë së grave në Kosovë, ajo vazhdon të mbetet një sfidë e përhapur për gratë dhe vajzat. Nga gjithsej 612,482 prona të regjistruara në Kosovë në vitin 2024, vetëm 19.8 për qind janë në pronësi të grave, ku përfshihen pronat që janë në pronësi të përbashkët të grave dhe burrave.²⁶⁹

Grafiku 10. Pronësia e grave 2010-2024



Kjo është rritur nga 10 për qind në vitin 2010, 14 për qind në vitin 2015 dhe 17 për qind në vitin 2018.²⁷⁰ Disa faktorë kanë kontribuar në këtë rritje, duke përfshirë fushatat e ndërgjegjësimit të publikut të organizuara nga ABGj-ja, organizatat e grave dhe akterë të tjerë. Megjithatë, masat afirmative të integruara në legjislacionin ekzistues kontribuojnë gjithashtu në këtë rritje. Ndoshta më i suksesshmi ka qenë Udhëzimi Administrativ nr. 2016. 3/2016, “Për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së

265 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, [Ligji nr. 2004/26 për Trashëgiminë](#).

266 Po aty. Neni 130.

267 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, [Ligji nr. 2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës](#).

268 [Agjencia Kadastrale e Kosovës](#) (qasur në shkurt 2024).

269 Rrjeti i Grave të Kosovës (2018). [Analiza Gjimore e Kosovës](#).

270 Numri i rasteve të përfituara nga ky Udhëzim Administrativ është rritur nga 105 në vitin 2016 në 5400 në vitin 2019.

paluajtshme të përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve”, i hartuar nga ABGj-ja në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Udhëzimi parasheh një sërë masash për të mundësuar regjistrimin e detyrueshëm të pronës së përbashkët të paluajtshme në emër të të dyve, burrit dhe gruas, dhe rikthehet çdo vit.²⁷¹

Disa faktorë kontribuojnë në shkallën e ulët të pronësisë të gratë në Kosovë. E para janë normat gjinore, rolet dhe traditat patriarkale të rrënjosura thellë, të cilat shpesh favorizojnë burrat para grave. Studimet sasiore mbi vetëdijesimin dhe opinionet nuk janë kryer kohëve të fundit. I fundit, i realizuar në vitin 2017, tregon se 80 për qind e kosovarëve (75 për qind e burrave dhe 85 për qind e grave) besojnë se burrat dhe gratë duhet të kenë të drejta të barabarta kur bëhet fjalë për pronën dhe trashëgiminë.²⁷² Ai gjithashtu tregon se vetëm 27 për qind e kosovarëve besojnë se djemtë dhe vajzat e tyre nuk duhet të trashëgojnë prona në mënyrë të barabartë.

Hulumtimet tregojnë se numri i grave që heqin dorë nga prona është shumë i lartë, pavarësisht ligjeve dhe politikave në fuqi për të garantuar të drejta të barabarta në trashëgimi. Përafërsisht 45 për qind e grave që kanë kaluar nëpër procese të formalizuara të trashëgimisë kanë hequr dorë nga pjesa e tyre e trashëgimisë.²⁷³ Kjo heqje dorë shpesh vjen nga presionet shoqërore, që rrjedhin nga vlerat tradicionale dhe pritshmëritë e familjes. Frika nga krijimi i mosmarrëveshje familjare ose nga ostracizmi mund të bëjë që shumë gra të heqin dorë nga të drejtat e tyre ligjore. Për më tepër, mungesa e ndërgjegjësimit ose keqkuptimi për të drejtat e tyre ligjore dhe përfitimet nga pronësia kontribuojnë në këtë shkallë të lartë të heqjes dorë.

Mungesa e pronës dhe trashëgimisë për gratë nuk është problem i izoluar pasi ndikon në aspekte të ndryshme të jetës së grave dhe aftësinë e tyre për të arritur sigurinë ekonomike dhe personale. Ndër të tjera, pa pronë, gratë kanë mundësi të kufizuara strehimi në rastet e dhunës me bazë gjinore, pasi atyre u mungon një hapësirë e sigurt për të shpëtuar. Përveç kësaj, pa pronë, gratë nuk mund të japin kolateral për kredi, gjë që kufizon mundësitë e tyre për ndërmarrësi dhe pavarësi financiare.

271 USAID Kosovo (2017). [Midterm National Survey on Property Rights in Kosovo](#).

272 Po aty.

273 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2022). [Anketa e Fugisë Punëtore](#).

Bujqësia

Në Kosovë, 62 për qind e popullsisë jeton në zonat rurale, duke përfshirë 61.6 për qind gra dhe 62.3 për qind burra. Prandaj, bujqësia luan një rol të rëndësishëm duke përbërë 6.9 për qind të BPV-së së Kosovës.²⁷⁴ Sektori i bujqësisë punëson 2.23 për qind të fuqisë punëtore formale, me burrat që përbëjnë 88.6 për qind të fuqisë punëtore dhe gratë 11.3 për qind.²⁷⁵ Megjithatë, siç u diskutua më lart në kapitullin “Joformaliteti”, përfshirja e grave dhe e burrave në bujqësi është shumë më e lartë se që sugjerojnë këto shifra zyrtare. Në fakt, shumica e punëve bujqësore bëhet nga anëtarët e familjes, me gratë që kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme, por kanë më pak pronësi.²⁷⁶

Në përgjithësi, gratë përballen me disa pengesa në bujqësi. Së pari, grantet dhe subvencionet në bujqësi janë ndarë historikisht në mënyrë joproporcionale, pasi gratë marrin shumë më pak fonde. Në vitin 2022, nga 28,981 fermerë që kishin aplikuar për subvencione qeveritare, 95 për qind kishin qenë burra dhe 5 për qind kishin qenë gra.²⁷⁷ Nga gratë që kishin aplikuar, 97 për qind prej tyre kishin marrë mbështetje, krahasuar me aplikantët burra, ku 98 për qind e tyre kishin marrë mbështetje.²⁷⁸

Gati një e treta e grave rurale i konsiderojnë informatat e pamjaftueshme si një sfidë të madhe në përdorimin e teknologjive moderne bujqësore. Kjo mungesë njohurish dhe burimesh pengon produktivitetin e tyre dhe kufizon mundësitë e tyre për zhvillim brenda sektorit.²⁷⁹ Pjesëmarrja e grave rurale në aktivitetet politike që lidhen me bujqësinë është dukshëm më e ulët se ajo e burrave, me 91 për qind të grave që nuk angazhohen krahasuar me 79 për qind të burrave ruralë që nuk angazhohen.²⁸⁰ Rolet tradicionale gjinore dhe modelet e migrimit ndërthurin këto sfida, duke zvogëluar disponueshmërinë e fuqisë punëtore dhe duke ndryshuar dinamikën e jetës rurale. Kjo zhvendosje rëndon në mënyrë disproporcionale gratë, të cilat shpesh vazhdojnë të marrin përsipër role bujqësore. Për më tepër, gratë përballen me qasje të kufizuara në makineri bujqësore dhe inpute, që zakonisht kanë nevojë për miratimin e familjes ose hasin në refuzim të plotë, gjë që kufizon më tej aftësinë e tyre për të kontribuar dhe për të përfituar nga sektori bujqësor.²⁸¹

274 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2022). [Anketa e Fuqisë Punëtore](#).

275 RrGGK (2024). Nën hije.

276 MBPZHR (2023). Raporti i Gjellbër.

277 Po aty.

278 RrGGK (e ardhshme 2024). Profili Gjinator në Bujqësi.

279 Po aty.

280 Po aty.

281 Korporata Ndërkombëtare Financiare dhe Zyra e Kryeministrit (2024). Përfshirja e Sistemit të Licencimit në Kosovë për Gratë dhe të Rinjtë (kopje fizike).

Sistemi i licencimit

Të kuptuarit e gjithëpërfshirjes së sistemit të licencimit në Kosovë është kyç për promovimin e barazisë gjinore, pasi identifikon barrierat që i pengojnë gratë dhe vajzat nga mundësitë profesionale, ekonomike dhe sociale.

Gratë dhe të rinjtë në Kosovë përballen me barrierat të larta administrative në marrjen e llojeve të ndryshme të licencave për shkak të proceseve të gjata dhe të ndërlikuara të aplikimit, udhëzimeve të paqarta dhe kostove të larta që lidhen me licencimin dhe rinovimin.²⁸² Ekziston një dallim i konsiderueshëm gjinor në fushat tradicionalisht të dominuara nga burrat, si sektori ligjor dhe ai i gjeodezisë. Përfaqësimi i grave të regjistruara si avokate që ushtrojnë profesionin është rritur nga 43 për qind në vitin 2012 në 64 për qind në vitin 2022, por fusha të tjera ende tregojnë pjesëmarrje të ulët të grave.²⁸³ Sektori i shëndetësisë tregon një numër të lartë licencash të dhëna për gratë, veçanërisht në infermieri dhe psikologji, ku gratë mbanin 80 për qind të licencave në vitin 2022. Letërnjoftimet dhe patentat e shoferit janë shërbimet më të zakonshme për të rinjtë, duke reflektuar kërkesat e detyrueshme të moshës. Licencat e sektorit shëndetësor janë gjithashtu të rëndësishme, me të rinjtë që mbajnë 88 për qind të licencave të infermierisë dhe psikologjisë të lëshuara në vitin 2022.²⁸⁴ Kufizimet financiare ndikojnë ndjeshëm te gratë dhe të rinjtë, me kosto të larta për aplikime, rinovime dhe trajnime shoqëruese që paraqesin pengesa për hyrjen në profesione të licencuara. Së fundi, gratë janë shumë të përfaqësuara në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë, të cilët kërkojnë licencim profesional. Megjithatë, nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm në përqindjen e grave të punësuar në këta sektorë nga viti 2012 në atë 2022, duke mbetur në rreth 56 për qind.²⁸⁵

282 Po aty.

283 Po aty.

284 Po aty.

285 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2023). [Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#). Neni 28.

PROMOVIMI I PJESËMARRRJES DHE LIDERSHIPIT TË BARABARTË

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përfshin një kuotë gjinore, ku së paku 30 për qind e listës së kandidatëve të subjektit politik duhet të përfshijë kandidatë nga gjinia e nënpërfaqësuar.²⁸⁶ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është përgjegjës për të siguruar që subjektet politike të përmbushin këtë kërkesë. Pas prezantimit të Ligjit për Barazinë Gjinore, duke vendosur një kuotë gjinore prej 50 për qind, të dy ligjet u panë si kontradiktore dhe KQZ-ja vazhdoi të zbatonte Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Qëllimi i kuotës ishte rritja e përfaqësimit të grave dhe në këtë mënyrë sigurimi i perspektivës gjinore në të gjitha nivelet vendimmarrëse. Megjithatë, në shumë raste gratë përfshihen vetëm në diskutime që lidhen me “çështjet e grave”, në krahasim me një spektër më të gjerë çështjesh.²⁸⁷

Përfaqësimi në nivel qendror

Kosova zgjodhi gruan e dytë presidente, duke bërë atë një nga vendet e pakta që ka më shumë se një grua në krye të shtetit.²⁸⁸ Më tej, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, Dr. Vjosa Osmani Sadriu, Presidente e Kosovës, theu rekordin e kandidatës më të votuar për Kuvendin e Kosovës.²⁸⁹

Efektet pozitive të kuotës gjinore janë veçanërisht të qarta në nivelin qendror. Në vitin 2007, 37 gra u zgjodhën deputete të Kuvendit të Kosovës, 26 prej të cilave kishin nevojë për mbështetjen e kuotës për të marrë një vend.²⁹⁰ Për krahasim, në vitin 2021, 44 gra u zgjodhën deputete dhe vetëm 9 prej tyre përfituan nga kuota. Institucionet ekzekutive nuk kanë kuotë gjinore që përcakton një minimum për përfaqësimin e të gjitha gjinive, si ajo që aplikohet në institucionet legjislativë dhe

286 Instituti Kombëtar Demokratik (2021). [Demokracia vibrante e Kosovës: Zvogëlimi i deficitit në pjesëmarrjen e plotë të grave](#). Faqe 7.

287 Instituti Kombëtar Demokratik (2021). [Demokracia vibrante e Kosovës: zvogëlimi i deficitit në pjesëmarrjen e plotë të grave](#). Faqe 16.

288 Informacioni i siguruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës.

289 Rrjeti i Grave të Kosovës (2021). Profili i shkurtër gjinor i Kosovës.

290 Instituti Kombëtar Demokratik (2021). [Demokracia vibrante e Kosovës: zvogëlimi i deficitit në pjesëmarrjen e plotë të grave](#). Faqe 17.

deri më sot nuk kanë arritur të përmbushin kuotën 50 për qind gjinore të përcaktuar me Ligjin për Barazi Gjinore. Kjo ka çuar në nënpërfaqësim të vazhdueshëm të grave në Kabinet. Përfaqësimi i grave në qeverinë e kaluar ka arritur një rekord, me gjashtë gra në kabinet: dy si zëvendëskryeminstre dhe pesë si ministre (njëra mban dy poste).²⁹¹

Përfaqësimi në nivel lokal

Përfaqësimi i grave në nivel lokal është më pak i kënaqshëm. Kosova para zgjedhjeve komunale të vitit 2021 ka pasur vetëm një kryetare komune, duke e bërë këtë pozitë më të paarritshmen. Në këto zgjedhje vetëm 14 gra ishin kandidatë për kryetare komune, që përfaqësonin 8 për qind të të gjithë kandidatëve.²⁹² Dy prej tyre u zgjodhën, një në Graçanicë dhe një në Ranillug.²⁹³ Gratë përfaqësonin 37 për qind të kandidatëve për asamblistë komunalë dhe kryesonin 12 për qind të listave të subjekteve politike. Në përgjithësi, 61 për qind e grave të zgjedhura për Kuvend Komunal nuk kishin nevojë për mbështetjen e kuotës, ndërsa 39 për qind e tyre u zgjodhën falë kuotës.²⁹⁴ Për krahasim, në zgjedhjet komunale të vitit 2017, 33 për qind e grave nuk kishin nevojë për mbështetje nga kuota për t'u zgjedhur, krahasuar me 67 për qind të tyre që ishin zgjedhur falë kuotës.

Angazhimi në politikë është natyrshëm i vështirë, por gratë që merren me politikën lokale përballen me edhe më shumë kundërshtime dhe pengesa. Këto sfida shtrihen nga burimet e kufizuara dhe mbështetja e pamjaftueshme nga partitë e tyre politike, deri te angazhimet familjare dhe presioni shoqëror për të shmangur përfshirjen në politikë.²⁹⁵ Për më tepër, gratë përballen me mundësi të pabarabarta për zhvillimin e kapaciteteve, gjë që dëmton besimin e tyre për të marrë role të ndryshme. Normat sociale e pengojnë ndjeshëm pjesëmarrjen politike të grave, veçanërisht në nivel lokal, dhe partitë politike i mbajnë këto sfida duke dështuar të adresojnë pabarazitë gjinore brenda programeve dhe statuseve të tyre.²⁹⁶

291 Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian (2021). [Raporti Përfundimtar i Zgjedhjeve Komunale në Kosovë 2021](#). Faqe 32.

292 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2021). [Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale 2021 nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve](#). Faqe 35 dhe 36.


293 Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian (2021). [Raporti Përfundimtar i Zgjedhjeve Komunale në Kosovë 2021](#). Faqe 32.

294 Instituti Demokratik Kombëtar (2021). [Kosovo's Vibrant Democracy: Closing the deficit in women's full participation](#). Faqe 43.

295 Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian (2021). [Kosovo 2021 Municipal Elections Final Report](#). Faqe 32.


296 Informacion i dhënë nga përfaqësuesi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Grafiku 11. Përfaqësimi në nivelet më të larta të qeverisjes lokale



Përfaqësimi i grave në pozitat drejtuese në nivelet ekzekutive dhe legjislative të qeverisjes lokale është mjaft i ulët. Konkretisht, në gjithë Kosovën janë vetëm 15 gra në pozita të tilla: dy kryetare komunash, gjashtë nënkryetare komunash, dhe shtatë kryetare kuvendesh komunale.²⁹⁷ Ky grafik tregon përfaqësimin e grave dhe burrave në nivelet më të larta të qeverisjes lokale. Përveç kryetareve të Komunës së Graçanicës dhe Ranillugut, gjashtë nënkryetare të komunave shërbejnë në Prishtinë, Gjiilan, Suharekë, Klinë, Podujevë dhe Graçanicë. Kuvendet komunale të udhëhequra nga gratë janë në Mitrovicën e Jugut, Prizren, Obiliq, Vushtrri, Novobërdë, Skenderaj dhe Gjakovë.²⁹⁸

Grafiku 12. Përfaqësimi i përgjithshëm i grave në qeverisjen lokale



297 Informacion i dhënë nga përfaqësuesi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

298 Po aty.

Përfaqësimi i përgjithshëm i grave në drejtori komunale në 30 komuna në vitin 2023 ishte 23.5 për qind. Konkretisht, ishin 101 gra dhe 328 burra që drejtonin drejtori të ndryshme.²⁹⁹ Ranillugu, Parteshi dhe Novobërda nuk kanë drejtoresha, ndërsa të dhënat për Mamushën, Mitrovicën Veriore, Leposaviqin, Zubin Potokun dhe Zveçanin nuk janë në dispozicion. Në përgjithësi, të dhënat e ofruara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për përfaqësimin e përgjithshëm në drejtori komunale tregojnë një trend pozitiv në përfaqësimin e grave në qeverisjen lokale në periudhën 2017–2022, siç tregohet në këtë grafik.³⁰⁰

Gratë në administratën publike

Gratë përbëjnë 43.88 për qind të nivelit qendror të administratës publike dhe 33.34 për qind të nivelit lokal.³⁰¹ Në përgjithësi, në vitin 2022, ato përfaqësonin 22.5 për qind të pozicioneve në nivelet vendimmarrëse. Përfaqësimi i grave në ndërmarrjet publike është 45.9 për qind, ku 30 për qind shërbejnë si kryetare bordesh, 22.2 për qind si drejtuese ekzekutive dhe 30 për qind si drejtuese financiare.³⁰² Përfaqësimi i grave në ndërmarrjet publike është 45.9 për qind, ku 30 për qind shërbejnë si kryetare bordesh, 22.2 për qind si drejtuese ekzekutive dhe 30 për qind si drejtuese financiare.³⁰³ Një sondazh për gratë në administratën publike tregoi se 32.2 për qind janë të interesuara për pozicione vendimmarrëse në të ardhmen, por 56.3 për qind e tyre besojnë se ka pak gjasa që kjo të ndodhë.³⁰⁴ Mungesa e mbështetjes dhe mungesa e besimit në aftësitë e grave për të marrë këto pozicione janë sfidat kryesore për avancimin e grave në administratën publike.³⁰⁵ Ndryshimet në kornizën ligjore për shërbyesit publikë gjithashtu kontribuojnë në pasiguri të shtuara për pozicionet vendimmarrëse. Kur u pyetën për veprimet e mundshme për të rritur diversitetin gjinor në këtë sektor, gratë e anketuara përmendën promovimin e historive të suksesshme të grave në vendimmarrje, trajnimin për gratë në fushat e menaxhimit dhe udhëheqjes, veprime afirmative që i inkurajojnë ato të shërbejnë në këto pozita, dhe ndryshimet në ligj që nuk kufizojnë një mandat, por lejojnë vazhdimin e tij bazuar në performancë.³⁰⁶ Në vitin 2024, Rrjeti për Fuqizimin e Grave në Vendimmarrje në Sektorin Publik u themelua përmes një bashkëpunimi midis Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Ambasadës Britanike në Kosovë.³⁰⁷ Rrjeti synon të promovojë modele të suksesshme dhe të mentorojë e udhëzojë gratë në sektorin publik drejt pozicioneve vendimmarrëse.

299 Po aty.

300 Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (2020). [Public Administration Reform in Kosovo, an ongoing effort](#). Page 52.

301 Ardhmeri e Barabarte (n.d). [Women's representation in politics and public administration: Kosovo](#). United Nations Development Programme.

302 Instituti Riinvest (2022). Gratë në Vendimmarrje në Sektorin Publik dhe Privat në Kosovë. Agjencia për Barazi Gjinore. Faqe 26.

303 Instituti Riinvest (2022). Gratë në Vendimmarrje në Sektorin Publik dhe Privat në Kosovë. Agjencia për Barazi Gjinore. Faqe 16–17.

304 Po aty. Faqe 20.


305 Po aty. Faqe 21.

306 Informacioni i siguruar nga Agjencia për Barazi Gjinore, qershor 2024.

307 Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian (2021). [Raporti Përfundimtar i Zgjedhjeve Komunale në Kosovë 2021](#). Faqe 32.

Pjesëmarrja në proceset zgjedhore

Grafiku 13. Përfaqësimi i grave dhe burrave në Komisionet Komunale të



Gratë janë dukshëm të nënpërfaqësuar në administratën zgjedhore. Nga 11 anëtarë të KQZ-së, vetëm një është grua. Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) në zgjedhjet komunale të vitit 2021 kishin 19 për qind gra në përbërjen e tyre dhe vetëm pesë gra ishin kryesuese të KKZ-ve.³⁰⁸ Për herë të parë, 16 KKZ janë nominuar nga shoqëria civile në vendet ku partitë politike nuk kanë arritur t'i nominojnë gratë sipas Deklaratës së nënshkruar në vitin 2015, ku janë zotuar ta bëjnë këtë. Përveç stafit zgjedhor, gratë ishin të nënpërfaqësuar edhe në vëzhgimin e zgjedhjeve, ku vetëm 22.39 për qind e vëzhguesve të zgjedhjeve të nominuar nga subjektet politike, ku përfshihen 25,810 individë, ishin gra.³⁰⁹

Grafiku tregon përfaqësimin e grave dhe burrave në KKZ dhe në vendvotime (VV) në Zgjedhjet Parlamentare dhe Zgjedhjet Komunale të vitit 2021.³¹⁰ Burrat dominojnë si këshilltarë zgjedhorë komunalë, me vetëm 15.33 për qind gra në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 dhe në zgjedhjet komunale të vitit 2021. Në të dyja zgjedhjet, Zubin Potoku kishte përfaqësimin më të lartë të grave në KKZ (77.8 për qind), pasuar nga Parteshi (60 për qind), Leposaviqi (45 për qind) dhe Drenasi (33.3 për qind).³¹¹ Në anën tjetër, nuk ka pasur gra anëtare të KKZ-ve në Dragash, Klinë, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Obiliq, Rahovec, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri, Graçanicë dhe Ranillug. Përfshirja e grave në vendvotime është më e lartë, me përkatësisht 30.51 për qind dhe 30.96 për qind në zgjedhjet parlamentare dhe komunale të vitit 2021. Kjo nuk pasqyron përfaqësimin në të gjitha komunitat. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, 18 komuna kishin mbi 30 për qind gra në vendvotime, ndërsa në zgjedhjet komunale të vitit

308 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2021). "Analiza e moshës dhe gjinisë për vëzhguesit e subjekteve politike në zgjedhjet e vitit 2021". Faqe 7.

309 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2023). "Analiza e përfaqësimit gjinor në organet drejtuese të zgjedhjeve në zgjedhjet e mëparshme". Faqe 5 dhe 7.

310 Po aty. Faqe 7.

311 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2023). "Analiza e të dhënave të zgjedhjeve të kaluara për përfaqësimin gjinor në Trupat Menaxhues të Zgjedhjeve". Faqe 5 dhe 9.

2021 ishin 15 komuna me një përfaqësim të tillë.³¹² Gratë janë ende të nënpërfaqësuar në mënyrë të konsiderueshme në stafin zgjedhor, mirëpo ka pasur një rritje në krahasim me dhjetë vjet më parë. Në zgjedhjet komunale të vitit 2013, përfaqësimi i grave në stafin zgjedhor ishte 17 për qind, ndërsa në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 ishte 20 për qind.³¹³

Media, media sociale dhe gjuha e urrejtjes

Puna në media është tejet kërkuese në përgjithësi, madje edhe më shumë për gratë. Të dhënat tregojnë se gratë gazetare përballen me diskriminim, jeta e tyre private vuan për shkak të punës dhe që ato janë të nënpaguara, me 50 për qind më pak se mesatarja në nivel kombëtar dhe 21.5 për qind që deklarojnë se ka hendek gjinor sa i përket pagesës, dhe se kolegët e tyre burra paguhen më shumë.³¹⁴ Sa i përket përfaqësimit, katër nga nëntë anëtarët e sapoemëruar të bordit të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës janë gra.³¹⁵ Po ashtu, gratë përbëjnë dy nga shtatë anëtarët e Komisionit të Pavarur të Mediave.³¹⁶ Gratë ishin të nënpërfaqësuar në media gjatë zgjedhjeve të vitit 2021 në raport me burrat që përbëjnë deri në 90 për qind të kandidatëve, analistëve dhe gazetarëve në debatet televizive.³¹⁷ Kjo është arsyeja pse këto panele u bënë të njohura si “patele të burrave”. Të dhënat e sondazhit me gratë gazetare tregojnë se kjo nuk është domosdo për shkak të burimeve të kufizuara, pasi mbi 40 për qind e të anketuarve [të grave gazetare] mbulojnë politikën.³¹⁸ Përveç mungesës së qasjes së barabartë në mundësi, puna në media përmban shqetësime të shumta të sigurisë për gratë. Ndër të tjera, 26.4 për qind e grave gazetare të anketuara kanë përjetuar ngacmime seksuale dhe disa prej tyre janë përballur edhe me sulme seksuale.³¹⁹

Gratë, veçanërisht ato që janë aktive në domenin publik, janë më shumë objektivi i dezinformimit sesa burrat.³²⁰ Për më tepër, analiza e përmbajtjes së dezinformative gjinore ka treguar që dhuna dhe ngacmimi në internet që përjetuan gratë vinte nga burrat në 89.6 për qind të rasteve dhe në 10.4 për qind nga gratë.³²¹ Mediat sociale kanë përforcuar dhunën ndaj grave në politikë, veçanërisht në formën e gjuhës së ashpër dhe sulmeve mizogjene.³²² Kjo u bë më e dukshme në zgjedhjet pas COVID-19-shit, të cilat e zhvendosën fushatën në platformat online. Në mënyrë të veçantë, gratë politike kanë përjetuar përkrahje seksiste dhe sipërfaqësore, shpesh duke zhvendosur vëmendjen nga ajo që bëjnë të mënyra se si duken ose sillen, gjë që mund t'i dekurajojë gratë të angazhohen në politikë.³²³ Sulme të

312 Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (2015). “Stafi zgjedhor në Zgjedhjet Kombëtare 2014 në Kosovë të ndara sipas gjinisë”. Faqe 3.

313 Gratë në Media: Studimi i Kosovës: Peaceful Change Initiative (2023). Faqe 4.

314 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (2024). [Zgjidhen Kryetari dhe Anëtarët e rinj të Bordit të AGK-së](#).

315 Komisioni i Pavarur të Mediave (2023). [Raporti vjetor i punës për 2022](#).

316 Instituti Kombëtar Demokratik. 2021. [Kosovo's 2021 Local Elections: Analysis of Inclusion and Information Integrity](#). Faqe 3.

317 Iniciativa për Ndryshim Paqësor (2023). [Gratë në Media: Anketa në Kosovë](#). Faqe 4.

318 Iniciativa për Ndryshim Paqësor (2023). [Gratë në Media: Anketa në Kosovë](#). Faqe 4.

319 Demokracia për Zhvillim (2023). [Mediat josociale: hulumtimi dhe ekspozimi i dezinformimit gjinor në Kosovë](#). Faqe 5.

320 Po aty.

321 Instituti Kombëtar Demokratik. 2021. Faqe 9.

322 Rrjeti i Grave të Kosovës (2024). [Barazia Gjinore: Në qendër të TI... dhe përtej një analize gjinore të digjitalizimit në Kosovë](#). Faqe 434.

323 Po aty. Faqe 436.

tilla përjetuan edhe presidentja Jahjaga edhe presidentja Osmani, e po ashtu edhe shumë politikane të tjera në role të ndryshme.

Mediat sociale janë përdorur gjerësisht si platformë për të nxitur gjuhën e urrejtjes, edhe në raste të ndjeshme të dhunës me bazë gjinore. Fajësimi i viktimave, veçanërisht në rastet e dhunës seksuale, dhe justifikimi i agresionit të burrave ndaj grave janë të zakonshme, të cilat mund t'i frikësojnë viktimat që të raportojnë dhe të marrin vëmendjen e medias.³²⁴ Mediat sociale gjithashtu kanë përkeqësuar gjuhën e urrejtjes ndaj komuniteteve LGBT+, dhe ndonjëherë kjo vjen edhe nga politikanët, madje edhe nga përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës, të cilët kanë shumë përkrahës në kanalet e tyre.³²⁵

Kultura, trashëgimia kulturore dhe sporti

Kultura dhe institucionet kulturore ndodhen nën ombrellën e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), ndërsa subjektet që kanë të bëjnë me sportin janë federatat me status OJQ. 80.4 për qind e të punësuarve në fushën e kulturës janë burra.³²⁶ Kjo masë e pabarazisë nuk reflektohet në nivelet vendimmarrëse, ku 44.4 për qind e institucioneve kulturore dhe 36.4 për qind e institucioneve të trashëgimisë kulturore udhëhiqen nga gratë.³²⁷

Të dhënat e ofruara më poshtë tregojnë ndarjen gjinore të përfituesve të mbështetjes financiare nga MKRS-ja, në kategori të ndryshme në tre vjetët e fundit. Siç shihet, nga këto skema mbështetëse kanë përfituar më shumë burra se gra, dhe diferenca në tre vjetët e fundit është rritur në favor të burrave. Në vitin 2021, 60.7 për qind e përfituesve ishin burra dhe 39.3 për qind ishin gra, në vitin 2022 ishin 66.7 për qind burra dhe 33.3 për qind gra, ndërsa në vitin 2023, 64.7 për qind e përfituesve ishin burra dhe 35.3 për qind ishin gra.³²⁸

324 Grupi i fokusit për grupet e marginalizuara në Kosovë u mbajt më 27 shkurt 2024.

325 Agjencia e Statistikave (2022). [Statistikat e Kulturës](#).

326 Të dhënat e siguruara nga përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, prill 2024.

327 Analizë e të dhënave të siguruara nga përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, prill 2024.

328 Të dhënat e siguruara nga përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, prill 2024.

Tabela 9. Përfituesit e mbështetjes financiare nga MKRS-ja, të ndarë sipas gjinisë

2021			2022		
Kategoria	Burra	Gra	Kategoria	Burra	Gra
Muzika	12	8	Sporti	22	19
Takimet letrare	12	10	Arti dhe trashëgimia kulturore	46	20
Teatri	4	4	Kultura	1	1
Promovimi	8	5	Veprat artistike	17	3
Filmi	8	2			
Diversiteti dhe dialogu kulturor	7	4			
Artet pamore	12	3			
Industria kreative	6	12			
Diplomacia kulturore	3	1			
Bibliotekat	12	5			
Kultura dhe trashëgimia kulturore*	142	108			
Sporti*	82	37			

2023		
Kategoria	Burra	Gra
Arti dhe kultura	147	86
Trashëgimia kulturore	85	66
Sporti	78	28
Botimi i librit	36	7
Veprat artistike	25	15

* Në këto kategori përfshihen edhe skemat e rimëkëmbjes ekonomike.

Krahas mbështetjes financiare për projekte dhe iniciativa specifike, MKRS-ja ka mbështetur 7 gra dhe 3 burra me bursa për master, doktoraturë (PhD) dhe programe të tjera pasuniversitare në fushën e trashëgimisë kulturore.³²⁹

Sa i përket sportit, në Komitetin Olimpik të Kosovës (KOK) ka baraspeshë gjinore, me 3 burra dhe 2 gra në Bordin Ekzekutiv, 2 burra dhe 1 grua përfaqësues të Federatave Olimpikë, 1 burrë dhe 1 grua përfaqësues të Federatës Jo-olimpikë, dhe 3 gra në poste administrative që përfaqësojnë sekretare të përgjithshme të federatave të tyre.³³⁰ Përderisa Kosova ka fituar 3 medalje të arta në Lojërat Olimpikë, hulumtimet tregojnë se gratë identifikojnë një sërë sfidash për të qenë sportiste profesionale, duke përfshirë mbështetjen financiare për punën e tyre, mjetet financiare individuale dhe diskriminimin me bazë gjinore.³³¹

329 Të dhënat e siguruar nga përfaqësuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, prill 2024.

330 Qendra Kosovare për Studime Gjinore (2022). [Gratë dhe vajzat në fushën e sportit: Hulumtim mbi stereotipet gjinore dhe barrierat që pengojnë qasjen e barabartë në sport](#). Faqe 14.

331 [Layout 1 \(peacewomen.org\)](#)

INTEGRIMI I AGJENDËS “GRATË, PAQJA DHE SIGURIA”

Analizë e shkurtër e politikave

Rezoluta 1325 e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Gratë, Paqja dhe Siguria” (UNSCR) u miratua në vitin 2000 nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Rezoluta trajton ndikimin e luftës te gratë, dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të grave në ndërtimin e paqes dhe zgjidhjen e konflikteve. Ajo bën thirrje për rritjen e përfaqësimit të grave në të gjitha nivelet vendimmarrëse në institucionet dhe mekanizmat kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Rezoluta thekson nevojën që të gjitha palët në konflikt të marrin masa të veçanta për t’i mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna me bazë gjinore, veçanërisht përdhunimi dhe format tjera të abuzimit seksual, në situata të konfliktit të armatosur dhe situatave pas konfliktit. Pasi që Kosova nuk është anëtare e OKB-së, ajo nuk është e obliguar ta zbatojë UNSCR 1325-shin.

Për më tepër, kjo Rezolutë nuk është miratuar kurrë në mënyrë eksplicite në kornizën legjislative

kombëtare, siç kanë qenë CEDAW-i dhe Konventa e Stambollit. Megjithatë, shumë aspekte të UNSCR-së janë përfshirë në Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore.

Kosova miratoi Planin e saj të parë Kombëtar të Veprimit (PKV) në vitin 2012 për periudhën 2013–2015.³³² PKV-ja është zhvilluar nga ABG-ja, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera qendrore dhe organizatat e shoqërisë civile. Objektivat kryesore të PKV-së ishin promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut që u takojnë grave, si dhe njohja e viktimave të Luftës së Kosovës. Për më tepër, PKV-ja identifikoi tri rezultate: rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset vendimmarrëse dhe paqeruajtëse e paqëndruesë; integrimin e perspektivave gjinore në çështjet e sigurisë dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në strukturat e sigurisë; dhe, përmirësimin e qasjes në mbrojtje, drejtësi, rehabilitim dhe riintegrim për të mbijetuarit e dhunës seksuale, torturës dhe formave të tjera të dhunës që lidhen me konfliktin/luftën.³³³ Në total, 79 për qind e PKV-së u zbatua, duke përfshirë 89 për qind të objektivit të parë, 64 për qind të objektivit të dytë dhe 84 për qind të objektivit të tretë.³³⁴ Asnjë PKV shtesë nuk është zhvilluar, pasi Rezoluta është zbatuar në politika

332 Po aty.

333 [Ballina-shqip.pdf \(rks-gov.net\)](#)

334 Rrjeti i Grave të Kosovës (2022). [1325-Facts-and-Fables-1.pdf \(womensnetwork.org\)](#).

të tjera. Përveç kësaj, disa institucione si Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Policia e Kosovës (PK) përfshijnë politikat e brendshme për gratë, paqen dhe sigurinë.³³⁵ Për më tepër, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (2015–2019) përfshin atë që mund të konsiderohet një Plan i Dytë Kombëtar i Veprimit, i cili përmban shumë elemente të agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria (GPS) brenda objektivave, iniciativave dhe treguesve të tij të performancës. Këto aspekte janë integruar në Shtyllën e III-të të PKBGj-së.

Përfaqësimi i grave në misionet diplomatike

Tabela 10. Të dhënat e ndara sipas gjinisë për misionet diplomatike në Kosovë

Viti	Gra (%)	Burra (%)	Totali
2020	32.0%	68.0%	150
2021	29.7%	70.3%	148
2022	29.7%	70.3%	148
2023	36.0%	64.0%	139

Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore kërkon përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha nivelet vendimmarrëse, duke përfshirë edhe misionet diplomatike. Për më tepër, Rezoluta 1325 e OKB-së mbron gjithashtu përfaqësimin e barabartë të grave në të gjitha nivelet vendimmarrëse, duke përfshirë paqen dhe sigurinë. Agjenda GPS thekson më tej rëndësinë e integritit të perspektivave të grave për të rritur efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e nismave të paqes.

Tabela 11. Përfaqësimi në nivele vendimmarrëse në misionet diplomatike

Viti	Totali	Gra (%)	Burra (%)
2020	52	25%	75%
2021	52	21.1%	78.8%
2022	45	24.4%	75.5%
2023	45	24.4%	75.6%

Në përgjithësi, përfaqësimi i barabartë siguron që të merren parasysh pikëpamjet e ndryshme, duke çuar në angazhim diplomatik më të nuancuar dhe më të fortë.

Gratë mbeten të nënpërfaqësuara në misionet diplomatike, si në nivel të përgjithshëm ashtu edhe në nivel vendimmarrës. Pavarësisht luhatjeve të lehta, përfaqësimi i grave ka mbetur vazhdimisht nën një të tretën e totalit në misionet diplomatike, me përqindje që ndryshojnë nga 29.7 për qind në 35.9 për qind nga viti 2020 deri në vitin 2023. Në nivelet vendimmarrëse, situata është edhe më e theksuar, ku përfaqësimi i grave nuk e kalon kurrë shifrën 25 për qind dhe me rënie në 21.1 për qind në vitin 2021.

335 Rrjeti i Grave të Kosovës (2022). [1325 Facts and Fables: A collection of stories about the implementation of the United Nations Security Council Resolution 1325 on Women, Peace, and Security in Kosovo, Second Edition.](#)

Përfaqësimi i grave në polici dhe në forcat e sigurisë

Tabela 12: Përfaqësimi në Policinë e Kosovës, i ndarë sipas gradës dhe gjinisë

Grada	Burra (%)	Gra (%)	Totali
Drejtor i Përgjithshëm	100%	0	1
Zëvendës drejtor i Përgjithshëm	100%	0	2
Drejtor i Departamentit	85.7%	14.3%	7
Kolonel	86.4%	13.6%	22
Nënkolonel	92.3%	7.7%	39
Major	90.4%	9.6%	83
Kapiten	89.9%	10.1%	149
Toger	91.4%	8.6%	314
Rreshter	89.1%	10.9%	869
Zyrtar i Lartë Policor	86.1%	13.9%	5385
Zyrtar Policor	92.0%	8.0%	224

Barazia gjinore në Policinë e Kosovës është shumë e rëndësishme për të krijuar një mjedis të larmishëm dhe gjithëpërfshirës që pasqyron nevojat dhe perspektivat e shoqërisë. Përfaqësimi i barabartë rrit proceset e vendimmarrjes dhe efektivitetin operacional duke përfshirë një gamë më të gjerë përvojash dhe pikëpamjesh. Tabela për përfaqësimin e grave në Policinë e Kosovës ilustron një pabarazi të konsiderueshme gjinore në gradat e ndryshme. Nga drejtorët e përgjithshëm tek zyrtarët policorë, pjesëmarrja e grave mbetet prapa me përqindje që ndryshojnë nga 0 në 13.9 për qind në pozicionet e larta dhe në rolet operationale.

Tabela 13: Oficerët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të ndarë sipas gradës dhe gjinisë

Grada	Gra (%)	Burra (%)	Totali
Gjenerallejtënant / OF-8	0,0%	100.0%	1
Gjeneralmajor / OF-7	33.3%	66.7%	3
Gjeneralmajor / OF-6	0,0%	100.0%	5
Kolonel / OF-5	2.9%	97.1%	34
Nënkolonel / OF-4	3.6%	96.4%	83
Major / OF-3	10.3%	89.7%	68
Kapiten / OF-2	3.7%	96.3%	81
Toger / OF-1	11.1%	88.9%	45
Nëntoger / OF-0	11.1%	88.9%	99

Gratë janë gjithashtu të nënpërfaqësuar në Forcat e Sigurisë së Kosovës, veçanërisht në gradat më të larta. Brenda gradave të oficerëve, nuk ka asnjë grua që mban pozicionin Gjenerallejtënant (OF-8) dhe vetëm një e treta e pozicioneve Gjeneralmajor (OF-7) mbahen nga gratë. Përfaqësimi zvogëlohet më tej ku asnjë grua nuk është në nivelin Gjeneralmajor (OF-6) dhe shumë pak në nivelet e Kolonelit (OF-5) dhe Nënkolonelit (OF-4), përkatësisht me 2.9 për qind dhe 3.6 për qind. Përfaqësimi rritet pak në gradat më të ulëta të oficerëve ku gratë përbëjnë 10.3 për qind të Majorëve (OF-3), dhe rreth 11.1 për qind në pozicionet e Togerit (OF-1) dhe të Nëntogerit (OF-0).

Në të kundërt, gradat nënofficere tregojnë një përfaqësim pak më të mirë, por ende të kufizuar, të grave. Gradat më të larta si Rreshter Major (OR-9) dhe Rreshter Master (OR-8) kanë përfaqësim shumë të ulët të grave përkatësisht me 5.1 për qind dhe 7 për qind. Pabarazia është e madhe në nivelin e Rreshterit të Klasit të Parë (OR-7) me vetëm 1.7 për qind gra. Megjithatë, ka rritje relative në gradat më të ulëta, ku gratë përbëjnë 15.6 për qind të Rreshterëve (OR-5) dhe 15.4 për qind të Tetarëve ose Specialistëve (OR-4), duke shfaqur një raport gjinor pak më të balancuar në krahasim me gradat më të larta, por ende me nënpërfaqësim të theksuar.

Tabela 14. Staf nënofficer në Forcën e Sigurisë së Kosovës, i ndarë sipas gradës dhe gjinisë

Grada	Gra (%)	Burra (%)	Totali
Rreshter Major / OR-9	5.1%	94.9%	39
Rreshter Master / OR-8	7.0%	93.0%	128
Rreshter i Klasit të Parë / OR-7	1.7%	98.3%	172
Rreshter Shtabor / OR-6	7.3%	92.7%	273
Rreshter / OR-5	15.6%	84.4%	591
Tetar-Specialist / OR-4	15.4%	84.6%	182
Ushtar i Klasit të Parë / OR-3	11.4%	88.6%	953
Ushtar / OR-2	5.5%	94.5%	1381

Përfaqësimi i Grave në Dialogun Kosovë-Serbi

Dialogu Kosovë-Serbi, i cili ka për qëllim zgjidhjen e konflikteve dhe promovimin e stabilitetit, ka parë përfshirje minimale të grave në të gjitha nivelet. Gratë janë përjashtuar në masë të madhe nga rrugët formale të negociatave, duke kufizuar ndikimin e tyre në vendimet kyçe.³³⁶ Ky përjashtim pasqyron një problem më të gjerë të pabarazisë gjinore në proceset e paqes, ku zërat dhe perspektivat e grave shpesh injorohen. Pa pjesëmarrjen e tyre, dialogu humb qasjen gjithëpërfshirëse që është e nevojshme për paqe të qëndrueshme. Dialogu Kosovë-Serbi gjithashtu ka injoruar prioritetet dhe shqetësimet e grave. Çështje si dhuna gjinore, fuqizimi ekonomik dhe përfshirja sociale nuk janë trajtuar në mënyrë adekuate në negociata.³³⁷

Dhuna seksuale e shkaktuar gjatë konfliktit

Pasojat e luftës së viteve 1998/99 nxorën në dritë dhunën sistematike seksuale të ushtruar ndaj individëve, e cila mbeti një çështje e pazgjidhur për vite me radhë. Duke njohur ashpërsinë dhe ndikimin e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, Kuvendi i Kosovës ndërmoi hapa të rëndësishëm drejt njohjes ligjore dhe mbështetjes për të mbijetuarit. Në mars të vitit 2014, Kuvendi miratoi ndryshimet në ligjet ekzistuese për viktimat e luftës, të cilat për herë të parë zgjerorin njohjen ligjore për viktimat e dhunës seksuale gjatë konfliktit. Konkretisht, ndryshimet janë bërë në Ligjin Nr. 04/L-054, i cili fillimisht trajtonte statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe viktimave civile të luftës.³³⁸ Këto ndryshime u përfshinë në Ligjin e ri Nr. 04/L-172 dhe synonin t'u siguronin të mbijetuarve një kornizë ligjore për njohje dhe dëmshpërblim.³³⁹

Pas këtyre ndryshimeve legjislativë, janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për funksionalizimin e dispozitave ligjore përmes themelimit të një organi të specializuar, Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës.³⁴⁰ Ky Komision u krijua për të verifikuar statusin e viktimave dhe të mbijetuarve, duke lehtësuar qasjen e tyre në përfitimet e parashikuara nga korniza e re ligjore. Në fillim, komisioni kishte një mandat pesëvjeçar, i cili u zgjat edhe për pesë vjet të tjera në vitin 2025.³⁴¹ Komisioni ka për detyrë një proces verifikimi të detajuar, i cili përfshin shqyrtimin e aplikimeve, vlerësimin e provave dhe zhvillimin e seancave,

336 Po aty.

337 https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Library/Publications/2016/The-Conflict-DId-Not-Bring-Us-Flowers_ENG.pdf

338 Po aty.

339 <https://mpms.rks-gov.net/epdm-package/rregullore-grk-nr-222015-per-percaktimin-e-procedurave-per-njohjen-dhe-verifikimin-e-statusit-te-viktimave-te-dhunes-seksuale-gjate-luftes-clirimtare-te-kosoves-pdf/?epdmdl=4847>

340 Ka pasur thirrje që komisioni të ketë mandat të pacaktuar dhe të mos ketë kufizime kohore..

341 Po aty dhe <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/udhezues-per-procesin-e-njohjes-dhe-verifikimit-te-statusit-te-personave-te-dhunuar-gjate-luftes-clirimtare-te-kosoves-pdf/?wpdmdl=4850&ind=VURIw4taVUVTIFDDi1IgUFJPQOVTSU4gRS-BOSk9ISkVTIERIRSBËRVJJRkILSU1JVCBUw4sgU1RBVfVTSVQgVMOLIFBFUINPTkFËRSBUë4s-gREhVTIVBUiBHSkFUw4sgTFVGVMOLUyDDh0xJUKINVEFSRSBUw4sgS09TT1bDi1MucGRm>

nëse është e nevojshme, për të përcaktuar vlefshmërinë e çdo pretendimi.³⁴² Aplikantëve u kërkohet të ofrojnë dokumentacion ose prova që mbështesin statusin e tyre si viktimë, të cilat komisioni i vlerëson sipas kriterëve dhe udhëzimeve të paracaktuara të vendosura në kornizën ligjore. Për të ndihmuar procesin e aplikimit dhe për t'u siguruar që të mbijetuarit të marrin mbështetjen e nevojshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka autorizuar katër organizata joqeveritare (OJQ) që janë të specializuara në punën me të mbijetuarit e DhSK-së. Këto OJQ luajnë një rol kritik në asistimin e të mbijetuarve gjatë procesit të aplikimit dhe më gjerë, duke u ofruar atyre udhëzimet, mbështetjen emocionale dhe avokimin e nevojshëm. Pas verifikimit, të mbijetuarit kanë të drejtë të marrin një pagesë mujore prej €230 si kompensim për vuajtjet e tyre, duke i adresuar vështirësitë psikologjike dhe ekonomike që i kanë kaluar.

Tabela 15. Numri i aplikacioneve të pranuar nga Komisioni 2018 - 2024

Viti	Numri i aplikacioneve
2018	921
2019	268
2020	204
2021	229
2022	241
2023	131
2024	16

Komisioni për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar në Kosovë ka pranuar gjithsej 2018 aplikacione nga viti 2018 deri në vitin 2024. Numri më i madh i aplikacioneve ka qenë në vitin 2018, me 921 parashtresa, ndjekur nga një rënie në vitet në vijim, me numrin më të ulët prej 16 aplikimeve në vitin 2024. Të dhënat pasqyrojnë një rritje fillestare të aplikimeve, duke u ulur në mënyrë të qëndrueshme me kalimin e viteve.

Të dhënat e marra nga komisioni tregojnë se janë trajtuar gjithsej 2,002 raste, 1,859 gra dhe 143 burra. Prej tyre janë aprovuar 1,624 raste, 1,535 gra dhe 89 burra. Ndërkohë, janë refuzuar 318 raste, ku 272 kanë të bëjnë me gra dhe 46 me burra. Kjo ndarje nënvizon një përqindje më të lartë të angazhimit dhe miratimit për gratë në proces.

342 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2009). [Ligji nr.03/L-020 për Mbrojtjen e Mjedisit](#), 2009.

Tabela 16. Rastet e trajtuara, të miratuara dhe të refuzuara nga Komisioni, të ndara sipas gjinisë

	Gra	Burra	Totali
Rastet e trajtuara	92.8%	7.1%	2002
Të miratuara	94.5%	5.4%	1624
Të refuzuara	85.5%	14.4%	318

NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE MJEDISI

Analiza e politikave

Në përgjithësi, kornizës ligjore për mjedisin dhe ndryshimet klimatike në Kosovë i mungon perspektiva gjinore. Legjislati, duke filluar nga mbrojtja e mjedisit e deri te strategjitë e energjisë, vazhdimisht dështon t'i përfshijë vlerësimet e ndikimit gjinor ose të integrojë një perspektivë gjinore brenda vetes, duke i pranuar efektet e dallueshme për gratë dhe burrat. Ligjeve dhe politikave kryesore si *Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit*, i cili është gur themeli për ruajtjen e mjedisit në Kosovë,³⁴³ *Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)*,³⁴⁴ *Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes*,³⁴⁵ *Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja*,³⁴⁶ u mungon perspektiva gjinore. Strategjive kryesore mjedisore gjithashtu në përgjithësi u mungon perspektiva gjinore.

Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019–2028 thotë se synon të rrisë kapacitetin e grupeve të cënueshme, përfshirë gratë, për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, por nuk dështon të përfshijë masa konkrete drejt këtij qëllimi.³⁴⁷

Megjithatë, ka disa zhvillime pozitive së fundmi. Strategjia e Energjisë 2022 integron perspektivën gjinore dhe vendos qëllimin që deri në vitin 2025, 25 për qind e të punësuarve në sektorin e energjisë në Kosovë të jenë gra.³⁴⁸ Përveç kësaj, Ligji 08/L-250 i vitit 2024 për Ndryshime Klimatike thotë se MMPHI-ja do të zhvillojë udhëzime për integrimin e perspektivës gjinore në programet e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.³⁴⁹

Situata aktuale

Ndryshimet klimatike prekin të gjithë, por jo në të njëjtën mënyrë. Komunitetet e marginalizuara dhe grupet e përjashtuara nga shoqëria, duke përfshirë gratë, shpesh përballen me pasoja më të rënda për shkak të pabarazive ekzistuese dhe qasjes së kufizuar në burime.³⁵⁰ Kjo cenueshmëri e shtuar vjen kryesisht nga pabarazitë ekzistuese në qasjen në arsim, informacion, burime, trajnime dhe kujdes shëndetësor, duke i bërë gratë dhe grupet e tjera më pak të priara për t'iu përshtatur me sukses ndryshimeve klimatike.³⁵¹ Gratë dhe grupet e tjera të cënueshme si të rinjtë dhe pakicat etnike janë përgjithësisht më të cënueshme nga ndikimet negative të ndryshimeve klimatike. Hulumtimet tregojnë se vdekshmëria e grave nga

343 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2010). [Ligji 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis](#).

344 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2009). [Ligji nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes](#).

345 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2010). [Ligji nr.03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja](#).

346 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (2018). [Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019–2028](#).

347 Ministria e Ekonomisë (2022). [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022–2031](#).

348 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2024). [Ligji nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike](#).

349 Instituti Ndërkombëtar për Zhvillim të Qëndrueshëm (2019). [Why Gender Matters in Climate Change Adaptation](#).

350 Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (2022). [Climate Change 2022: Impacts, Adaptation, and Vulnerability](#).

351 Fondi Global për Reduktimin dhe Rimëkëmbjen nga Fatkeqësitë (2021). [Gender Dimensions of Disaster Risk and Resilience](#).

fatkeqësitë e lidhura me klimën priret të jetë më e lartë se ajo e burrave; vajzat kanë më shumë gjasa ta braktisin shkollën gjatë thatësirës së zgjatur; dhe, zhvendosja e detyruar dhe fatkeqësitë natyrore i vendosin gratë dhe vajzat në rrezik të shtuar ndaj dhunës me bazë gjinore, siç është shfrytëzimi dhe abuzimi seksual.³⁵² Hulumtimet shtesë tregojnë se të gjitha grupet e cënueshme janë më pak të afta të përshtaten me ndikimet negative të ndryshimeve klimatike në krahasim me burrat, shpesh për shkak të barrierave socio-kulturore dhe ekonomike.³⁵³ Për më tepër, të rinjtë si dhe pakicat etnike përballen gjithashtu me sfida unike të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, kryesisht për shkak të pabarazive socio-ekonomike dhe kulturore.

Përfaqësimi dhe vendimmarrja

Tabela 17: Të dhënat e ndara sipas gjinisë për përfaqësimin në institucionet që punojnë në lidhje me mjedisin dhe ndryshime klimatike

Institucioni	Niveli i përgjithshëm			Niveli i vendimmarrjes		
	Gra	Burra	Totali	Gra	Burra	Totali
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	46.9%	53%	164	45.9%	54%	37
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit	12.6%	87.3%	103	11.7%	88.2%	17
Instituti Hidrometeorologjik	11.1%	88.8%	18	0	100%	1
Agjencia për Mbrojtjen e Natyrës	16.6%	83.3%	6	0	100%	2

Gratë janë të nënpërfaqësuar në institucionet që punojnë për mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gratë përbëjnë 46.95 për qind të fuqisë punëtore dhe 45.95 për qind të roleve vendimmarrëse. Në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit, këto shifra zbresin përkatësisht në 12.62 për qind dhe 11.76 për qind. Instituti Hidrometeorologjik dhe Agjencia për Mbrojtjen e Natyrës kanë përfaqësim edhe më të ulët të grave, ku ato përbëjnë 11.11 për qind dhe 16.67 për qind të fuqisë punëtore, teksa asnjë grua nuk mban pozicione vendimmarrëse.

Fatkeqësisht, MMPHI-ja nuk mbledh dhe përpunon të dhëna të ndara sipas gjinisë për pjesëmarrësit në takime publike apo dëgjime buxhetore.³⁵⁴ Megjithatë, përvoja e drejtpërdrejtë nga gratë aktiviste që punojnë me mjedisin dhe ndryshimet klimatike tregon se gratë rrallë marrin pjesë në këto seanca.³⁵⁵ Normat kulturore dhe pritshmëritë shoqërore, të kombinuara me mungesën e besimit dhe qasjes në informacion, identifikohen vazhdimisht si barriera të konsiderueshme për pjesëmarrjen e plotë të grave në politikën dhe veprimin ndaj ndryshimeve klimatike, si brenda institucioneve ashtu edhe si qytetare.³⁵⁶

352 Përmbledhje e karbonit (2021). [Tackling gender inequality is 'crucial' for climate adaptation](#).

353 Korrespondencë me MMPHI-në, mars 2024.

354 Diskutim në fokus grup, shkurt 2024.

355 Po aty.

356 <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-01/IPA%20III%202021%20043-659%204%20-%20Annex%204%20E2%80%93%20EU%20for%20Environment.PDF>

Ky nënpërfaqësim shtrihet në menaxhimin e projekteve dhe politikave të lidhura me klimën, ku burrat zënë kryesisht pozicione vendimmarrëse.

Analiza e drejtpërdrejtë e ndikimeve të diferencuara të ndryshimeve klimatike në grupe të ndryshme shoqërore, duke përfshirë gratë, burrat dhe grupet e marginalizuara si të rinjtë dhe pakicat në Kosovë, nuk është kryer. Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë i bën analizat e tilla mjaft sfiduese. Kosovës i mungojnë të dhënat e ndara sipas gjinisë në lidhje me mjedisin, ndryshimet klimatike dhe ndotjen.³⁵⁷ Për shembull, nuk ka të dhëna, mes tjerash, për incidencën e sëmundjeve të lidhura me mjedisin sipas gjinisë, moshës ose përkatësisë etnike; nuk ka të dhëna për qasjen në ujë të pastër dhe objektet sanitare të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike; nuk ka të dhëna sasiore mbi ndikimet e diferencuara të ndotjes së ajrit ose normat e punësimit në vendet e gjelbra sipas gjinisë. Duket se ekziston një konsensus midis aktivistëve dhe praktikuesve se Kosova nuk është ndryshe nga pjesa tjetër e botës, dhe se ndryshimet klimatike ndikojnë më rëndë te gratë dhe vajzat për shkak të pabarazive socio-ekonomike dhe qasjes së kufizuar në burimet thelbësore, duke përfshirë ujin, kujdesin shëndetësor dhe pronën.³⁵⁸ Për shembull, përmbytjet, të cilat janë pasojë e drejtpërdrejtë e ndryshimeve klimatike, prekin në mënyrë joproporcionale gratë, veçanërisht ato përgjegjëse për menaxhimin e ekonomisë familjare dhe detyrat e kujdesit. Këtë e vunë re gratë aktviste gjatë përmbytjeve të fundit në vitin 2023.³⁵⁹ Për më tepër, për shkak se gratë në shumë komunitete priren të qëndrojnë më shumë në shtëpi, ekspozimi i tyre ndaj rreziqeve mjedisore në mjedisin e tyre të afërt është më i lartë. Të jetuarit pranë zonave të ndotura, siç është Obiliqi, mund të çojë në probleme të drejtpërdrejta shëndetësore, duke filluar nga problemet e frymëmarrjes deri te sëmundjet që lidhen me higjienën e ujit dhe kanalizimeve, duke ndikuar kështu në mirëqenien dhe aftësinë e tyre për t'u kujdesur për familjet e tyre.³⁶⁰ Për më tepër, ndikimet ekonomike të ndryshimeve klimatike, si reduktimi i produktivitetit bujqësor dhe humbja e mjeteve të jetesës, godasin më shumë gratë, të cilat, siç mund ta shohim më lart, përbëjnë shumicën e punëtorëve në familjet bujqësore në ekonominë joformale.

Ka shumë faktorë që kontribuojnë në nënpërfaqësimin e grave në konsultimet publike. Përgjegjësitë e papaguara të kujdesit, veçanërisht, vazhdojnë të ndikojnë shumë në aftësinë e grave për të kryer çfarëdo aktiviteti jashtë shtëpisë. Një faktor tjetër përfshin mungesën e ndërjegjësimit të kombinuar me reklamimin joadekuat. Shumë gra, veçanërisht ato në zonat më rurale që nuk përdorin shpesh mediat sociale dhe internetin, nuk kanë qasje në informata mbi konsultimet publike në radhë të parë.³⁶¹ Kjo mungesë e vetëdijes vazhdon pasi institucionet publike nuk përdorin masa të ndjeshme gjinore për rënien në kontakt dhe komunikimin.³⁶² Për shembull, përderisa shumica e informatave mbi konsultimet publike postohen në mediat sociale, hulumtimi i kryer ndërkombëtarisht tregon se burrat përdorin mediat sociale më shumë për marrjen e informatave, ndërsa gratë i përdorin ato për t'i mbajtur lidhjet me miqtë dhe familjen.³⁶³ Në Kosovë nuk është bërë asnjë analizë e thellë se si gratë dhe burrat marrin informata, dhe se cilat janë kanalet më të mira për t'i arritur dhe informuar ato.

357 Diskutim në fokus grup, shkurt 2024.

358 Komisioni Evropian (2023). [EMSR646: Vërshimet në Kosovë](#).

359 Diskutim në fokus grup, shkurt 2024.

360 Po aty.

361 Po aty.

362 Media Sociale Sot (2016). [Mediat sociale sot, sjelljet specifike gjinore në mediat sociale dhe çfarë nënkuptojnë ato për komunikimet në internet](#).

363 Ministria e Zhvillimit Ekonomik (2024). [Teknologjia e Informacionit dhe Telekomunikacionit](#)

Digjitalizimi

Në përgjithësi, ligjeve, politikave dhe strategjive për digjitalizimin dhe TIK-un në Kosovë u mungon perspektiva gjinore. Kjo përfshin Agjendën Digjitale 2030³⁶⁴ dhe Strategjinë e E-Qeverisjes për Kosovën 2023–2027³⁶⁵ të cilat fokusohen në digjitalizimin e sektorit publik. Digjitalizimi në Kosovë ka pasur zhvillim të rëndësishëm në vitet e fundit, duke u fokusuar në eksportimin e shërbimeve të TI-së, përmirësimin e shërbimeve qeveritare, arsimit dhe sektorëve të biznesit përmes teknologjisë. Qasja e Kosovës ndaj digjitalizimit është pjesë e strategjisë së saj më të gjerë për rritje ekonomike dhe integrim në strukturat evropiane. Përpjekjet përfshijnë përmirësimin e infrastrukturës së internetit, promovimin e shkrim-leximit digjital dhe mbështetjen e bizneseve fillestare. Qeveria ka lansuar shërbime të ndryshme elektronike, duke synuar përmirësimin e transparencës dhe efikasitetit në shërbimet publike. Në vitin 2021, eksportet e shërbimeve të TIK-ut arritën në €99 milionë në vitin 2021, ose 5.1 për qind të totalit të eksporteve të shërbimeve të Kosovës.³⁶⁶

Gratë mbeten të nënpërfaqësuar në digjitalizim në sektorin publik në Kosovë. Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), një institucion kryesor për shërbimet e internetit dhe sigurinë kibernetike, ka vetëm punonjës burra.³⁶⁷ Në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) ka përfaqësim më të barabartë, me 156 gra (49 për qind) dhe 164 burra (51 për qind).³⁶⁸ Megjithatë, gratë janë më pak të përfaqësuar në role vendimmarrëse, duke mbajtur vetëm 38 për qind të këtyre pozicioneve. Departamentet e TI-së nëpër ministri të ndryshme udhëhiqen kryesisht nga burra, me 92 për qind të roleve udhëheqëse të zëna nga ta, gjë që tregon një hendek të madh gjinor në pozitat udhëheqëse të TI-së.³⁶⁹ Gratë janë gjithashtu të nënpërfaqësuar në sektorin privat për sa u përket TIK-ut dhe digjitalizimit. Burrat përbëjnë rreth 85 për qind të numrit të përgjithshëm të sipërmarrësve në TIK, një shifër që është 5.5 herë më e lartë se ajo e grave, të cilat përbëjnë vetëm 15.24 për qind të sipërmarrësve.³⁷⁰

Në përgjithësi 99 për qind e qytetarëve në Kosovë kanë qasje në internet dhe janë të kyçur në rrjetin elektrik sa i përket infrastrukturës së konektivitetit.³⁷¹ Burrat dhe gratë lidhen me Wi-Fi në të njëjtën shkallë prej 97 për qind; gratë dhe burrat lidhen me LTE/3G/4G përkatësisht me 48 për qind dhe 50 për qind, si dhe gratë dhe burrat lidhen me internetin kabllor me 41 për qind dhe 47 për qind, respektivisht. Shumica e familjeve përdorin televizion kabllor digjital (99 për qind), pasuar nga telefonat e mençur (98 për qind) dhe laptopët (65 për qind). Më shpesh, njerëzit përdorin telefona të mençur për t'u lidhur me internet në shtëpi (95 për qind e grave dhe 96 për qind e burrave), ndërsa 31 për qind e grave dhe 39 për qind e burrave përdorin tabletat elektronike.³⁷² Rreth 14 për qind e qytetarëve (14 për qind e grave dhe 11 për qind e burrave) deklarojnë se nuk kishin dëgjuar kurrë për platformën e-Kosova.³⁷³ Për më

364 Ministria e Administratës Publike, Republika e Kosovës (2024). [Strategjia e Kosovës për Qeverisje Elektronike 2023-2027](#)

365 Forumi Ekonomik Gjerman (2022). [Kosovo's ICT and BPO sector: developments and outlook](#). Qasur në mars 2024.

366 Rrjeti i Grave të Kosovës (2024). [Barazia Gjinore dhe TI: Analiza Gjinore e Digjitalizimit në Kosovë](#).

367 Po aty.

368 Po aty.

369 Qendra e Inovacionit në Kosovë, Startup Ecosystem Kosova (2020). [Needs Evaluation Report](#).

370 UNDP (2022). [Digital Household Survey](#). Qasur në mars 2024.

371 UNDP (2022). [Digital Household Survey](#). Qasur në mars 2024.

372 Po aty.

373 UNDP (2022). [Digital Household Survey](#).

teper, 31 për qind e grave dhe burrave raportojnë se kanë shmangur shërbimet qeveritare në internet sepse nuk dinë t'i përdorin ato.³⁷⁴

Barrierat kryesore për pjesëmarrjen digjitale për gratë dhe vajzat përfshijnë çështjet e përballeshmërisë, të tilla si mungesa e të ardhurave për blerjen e të dhënave ose pajisjeve të internetit (71 për qind) dhe qasja e kufizuar në shërbimet digjitale (29 për qind). Në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, kostoja u pa unanimisht si pengesa e vetme (100 për qind) nga të dyja gjinitë. Gratë boshnjake identifikuan përballeshmërinë si shqetësimin e tyre kryesor (100 për qind). Për gratë serbe, barrierat e larta ishin përballeshmëria (55 për qind) dhe disponueshmëria e shërbimeve (45 për qind).³⁷⁵

Pabarazi gjinore ekziston edhe për sa i përket arsimit në TIK. Në mesin e studentëve të universiteteve publike dhe private në vitin akademik 2021/22, 205 gra (36 për qind) dhe 370 burra (64 për qind) janë diplomuar në nivel bachelor në TIK.³⁷⁶ Dallimi është edhe më i madh në regjistrimet në arsimin profesional. Në vitin 2021, 73 për qind e studentëve të regjistruar në programet e AAP për TIK ishin djem, krahasuar me 27 për qind që ishin vajza.³⁷⁷ Kjo mund të tregojë se ideja e përgjithshme se fusha e TIK-ut u përshtatet vetëm djemve është e përhapur dhe reflekton në zgjedhjet e drejtimeve që në fillim.

Pothuajse dy të tretat e grave në Kosovë besojnë se dhuna ndaj grave është e shpeshtë dhe më shumë se gjysma kanë përjetuar abuzim fizik, psikologjik ose seksual nga një marrëdhënie e ngushtë që kur ishin 15 vjeç.³⁷⁸ Në mënyrë të ngjashme, përqindja e grave në Kosovë që kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës së lehtësuar nga teknologjia është 43.3 për qind.³⁷⁹ Një vështrim i përgjithshëm i legjislacionit dhe strategjive kombëtare që adresojnë drejtpërdrejt dhunën e lehtësuar nga teknologjia, i kryer nga UN Women, zbuloi se në Kosovë, Kodi Penal, Ligji i Specializuar për Barazi Gjinore, Dhunën ndaj Grave/Dhunën në Familje dhe Strategjia e Barazisë Gjinore, në rastin më të mirë, vetëm në mënyrë indirekte adresojnë disa forma të DhGV-së të lehtësuar nga teknologjia. Megjithatë, Kodi Penal trajton ngacmimin seksual, ndjekjen, ryshfetin dhe dhunën në familje. Neni 186, paragrafi 1³⁸⁰ përcakton në mënyrë specifike ngacmimin, duke përfshirë ngacmimin digjital përmes telefonatave, mesazheve dhe email-eve, si veprime që ngjallin frikën e lëndimit, dëmtimit të pasurisë ose shqetësimin të rëndë të viktimat.

374 Po aty.

375 RrGGK

376 KEC (2021). [Vlerësimi i Realizimit të Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021: Arritje e pamjaftueshme](#). Qasur në mars 2024.

377 OSBE (2019). [Anketa e OSBE-së rreth dhunës ndaj grave në Kosovë](#). Qasur në mars 2024.

378 UN Women (2023) [THE DARK SIDE OF DIGITALIZATION: Technology-facilitated violence against women in Eastern Europe and Central Asia](#) Qasur në mars 2024.

379 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2019. Qasur në mars 2024 në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>

380 Bashkimi Evropian në Kosovë (n.d.) ["The European Union and Kosovo"](#)

HARTËZIMI I MBËSHTETJES

Bashkimi Evropian

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBEK) dhe Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE) mbështesin zhvillimin e përgjithshëm të Kosovës. ZBEK-u zbaton politikat e BE-së, lehtëson dialogun, menaxhon ndihmën financiare për zhvillim dhe mbështet reformat që synojnë përafrimin e Kosovës me normat evropiane. Përveç kësaj, ZBEK-u administron ndihmën financiare përmes instrumenteve si Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA), i cili mbështet sektorë të ndryshëm duke përfshirë administratën publike, drejtësinë dhe shoqërinë civile. Midis vitit 2007 dhe atij 2020, BE-ja ka ndarë mbi €1.5 miliard për reformën e administratës publike, reformën ekonomike, arsimin, bujqësinë, sundimin e ligjit, rindërtimin, shoqërinë civile, median dhe shumë fusha të tjera kryesore.³⁸¹ Në anën tjetër, PSBE-ja udhëzon qeverinë e Kosovës në proceset politike, koordinon aktivitetet e BE-së dhe promovon të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, duke përfshirë barazinë gjinore.³⁸² Mbështetja për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave ka qenë vazhdimisht gur themel i mbështetjes së BE-së për Kosovën. Financiarisht, kjo është bërë kryesisht përmes tri programeve: Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR), Instrumentit për Shoqërinë Civile dhe Mediat (CSF), dhe Instrumentit për Barazi Gjinore (GEF).

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) është misioni i BE-së për Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP) në Kosovë. Ai ofron mbështetje për institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë drejt rritjes së efektivitetit, qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies së tyre. EULEX-i gjithashtu punon në DhSK duke monitoruar dhe këshilluar autoritetet vendore gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit për të përmirësuar trajtimin e këtyre rasteve të ndjeshme.

Organizatat ndërkombëtare

Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) është një kolektiv i agjencive të OKB-së që punojnë së bashku në Kosovë për t'i mbështetur qëllimet e zhvillimit të vendit në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) të Kombeve të Bashkuara.³⁸³ E udhëhequr nga Koordinator i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNKT-ja punon në sektorë të ndryshëm duke përfshirë qeverisjen, shërbimet sociale dhe zhvillimin ekonomik për ta promovuar rritjen gjithëpërfshirë dhe të qëndrueshme, si dhe aftësinë ripërtëritëse në Kosovë. Ato fokusohen në sigurimin e qeverisjes efektive, avancimin e të drejtave të njeriut, nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe rritjen e kohezionit social. Puna e UNKT-së organizohet në kuadër të

381 Po aty https://www.eeas.europa.eu/kosovo/eu-and-kosovo_en?s=321

382 Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (n.d.), "The UN in Kosovo"

383 UN Women Evropë dhe Azi (n.d) [Kosovo](#)

Kornizës së Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara që bashkëpunon me institucionet e Kosovës dhe synon zhvillimin transformues dhe gjithëpërfshirës deri në vitin 2025. Barazia gjinore dhe Fuqizimi i Grave është një nga fushat parësore të UNKT-së, në përputhje me OZhQ 5-shin.

UN Women është Agjencia e OKB-së për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave. UN Women ka punuar në Kosovë që nga viti 1999 duke u fokusuar në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në sektorë të ndryshëm. Puna e tyre është fokusuar kryesisht në dhunën me bazë gjinore, buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, fuqizimin ekonomik të grave, ngritjen e kapaciteteve dhe asistencën teknike për institucionet vendore.³⁸⁴ UN Women kryeson gjithashtu Grupin e Sigurisë dhe Gjinisë (GSGj), i cili është një grup shumëpalësh i palëve të interesit për barazinë gjinore që koordinon aktivitetet dhe projektet që nga viti 2007. Që nga viti 2023, UN Women ka zbatuar Instrumentin për Barazi Gjinore të financuar nga BE-ja, një projekt që synon të përfshijë barazinë gjinore nëpër sektorë të ndryshëm në Kosovë në nivel qendror dhe lokal.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) punon drejt zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë përmes katër fushave kryesore të punës. Misioni i tij është të zhdrukë varfërinë dhe të reduktojë pabarazitë dhe përjashtimin duke zhvilluar politika, aftësi udhëheqëse, aftësi partneriteti, aftësi institucionale dhe duke ndërtuar qëndrueshmëri. Kjo punë kryhet përmes katër fushave kryesore të punës së tyre duke përfshirë Qeverisjen dhe Ndërtimin e Paqes, Rritjen Gjithëpërfshirëse dhe Rezistencën ndaj Klimës, Digjitalizimin dhe Barazinë Gjinore.³⁸⁵

Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNFPA) fokusohet në avancimin e shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese, me fokus në përmirësimin e qasjes në kujdesin shëndetësor riprodhues cilësor, promovimin e edukimit seksual dhe rritjen e kapaciteteve të institucioneve për të zhvilluar dhe zbatuar politika të bazuara në të drejta.³⁸⁶ Pjesa kryesore e misionit të UNFPA-së përfshin adresimin e çështjeve të tilla si parandalimi i kancerit të qafës së mitrës, i cili ka qenë fokus i madh i përpjekjeve të tyre në vitet e fundit. Fokus kryesor i punës së tyre është te barazia gjinore, duke integruar atë në programe më të gjera shëndetësore dhe të bazuara në të drejta.³⁸⁷ Kjo përfshin përpjekjet për t'i fuqizuar gratë dhe vajzat përmes arsimit dhe shërbimeve shëndetësore, duke siguruar që ato të mund të bëjnë jetë më të shëndetshme dhe më të bazuar në informata. Për më tepër, UNFPA-ja mbështet përfshirjen e grupeve të cënueshme në anketa si Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave për të siguruar që askush të mos mbetet prapa gjatë mbledhjes së të dhënave që informojnë politikën dhe programimin.

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) në Kosovë punon në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Puna e tyre fokusohet në sigurimin që fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë të jenë të shëndetshëm, të mbrojtur dhe të kenë mundësi të arrijnë potencialin e tyre të plotë.³⁸⁸ Programet e UNICEF-it në Kosovë për periudhën 2021–2025 fokusohen në tri fusha kryesore, Dekada e parë e Jetës, Dekada e Dytë e Jetës, dhe Përfshirja Sociale dhe Monitorimi i të Drejtave. UNICEF-i

384 UNDP Kosova (n.d) [Fokusi ynë](#)

385 UNFPA Kosova (n.d) [Kush jem ne](#)

386 Anketa e Palëve të Interesit zbatuar në vitin 2024

387 Programi i UNICEF-it në Kosovë (n.d) [Çfarë bëjmë ne](#)

388 Këshilli i Evropës, Drejtorja e Koordinimit të Programit, (n.d) [Kosovo](#)

promovon barazinë gjinore gjatë gjithë punës së tij, duke siguruar që vajzat dhe djemtë të kenë mundësi të barabarta për t'u rritur, për të mësuar dhe zhvilluar potencialin e tyre.

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) fokusohet në disa programe, projekte dhe aktivitete që synojnë mbështetjen e zhvillimit të institucioneve demokratike dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Ndër të tjera, OSBE-ja fokusohet në sektorë të tillë si monitorimi i të drejtave të njeriut, demokratizimi, siguria publike dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave. Misioni i OSBE-së në Kosovë është i përfshirë në mënyrë aktive në luftimin e dhunës në familje përmes iniciativave dhe programeve të ndryshme trajnuese, veçanërisht për rritjen e reagimit institucional ndaj dhunës në familje.

Këshilli i Evropës (KiE) ka qenë aktiv në Kosovë që nga viti 1999. Fushat kryesore të fokusit përfshijnë përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë, arsimin, luftimin e diskriminimit në bazë etnike dhe gjinore, dhe rritjen e lirisë së mediave.³⁸⁹ KiE është fokusuar kryesisht në dhunën në familje në Kosovë dhe ka zbatuar tri faza të programit "Përforcimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë. Aktualisht, ai është duke zbatuar Programin "Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit", i cili synon fuqizimin e kapaciteteve institucionale për të parandaluar dhe luftuar dhunën në familje në përputhje me standardet e IC-së.

Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) është një organizatë ndërkombëtare jofitimprurëse e fokusuar në mbështetjen e demokracisë dhe qeverisjes demokratike. NDI-ja ka qenë aktive në Kosovë që nga viti 1999 dhe fokusohet në aspekte të ndryshme të qeverisjes, duke përfshirë përmirësimin e legjislativës dhe reagimin politik; promovimin e hapjes dhe transparencës në asamblenë kombëtare; fuqizimin e kapaciteteve parlamentare dhe mbështetjen e pjesëmarrjes politike të grave, pakicave etnike dhe të rinjve.³⁹⁰ Që nga viti 2012, NDI-ja organizon veprimtarinë vjetore "Java e Gruas", e cila fokusohet në pjesëmarrjen politike dhe lidhshmërinë e grave.

Donatorët dypalësh

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit/Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) fokusohet kryesisht në mbështetjen e tranzicionit të Kosovës drejt stabilitetit politik, demokracisë dhe zhvillimit ekonomik nën mbikëqyrjen e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).³⁹¹ Fushat aktuale parësore të GIZ-it në Kosovë përfshijnë: zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, administratën publike, demokracinë, shoqërinë civile dhe energjinë.³⁹²

Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) fokusohet në fuqizimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë.³⁹³ Bashkëpunimi zhvillimor i SIDA-s fuqizon të drejtat e njeriut, demokracinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë. Aktualisht SIDA ka katër fusha tematike: 1) Të drejtat e njeriut, demokracinë, sundimin e ligjit dhe barazinë gjinore;

389 Instituti Demokratik Kombëtar, (n.d), [Kosovo](#)

390 GIZ, (n.d), [Kosovo](#)

391 Po aty.

392 Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, (n.d), [SIDA's work in Kosovo](#)

393 Po aty.

2) Shoqëritë paqësore dhe gjithëpërfshirëse; 3) Mjedisi dhe Klima; dhe 4) Zhvillimi Ekonomik për të gjithë. SIDA i jep rëndësi të madhe barazisë gjinore në Kosovë, duke mbështetur aktivisht nismat që promovojnë barazinë gjinore. Kjo përfshin adresimin e diskriminimit ndaj grave në vendin e punës, luftimin e ngacmimeve seksuale në vendin e punës dhe trajtimin e formave të tjera të dhunës me bazë gjinore.³⁹⁴

Ambasada e Mbretërisë së Holandës punon drejt transformimit social dhe fuqizimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit përmes MATRA-s & Fondit për të Drejtat e Njeriut.³⁹⁵ Ky fond mbështet iniciativat e OJQ-ve të Kosovës që punojnë në fusha të ndryshme, duke përfshirë të drejtat e grave dhe komunitetet LGBTI+.

Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC) është në Kosovë që nga viti 2003 përmes një zyre ndërlidhëse, dhe me një zyrë koordinuese të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) që nga viti 2008.³⁹⁶ Qëllimet kryesore të ADC-së janë reduktimi i varfërisë, paqja dhe siguria njerëzore dhe mbështetja për integrimin evropian dhe rajonal të Kosovës. Gratë, pakicat kombëtare dhe individët në gjendje të pafavorshme sociale janë një çështje ndërsektoriale në punën e tyre. Ndër të tjera, ADA-ja ka mbështetur, mes tjerash, iniciativat për përfshirjen e grave në bujqësi, aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve për OGSHC-të dhe më gjerë, iniciativat për rritjen e ndërgjegjësimit mbi dhunën me bazë gjinore.³⁹⁷

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) punon në Kosovë që nga viti 1999, duke investuar më shumë se \$1 miliard në projekte në fusha të ndryshme që kontribuojnë në zhvillimin e Kosovës.³⁹⁸ Strategjia e USAID-it për Bashkëpunim për Zhvillim të Kosovës 2022–2025 ka dy objektiva zhvillimore: 1) institucionet qeverisëse llogaridhënëse dhe efektive u shërbejnë më mirë qytetarëve; dhe 2) mundësitë e shtuara për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse demokratike dhe ekonomike.³⁹⁹ Përderisa gratë, të rinjtë dhe pakicat ndërthuren në të dyja objektivat, fokusi më i madh gjinor është në objektivin e dytë, i cili synon të mbyllë hendekun gjinor në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë tregun e punës, pjesëmarrjen politike dhe qasjen në kapital prodhues.⁴⁰⁰ USAID-i punon për arritjen e këtyre objektivave duke mbështetur projekte të zbatuara nga organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare.

394 Holanda dhe Kosova. (2023). [MATRA and Human Rights Fund – 2024](#).

395 Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (2013). [Kosovo Country Strategy 2013-2020 \(extended until the end of 2021\)](#). Faqe 2.

396 Agjencia Austriake për Zhvillim (2024). [All Projects: Kosovo](#).

397 Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. (dhe) [Kosovo Country Overview](#).

398 Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar në Kosovë. (2022) [USAID Kosovo Country Development Cooperation Strategy 2022-2025](#). Faqe 7.

399 Po aty. Faqe 25.

400 Rrjeti i Grave të Kosovës (n.d). [Rreth nesh](#).

Shoqëria civile

Kosova ka një shoqëri civile të fuqishme, me organizata të shumta të shoqërisë civile të grave (OSHCG) të cilat monitorojnë punën e qeverisë dhe institucioneve publike, si dhe punojnë drejtpërdrejt me gratë dhe burrat, në përpjekje për t'i fuqizuar ato dhe për të avancuar agjendën e barazisë gjinore. Përveç kësaj, ka shumë organizata të shoqërisë civile që punojnë në fusha të ndryshme, por që përfshijnë komponentë të barazisë gjinore ose e integrojnë atë si një çështje ndërsektoriale. Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), i themeluar në vitin 1996, ka rrjetin më të madh të organizatave të grave, i cili përfshin 140 anëtare të të gjitha grupeve etnike.⁴⁰¹ Ka katër fusha programore duke përfshirë 1) përmirësimin e barazisë gjinore përmes sundimit të ligjit; 2) një jetë pa dhunë me bazë gjinore; 3) fuqizimin ekonomik të grave; dhe 4) edukimin transformues gjinor.⁴⁰² Për të zbatuar projekte brenda këtyre fushave, të cilat fokusohen në hulumtimin dhe avokimin, RrGGK-ja ka marrë mbështetje nga një gamë e gjerë donatorësh duke përfshirë, mes tjerash, ADA-në, SIDA-në, Zyrën e BE-së në Kosovë, Fondacionin Kvinna till Kvinna, UN Women.⁴⁰³

Kosovo Women 4 Women (KW4W) është një tjetër OShCG që ka mbështetur gratë e marginalizuara në mbarë Kosovën që nga viti 1999.⁴⁰⁴ Ajo punon në nivele bazë në projekte që synojnë fuqizimin ekonomik të grave, rritjen e pjesëmarrjes në komunitetet e tyre dhe më gjerë, si dhe përmirësimin e mirëqenies. Në përpjekjet e saj për të përmirësuar pozitën ekonomike dhe sociale të grave, KW4W-ja është mbështetur nga GIZ-i, Fondacioni Cartier, European Entrepreneurs Everywhere, USAID-i dhe donatorë të tjerë.⁴⁰⁵

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj) është një tjetër OShCG aktive në hulumtime dhe avokim për barazinë gjinore që nga viti 2004.⁴⁰⁶ Duke punuar në fushat e dhunës me bazë gjinore, pjesëmarrjes në tregun e punës dhe proceseve politike, si dhe më gjerë, QKSGj-ja ka marrë mbështetje nga MATRA dhe Fondi për të Drejtat e Njeriut të Ambasadës së Holandës, UN Women, Kvinna till Kvinna Foundation, Save the Children, dhe palët e tjera vendore dhe ndërkombëtare të interesit.⁴⁰⁷

Përveç kësaj, ka shumë organizata të tjera që punojnë në fushën e barazisë gjinore. Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës punon në drejtim të fuqizimit të grave dhe vajzave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.⁴⁰⁸ Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion, e njohur si QIKA, është një organizatë e re në krahësim me të tjerat, që kontribuon në uljen e pabarazisë gjinore përmes hulumtimit, avokimit dhe veprimeve.⁴⁰⁹ Women in Tech është gjithashtu një OShCG e re e cila kontribuon në mbylljen e hendekut digjital gjinor.⁴¹⁰ Aksioni për Nëna dhe Fëmijë (ANF) punon për të përmirësuar jetën e nënave, foshnjave dhe fëmijëve përmes avokimit, bashkëpunimit me institucionet e

401 Po aty.

402 Rrjeti i Grave të Kosovës (2022). [Raporti Vjetor 2022](#). Faqe 88-92.

403 Anketa e Palëve të Interesit zbatuar në mars 2024.

404 Po aty.

405 Qendra Kosovare për Studime Gjinore (n.d). [Historiku, vizioni dhe misioni](#).

406 Qendra Kosovare për Studime Gjinore (vend). [Projektet aktuale](#) dhe [Projektet e kaluara](#).

407 Rrjeti i Grave të Kosovës (n.d). [Anëtarët: Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës](#)

408 Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion (n.d). [Kush jemi ne?](#)

409 Anketa e Palëve të Interesit zbatuar në mars 2024.

410 Aksioni për Nëna dhe Fëmijë (n.d). [Kush jemi ne?](#)

kujdesit shëndetësor, hulumtimit dhe zbatimit të projekteve.⁴¹¹ Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime - SIT kontribuon për një shoqëri të barabartë duke punuar me burrat dhe të rinjtë në fushat e dhunës me bazë gjinore, shëndetit seksual dhe riprodhues, dhe në promovimin sjelljeve të shëndetshme.⁴¹²

Ekzistojnë katër OShCG që punojnë drejtpërdrejt me të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë konfliktit, të cilat janë gjithashtu të licencuara nga qeveria e Kosovës për t'i mbështetur ato në aplikimin për njohjen e statusit të tyre. Këtu përfshihet Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), Medica Kosova, Medica Gjakova dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave.⁴¹³ Këto organizata punojnë në avokim dhe mbështetje të drejtpërdrejtë për të mbijetuarit në formën e mbështetjes psiko-sociale, aktiviteteve të fuqizimit ekonomik dhe më shumë.

411 Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime (n.d). [Rreth nesh](#).

412 UN Women (2016). "[Konflikti nuk na solli lule: nevoja për korrigjime gjithëpërfshirëse lidhur me dhunën seksuale gjatë konfliktit në Kosovë](#)". Faqe 14.

413 UN Women (2016). "[Konflikti nuk na solli lule: nevoja për korrigjime gjithëpërfshirëse lidhur me dhunën seksuale gjatë konfliktit në Kosovë](#)". Faqe 14.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Sigurimi i lirisë nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore

Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

- Ka pasur përmirësime të konsiderueshme në strukturën ligjore lidhur me dhunën me bazë gjinore, me përfshirjen e Konventës së Stambollit në Kushtetutën e Kosovës, me rishikimin e Kodit të ri Penal, me Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, dhe me Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026.
- Anketimet tregojnë se 54 për qind e të gjitha grave në Kosovë kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike, ose seksuale nga një partner intim që nga moshën 15 vjeç.
- Incidenca e dhunës në familje në Kosovë u raportua të jetë 1.56 raste për 1,000 banorë në vitin 2022.
- Në vitin 2022, gratë përbënin 81.5 për qind të viktimave të dhunës në familje, ku 47 për qind e këtyre viktimave që kishin përjetuar dhunë nga bashkëshortët e tyre.
- Policia e Kosovës raportoi një kohë mesatare përgjigjeje prej 19.2 minutash në rastet e dhunës në familje në vitin 2022.
- Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmë të Viktimave ka pranuar në mes 90 për qind deri në 93 për qind të rasteve të lidhura me dhunën me bazë gjinore nga viti 2019 deri në vitin 2023.
- Nga viti 2019 deri në 2023, strehimoret në Kosovë kanë strehuar 2,516 gra dhe fëmijë viktime të dhunës në familje.
- Nga viti 2020 deri në 2023, Policia e Kosovës ka marrë 84 raportime për ngacmime seksuale.
- Programi Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave, i nisur si pilot në Qendrën Korrektuese në Dubravë në vitin 2022, përfshin 10 module të zbatuara gjatë 24 sesioneve.
- Ka një trajtim të pamjaftueshëm, veçanërisht nga sistemi i drejtësisë i Kosovës, të rasteve të dhunës gjinore, përfshirë dhunën online dhe atë në familje.

Rekomandimet:

1. Mbështetja e zbatimit të kornizës ligjore në lidhje me dhunën me bazë gjinore, dhe në veçanti e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, si dhe e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore.
2. Vazhdimi i financimit të organizatave të shoqërisë civile të grave për rritjen e ndërgjegjësimit për dhunën me bazë gjinore, dhe i ofrimit të shërbimeve dhe mbështetjes.
3. Mbështetja e pushtetit lokal dhe qendror në ofrimin e shërbimeve bazë për riintegrimin e viktimave në formën e strehimit dhe punësimit afatgjatë, si dhe qasje në kujdesin ditor.
4. Inkurajimi i qeverisë që të zhvillojë fushata të ndërgjegjësimit për shërbime të ndryshme disponueshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, ndihmën juridike falas, kompensimin e viktimave, masën për subvencionimin e pagave për të mbijetuarit e dhunës në familje dhe shërbime të tjera përkatëse.
5. Mbështetja e qeverisë në ngritjen dhe funksionalizimin e një sistemi monitorimi digjital për zbatimin e duhur të urdhrave mbrojtës nëpërmjet byzylykëve elektronikë, si një mjet për parandalimin e vazhdimin dhe përshkallëzimit të dhunës.
6. Thirrja për qeverinë që të sigurojë që ka burime të mjaftueshme njerëzore të trajnuara në të gjitha entitetet që punojnë me viktimat e dhunës me bazë gjinore, dhe veçanërisht në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe Qendrat për Punë Sociale.
7. Promovimi i përfshirjes së temave të barazisë gjinore, dhunës me bazë gjinore, dhe qasjes në burime dhe të drejta të ndryshme në të gjithë sistemin arsimor.
8. Mbështetja e përshtatjes së protokolleve për parandalimin dhe menaxhimin e ngacmimit seksual në sektorin publik dhe privat, si dhe në universitete, së bashku me aktivitete të gjera për ngritjen e kapaciteteve dhe fushatave të ndërgjegjësimit për të siguruar që ngacmimi seksual të parandalohet dhe menaxhohet në mënyrë efektive në vendet e punës ose në mjediset arsimore.
9. T'i bëhet thirrje sistemit të drejtësisë të Kosovës që t'i trajtojë menjëherë dhe në mënyrë efektive të gjitha format e dhunës gjinore dhe rasteve të dhunës në familje, dhe të parandalojë mosndëshkueshmërinë për autorët e këtyre veprave.

Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese

Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

- Shëndeti seksual dhe riprodhues vazhdon të jetë një temë tabu, gjë që shkakton ngurrim për ta përfshirë edukatën seksuale në arsimin formal. Si rezultat, ka mungesë informacioni për kontraceptivët dhe sëmundjet e infeksionet seksualisht të transmetueshme të rinjtë.
- Vetëm 40 për qind e rinisë në Kosovë përdorin kontraceptivë, një nivel shumë më i ulët krahasuar me 71 për qind shkallën e përdorimit në vendet evropiane, dhe 33.3 për qind e grave në moshë riprodhuese raportojnë se nuk përdorin asnjë metodë kontraceptive.
- Përqindja e grave në moshën 15–49 vjeç në Kosovë që kanë nevojën për planifikim familjar e që janë të kënaqura me metoda moderne është ndjeshëm e ulët në 12.5 për qind.
- Shumica e grave nuk bëjnë teste të rregullta PAP, me 44 për qind të grave që thonë se kurrë nuk e kanë bërë këtë test, dhe 37 për qind që thonë se e kanë bërë vetëm një të tillë.

Rekomandimet:

1. Promovimi i përfshirjes së shëndetit seksual dhe riprodhues në arsimin formal në nivelet fillore dhe të mesme, si dhe informatat rreth burimeve dhe shërbimeve të disponueshme në nivelin e mesëm.
2. Inkurajimi i qeverisë që t'i zgjerojë përpjekjet e saj për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës dhe të gjirit, duke rritur furnizimin dhe shpërndarjen e vaksinave kundër HPV-së, dhe duke rritur vetëdijesimin për PAP testet dhe ekzaminimet mamografike të disponueshme.
3. Mbështetja e qeverisë në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave që lidhen me shëndetin seksual dhe riprodhues, të ndara sipas gjinisë, pasi ka mungesë informacioni që do të mundësonte zgjidhje efektive për çështje të ndryshme.
4. Inkurajimi i qeverisë për të kryer vlerësime periodike për diskriminimin e mundshëm dhe trajtimin e padinjitetshëm në qasjen e shërbimeve që lidhen me shëndetin seksual dhe riprodhues në sektorin publik.
5. Të inkurajohet përmirësimi shërbimeve të planifikimit familjar dhe përpjekjeve për informim, për t'i plotësuar në tërësi nevojat e grave në Kosovë për metodat moderne të kontracepsionit.

Promovimi i të drejtave ekonomike dhe sociale dhe fuqizimi i vajzave dhe grave

Konkluzionet dhe gjetjet kryesore:

- Varfëria është shumë e përhapur, me 18 për qind të popullsisë që jetojnë nën kufirin e varfërisë, dhe 5.1 për qind në varfëri ekstreme. Varfëria është më e përhapur në zonat rurale, ku jetojnë 64.4 për qind e të varfërve dhe 63.7 për qind e atyre në varfëri ekstreme. Varfëria prek më shumë gratë sesa burrat, me 19 për qind të grave dhe 17 për qind për qind të burrave që jetojnë nën kufirin e varfërisë.
- Gratë dhe vajzat përballen me papunësi dhe mungesë pjesëmarrjeje në fuqinë punëtore në norma shumë më të larta se burrat. Për shembull, 44.5 për qind e burrave janë joaktivë (që do të thotë që ata nuk punojnë, as po kërkojnë punë), krahasuar me 78 për qind të grave.
- Gratë dhe burrat përmendin arsye të ndryshme për pasivitetin e tyre në tregun e punës. Burrat thonë se pjesëmarrja e tyre në arsim dhe trajnime është arsyeja kryesore për pasivitetin e tyre, ndërsa gratë përmendin përgjegjësitë e papaguara të kujdesit, duke përfshirë kujdesin për fëmijët, si arsye kryesore.
- Gratë në Kosovë kalojnë 277 për qind më shumë kohë në detyrat e kujdesit të papaguar krahasuar me burrat, ndërsa burrat i dedikojnë 400 për qind më shumë kohë punës jashtë shtëpisë krahasuar me gratë.
- Diskriminimi me Bazë Gjinore në tregun e punës është i përhapur por i nënraportuar.
- Gratë janë të nënpërfaqësuar si studente në Qendrat e Trajnimeve Profesionale (35.4 për qind).
- Gratë janë pronare të vetëm 21.9 për qind të të gjitha ndërmarrjeve në Kosovë, që operojnë kryesisht si biznese mikro dhe të vogla, me një prezencë të dallueshme në tregtinë me shumicë, tregtinë me pakicë dhe shërbime, megjithëse përballen me pengesa të konsiderueshme si mungesa e kolateraleve për financim.
- Në vitin 2022, një përqindje e kosovarëve ishin të përfshirë në punë joformale. Brenda këtij grupi, numri i grave ishte pothuajse dyfish më i lartë se i burrave në angazhimin në veprimtari joformale, duke përfshirë 65 për qind të fuqisë punëtore joformale. Gratë në sektorin joformal në Kosovë shpesh angazhohen në punë të paqëndrueshme, që paguhen pak, dhe janë pa mbrojtje sociale.
- Djemtë braktisin shkollën në shkallë më të lartë se vajzat. Në përgjithësi, 74.75 për qind e të gjithë nxënësve që e kanë braktisur shkollën ishin djem dhe 25.25 për qind ishin vajza, duke çuar kështu drejt trendit që djemtë kanë më shumë gjasa ta braktisin shkollën.
- Dëshmitë sugjerojnë që normat gjinore dhe pritjet shoqërore ndikojnë në shkallën e përgjithshme të braktisjes së shkollës, me pritshmërinë që djemtë të mbështesin financiarisht familjet e tyre sa më herët të jetë e mundur.
- Edhe pse korniza ligjore e Kosovës siguron të drejta të barabarta pronësie dhe trashëgimie, vetëm 19.8 për qind e pronave të regjistruara ishin të zotëruara nga gratë në vitin 2024.

- Ka pasur një rritje graduale në pronën e regjistruar në emër të grave, e mbështetur nga masa afirmative si Udhëzimi Administrativ Nr. 3/2016 për regjistrimin e pronës së përbashkët. Megjithatë, numri i lartë i grave që refuzojnë trashëgiminë lidhet me barrierat kulturore dhe shoqërore të cilat i pengojnë gratë nga të përfituarit e plotë të trashëgimisë dhe mbrojtja ligjore.

Rekomandimet:

1. *Inkurajimi i Qeverisë së Kosovës dhe ofrimi i asistencës teknike drejt ndryshimit të Ligjit të Punës në mënyrë që të përfshihen dispozitat nga Direktiva 2019/1158 e BE-së për balancën punë-jetë. Aspektet specifike që duhen marrë parasysh janë:*
 - a. Njohja e konceptit të pushimit “prindëror”, përveç pushimit të atësisë dhe lehonisë.
 - b. Sigurimi i pushimit të paguar për të paktën 10 ditë për baballarët me lindjen ose birësimin e fëmijës së tyre.
 - c. Sigurimi i pushimit prindëror të patransferueshëm si e drejtë individuale e të dy prindërve për të paktën katër muaj.
 - d. Sigurimi i të drejtës për të gjithë prindërit me fëmijë nën moshën 8 vjeç për të kërkuar orar fleksibil të punës.
 - e. Sigurimi i pushimit me pagesë për punonjësit që kujdesen për anëtarët e familjes, përveç fëmijëve.
2. *Mbështetja e Qeverisë së Kosovës, veçanërisht Inspektoratit të Punës drejt institucionalizimit të trajnimeve të rregullta për të gjithë inspektorët për diskriminimin me bazë gjinore në vendin e punës.*
 3. *Mbështetja e zgjerimit të QAP-ve në zonat rurale dhe të populluara nga pakicat për të përmirësuar qasjen për gratë dhe pakicat etnike, potencialisht përmes projekteve të infrastrukturës të financuara nga BE-ja ose njësive të lëvizshme të trajnimit.*
 4. *Rritja e financimit, granteve dhe kredive me interes të ulët për bizneset fillestare dhe të vogla në pronësi të grave, veçanërisht në sektorë të nënpërfaqësuar si prodhimi dhe teknologjia. Përfshirja e trajnimit për edukimin financiar dhe mbështetjen në zhvillimin e planeve të biznesit.*
 5. *Lansimi i programeve të synuara që inkurajojnë gratë të kyçen dhe të zhvillohen në industri ku aktualisht janë të nënpërfaqësuar, si sektori i ndërtimit dhe energjisë. Këto programe mund të përfshijnë partneritete me bizneset ekzistuese, trajnime profesionale dhe mundësi mentorimi.*
 6. *Zhvillimi i iniciativave për t'i ndihmuar gratë në sektorin joformal që të kalojnë në ekonominë formale. Kjo mund të përfshijë thjeshtimin e procesit të regjistrimit, ofrimin e stimujve tatimorë, dhe ofrimin e këshillave ligjore dhe financiare për të siguruar që bizneset e tyre të jenë plotësisht në përputhje dhe të qëndrueshme.*
 7. *Avokimi për vazhdimin dhe zgjerimin e masave afirmative siç është Udhëzimi Administrativ Nr. 3/2016, i cili mandaton regjistrimin e përbashkët të pronës së paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve. Angazhimi në dialog politik me qeverinë për të përforcuar rëndësinë e këtyre masave, dhe për të eksploruar politika shtesë që mund të përmirësojnë më tej të drejtat e pronësisë së grave.*

8. Nisja e fushatave të ndërgjegjësimit që synojnë gratë për t'i edukuar ato për rëndësinë e mosheqjes dorë nga të drejtat e tyre pronësore. Këto fushata duhet të përfshijnë informacione mbi përfitimet ligjore dhe ekonomike të mbajtjes së pronësisë, dhe të ofrojnë udhëzime për rekursin ligjor në dispozicion të grave që përballen me presion për të hequr dorë nga të drejtat e tyre.

Promovimi i pjesëmarrjes të barabartë dhe lidërshipt

Konkluzionet dhe gjetjet kryesore:

- Edhe pse ligji e obligon pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në të gjitha institucionet publike, gratë mbeten të nënpërfaqësuar, sidomos në nivelet e vendimmarrjes.
- Në vitin 2021, 44 gra u zgjodhën deputete në Kuvendin e Kosovës dhe vetëm 9 për qind prej tyre i siguruan ulëset përmes kuotës gjinore, krahasuar me 26 gra nga 37 gjithsej në vitin 2007.
- Në nivel lokal, vetëm 14 gra (8 për qind e të gjithë kandidatëve) kandiduan për kryetare komune në zgjedhjet komunale të vitit 2021, dhe vetëm dy u zgjodhën.
- Përfaqësimi i grave në Kuvendet Komunale ishte 37 për qind, me 61 për qind të grave të zgjedhura të cilat nuk i fituan ulëset nga kuota gjinore
- Në përgjithësi, përfaqësimi i grave në drejtoritë e qeverisjes lokale ishte 23.5 për qind, me 101 gra dhe 328 burra që udhëhoqën drejtoritë të ndryshme deri në vitin 2023.
- Në rolet administrative zgjedhore, gratë përbënin vetëm 19 për qind të Komisioneve Zgjedhore Komunale dhe 22.39 për qind të vëzhguesve zgjedhorë në vitin 2021.

Rekomandimet:

1. *Pushteti lokal dhe ai qendror duhet ta respektojnë ligjin për barazinë gjinore në nivelet ekzekutive, si dhe në listat e kandidatëve për zgjedhje, dhe të sigurojnë barazi të plotë, pra duke tejkaluar kuotën 30 për qind të parashikuar në ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale.*
2. *Mbështetja e shoqërisë civile dhe medias për të larmuar debatin publik me më shumë gra në panele dhe platforma të ndryshme, si dhe në rritjen e ndërgjegjësimit kundër dhunës ndaj grave në domenin publik dhe grave politike në veçanti.*
3. *Inkurajimi i partive politike që të respektojnë angazhimet e tyre për të rritur përfaqësimin e grave në proceset zgjedhore, si dhe të ofrojnë hapësirë dhe t'i fuqizojnë gratë për të mbuluar një gamë të gjerë temash përtej "çështjeve të grave".*
4. *Mbështetja e qeverisë në integrimin e çështjeve gjinore në kulturë, trashëgimi kulturore dhe sporte, si dhe duke siguruar që gratë dhe burrat të kenë qasje të barabartë në mundësi.*
5. *Të inkurajohet qeveria që të përforcojë rolin e Zyrtarëve për Barazi Gjinore, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore dhe Rregulloren për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zyrtarëve Përkatës për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna.*
6. *Të mbështetet dhe inkurajohet Kuvendi i Kosovës që të sigurojë se perspektiva gjinore është e inkorporuar në të gjithë punën e tij, duke rezultuar kështu në ligje gjithëpërfshirëse.*

Integrimi i agjendës për gra, paqe dhe siguri

Konkluzionet dhe gjetjet kryesore:

- Pavarësisht avokimit për përfaqësim të barabartë nën rezolutën UNSCR 1325 dhe ligjet kombëtare, pjesëmarrja e grave në misionet diplomatike në Kosovë dhe në nivelet e vendimmarrjes mbetet e ulët, pasi gratë përbënin vetëm 24.4 për qind të pozitave vendimmarrëse në vitin 2023.
- Gratë janë dukshëm të nënpërfaqësuar në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në veçanti në nivelet e larta, pasi që nuk ka gra në gradat më të larta të oficerëve, duke vënë në pah kështu një nevojë imediate për përmirësimin e barazisë gjinore.

Rekomandimet:

1. *Mbështetja e Ministrisë së Punëve të Jashtme drejt:*
 - a. Krijimit të programeve të trajnimit dhe zhvillimit të përshtatura posaçërisht për gratë në Kosovë, që synojnë rritjen e aftësive relevante për diplomacinë, negociatat e paqes dhe udhëheqjen në forcat e sigurisë.
 - b. Zbatimit të skemave të mentorimit duke i bërë bashkë gratë në pozicione të nivelit të ulët ose të mesëm me lidere me përvojë në sektorët e diplomacisë dhe sigurisë.
2. *Avokimi dhe mbështetja në zbatimin e kuotave gjinore brenda misioneve diplomatike dhe forcave të sigurisë për të siguruar një përqindje minimale të grave në të gjitha gradat, veçanërisht në pozitave vendimmarrëse. Monitorimi dhe raportimi publik mbi progresin për të siguruar llogaridhënie dhe transparencë.*
3. *Puna e ngushtë me institucionet e Kosovës për të rishikuar dhe forcuar politikën në lidhje me barazinë gjinore brenda kornizave kombëtare për paqen dhe sigurinë. Kjo përfshin mbështetjen e reformave legjislative dhe të politikave që përfshijnë në mënyrë eksplicite perspektivat dhe kërkesat gjinore nga UNSCR 1325-ja.*
4. *Lehtësimi i përfshirjes së grave të mbijetuara të dhunës seksuale të shaktuar gjatë konfliktit në proceset e ndërtimit të paqes. Kjo jo vetëm që do t'i njihte përvojat e tyre, por edhe do t'i përdorte perspektivat e tyre unike për të udhëzuar dhe formësuar përpjekjet e pajtimit dhe paqes.*

Ndryshimet klimatike dhe mjedisi

Konkluzionet dhe gjetjet kryesore:

- Legjislacionit për ambient dhe ndryshime klimatike në Kosovë i mungon perspektiva gjinore, meqë janë dizajnuar politika të cilat kanë dështuar ta integrojnë ndikimin gjinor apo t'i njohin efektet e ndryshme që këto çështje kanë te burrat dhe gratë.
- Gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara në Kosovë janë joproporcionalisht të prekura nga ndryshimet klimatike për shkak të pabarazive ekzistuese – në mesin e grave ka shkallë më të lartë të mortalitetit për shkak të katastrofave natyrore të ndërlidhura me ndryshimet klimatike, dhe ato janë më të prira t'u nënshtrohen dhunës me bazë gjinore gjatë këtyre ngjarjeve.

Rekomandimet:

1. *Konsiderimi i autorizimit të një analize të thellë gjinore të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike në Kosovë. Kjo analizë duhet të vlerësojë ndikimet diferenciale të ndryshimeve klimatike në grupe të ndryshme sociale, veçanërisht duke u fokusuar te gratë, të rinjtë dhe pakicat etnike. Gjetjet dhe rekomandimet e saj duhet të përdoren për t'i udhëzuar rregullimet e politikave të ardhshme dhe hartimin e programeve.*
2. *Bazuar në analizën, mbështetja e MMPHI-së në hartimin dhe zbatimin e udhëzimeve për barazinë gjinore siç kërkohet me Ligjin për Ndryshimet Klimatike të vitit 2024.*
3. *Mbështetja e MMPHI-së në përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha aktivitetet, projektet dhe programet që lidhen me ndryshimet klimatike.*
4. *Mbështetja e iniciativave për të edukuar publikun mbi ndikimet diferenciale të ndryshimeve klimatike te gratë dhe grupet e tjera të cenueshme, duke rritur mirëkuptimin e komunitetit dhe strategjitë e reagimit.*

Digjitalizimi

Konkluzionet dhe gjetjet kryesore:

- Gratë janë dukshëm të nënpërfaqësuar në sektorët digjitalë dhe të TIK-ut në Kosovë, duke mbajtur vetëm 38 për qind të roleve vendimmarrëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe konstituojnë një fraksion tejet të vogël në mesin e ndërmarrësve në sektorin e Teknologjisë Informative.
- Pavarësisht shtrirjes së gjerë të internetit dhe konektivitetit, gratë në Kosovë ballafaqohen me barriera të konsiderueshme sa i përket pjesëmarrjes në sferën digjitale, përfshirë këtu mundësitë për përballimin e kostos së qasjes në shërbime të internetit dhe pajisje digjitale, duke shtuar këtu edhe mangësitë e konsiderueshme sa u përket njohurive për digjitalizimin.

Rekomandimet:

1. *Financimi i bursave dhe krijimi i programeve të synuara për gratë dhe vajzat në edukimin në TIK, veçanërisht në trajnimin profesional dhe arsimin e lartë. Inkurajimi i partneriteteve midis institucioneve arsimore dhe kompanive të teknologjisë për të ofruar praktika dhe mentorim për studentet gra.*
2. *Nisja e iniciativave për përmirësimin e shkrim-leximit digjital tek gratë, duke u fokusuar në tejkalimin e barrierave të tilla si përballueshmëria dhe qasja.*
3. *Zbatimi i programeve të specializuara që fokusohen në vetëdijësimin për sigurinë kibernetike dhe masat mbrojtëse për gratë, duke adresuar çështje si ngacmimi në internet dhe dhuna e lehtësuar nga teknologjia. Sigurimi i trajnimeve dhe burimeve për t'i ndihmuar gratë të ruajnë privatësinë dhe sigurinë e tyre në internet.*

